



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 562 Akti

Nr. 693 Vendimi
Tiranë, më 10.8.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilija	Kryesues
Brunilda Bekteshi	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brouwer, në datën 7.8.2023, ora 10:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Saimir Hysa**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht për sa rezultuan, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Saimir Hysa, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, referuar pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, aktualisht Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të shkronjës “b” të pikës 7 të nenit 3 dhe pikës 9 të nenit 3 të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 15.6.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, z. Saimir Hysa, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Brunilda Bekteshi dhe Roland Ilia. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Brunilda Bekteshi.
4. Trupi gjykues, pasi kishte administruar të tria raportet e përcjella nga organet ndihmëse, sipas parashikimit të neneve 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, në datën 19.6.2020, kishte vendosur: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim të caktojë kryesues të trupit gjykues komisionerin Roland Ilia. Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesave me subjektin e rivlerësimit, z. Saimir Hysa, i cili deklaroi¹ gjithashtu se nuk është në kushtet e konfliktit të interesave me asnjë prej anëtarëve të trupit gjykues.
5. Në datën 13.6.2023, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Saimir Hysa, për të tria kriteret e rivlerësimit: kriterin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të paraqesë pretendimet e tij brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike, si dhe për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.
6. Në datën 13.6.2023, subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën. Brenda afatit të caktuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, në datën 14.6.2023, u njoh e disponoi kopje të materialeve të dosjes së tij dhe në datën 23.6.2023 dërgoi shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ në rrugë elektronike dhe zyrtare.
7. Në datën 26.6.2023 vëzhguesi ndërkombëtar paraqiti disa gjetje në materialin² e përcjellë, me qëllim vijueshmërinë e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit. Trupi gjykues, me vendimin nr. 3, datë 29.6.2023, vendosi riçeljen e hetimit administrativ.

¹ Rikonfirmuar me anë të *email*-it datë 19.4.2023.

² Nr. *** prot., datë 26.6.2023 dhe nr. *** prot., datë 27.6.2023, administruar në dosjen e Komisionit në versionin anglisht dhe në përkthimin shqip.

8. Në datën 24.7.2023, Komisioni, me vendimin nr. 4, vendosi: (i) të përfundojë hetimin shtesë pas rihapjes për subjektin e rivlerësimit, z. Saimir Hysa, për kriterin e pasurisë dhe vlerësimin e aftësive profesionale; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit shtesë, të paraqesë pretendimet e tij brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike, si dhe për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative. Trupi gjykues, pas administrimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti në qëndrimin e tij, në datën 2.8.2023, me vendimin nr. 5, datë 2.8.2023, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Saimir Hysa, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, duke e njoftuar me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 7.8.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Saimir Hysa, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brouwer. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Saimir Hysa. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 7.8.2023 për të rifilluar në datën 10.8.2023 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Subjekti i rivlerësimit, z. Saimir Hysa, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" sipas krerëve IV, V dhe VI të këtij ligji. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLP-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese³ dhe kreut VII të ligjit nr.

³ Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës "Rivlerësimi kryhet nga Komisioni", kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016, "Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit". Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: "Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë". Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër,

84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

13. ILDKPKI-ja, me raportin nr. *** prot., datë 9.11.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Saimir Hysa, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar dhe në datën 28.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ky institucion ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaramet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas mbylljes së hetimit administrativ; (d) shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

15. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarameve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarameve të rreme apo të ndonjë konfliktit të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

16. Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2) dorëzuar në datën 28.1.2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga

bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

17. Apartament banimi me sipërfaqe 41 m², i ndodhur në G, Kavajë. Blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.9.2005, para noteres E.K, në bashkëpronësi me vëllain I.H. Regjistruar pranë ZVRPP-së Kavajë me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, Kavajë. Kontributi i subjektit ka qenë në shumën 200.000 lekë, të ardhura që burojnë nga paga e tij si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Vlera: 1.400.000 lekë. Pjesa takuese: 33.3%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴.

17.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Kavajë.

Hetimi i Komisionit

17.2 Nga verifikimi i deklaratave periodike u vërejt se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë blerjen e kësaj pasurie në deklaratën e interesave privatë periodikë për vitin 2005, me përshkrimin “Apartament me sipërfaqe 41 m², blerë në muajin gusht në shumën 1.400.000 lekë, me vendndodhje në G, në pjesë takuese 1/3, 33%”. Subjekti në këtë deklaratë nuk ka deklaruar shumën e investuar prej tij në këtë pasuri, si dhe burimin e krijimit të shumës së shpenzuar për blerjen e saj.

17.3 Nga korrespondenca e Komisionit me ASHK-në, kjo e fundit, nëpërmjet Drejtorisë Vendore Kavajë⁵, ka konfirmuar ekzistencën e kësaj pasurie në emër të subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij I.H.

17.3.i Nga verifikimi i praktikës së ASHK-së vërehet se subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i tij I.H, me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.9.2005, kanë blerë nga bashkëpronarët L, E. dhe A.V pasurinë e konfirmuar me të njëjtat të dhëna sikurse subjekti e ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, me sip. 41.6 m², në vlerën 1.400.000 lekë, e cila sipas kontratës rezulton e likuiduar tërësisht. Kontrata ka përcaktuar gjithashtu edhe pjesët takuese të secilit bashkëpronar, ku subjekti i rivlerësimit përcaktohet zotëruar në 1/3 e pasurisë, ndërsa vëllai i tij në 2/3 e saj.

17.4 Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se subjekti është pyetur në ILDKPKI dhe në procesverbalin⁶ e mbajtur në datën 15.3.2016 ka deklaruar lidhur me pjesën e paguar prej tij dhe cili ka qenë burimi. Në përgjigje subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ekzaktësisht: *“Fillimisht dua të sqaroj se shtysë për blerjen e kësaj banese është bërë një marrëveshje midis vëllait tim I.H, rezident në Austri, i cili drejton një studio arkitekture “***”. Ai kishte rënë në marrëveshje me shtetasin V.H, bashkëshorti i E.V dhe A.V për projektin e një hoteli në T, Vlorë, ku shpërblimi do të ishte 1.200.000 lekë. Nga im vëlla projekti është bërë në kohë dhe i është dorëzuar atij, por nuk i është likuiduar pagesa. Në vitin 2005 ata i kanë ofruar në këmbim të shumës një apartament garsoniere në G. në kompleksin e ndërtuar nga “***” sh.p.k. Nisur nga ky fakt im vëlla më ofroi që unë të paguaja diferencën prej 200.000 lekësh dhe unë të isha bashkëpronar në këtë apartament me 1/3. Meqenëse ai është jashtë shtetit dhe unë merresha edhe me mirëmbajtjen dhe dokumentacionin e nevojshëm ramë dakord që edhe regjistrimi në hipotekë të bëhej me pjesë takuese, ai 2/3 kurse unë 1/3. Burimi i vlerës 200.000 lekë, plus edhe ndonjë shpenzim për mobilimin, janë nga të ardhurat nga paga”*.

⁴ Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.9.2005, ku shtetasit Saimir dhe I. Hysa blejnë apartamentin me sip. 41.6 m², nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, Kavajë; kartelë pasurie për apartamentin me sip. 67 m², vol. ***, f. ***, në emër të shitësve L., E. dhe A.V; harta treguese e regjistrimit; vërtetim nr. ***, datë 20.1.2017, i njësisë me origjinalin të dokumenteve; certifikatë për vërtetim pronësie datë 4.10.2005, në emër të shtetasve Saimir dhe I. Hysa për apartamentin me sip. 41.6 m², nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, Kavajë; harta treguese e regjistrimit. Aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 25.11.2020 dhe praktikë shoqëruese, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶ Administruar me shkresën e ILDKPKI-së, kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.10.2020.

17.4.1 Subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ ka depozituar⁷ një material në formatin 3D lidhur me projektin e hotelit “****” në T., Vlorë, i realizuar nga studioja arkitekturore e vëllait të tij “****”.

17.5 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se burim krijimi për pjesën e tij takuese kanë shërbyer të ardhurat nga paga e tij si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Komisioni kreu analizën financiare në datën e nënshkrimit të kontratës, duke përfshirë të ardhurat nga pagat dhe shpenzimet e identifikuara deri në shtator të vitit 2005. Vlera e investuar është marrë në shumën 200.000 lekë, sipas deklaramit të subjektit në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI dhe në deklaratën *Vetting*.

17.5.1 Nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare të investojë në pjesën e tij takuese për këtë pasuri, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

17.6 Por, për këtë pasuri, Komisioni i kërkoi subjektit të jepte shpjegime lidhur me pagesën prej 200.000 lekësh të kryer prej tij, në raport me pjesën takuese 1/3, e cila përkon me vlerën 466.667 lekë.

17.7 Në qëndrimin e tij lidhur me kërkimin e Komisionit, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar: “*Ky apartament është blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.9.2005, në bashkëpronësi me vëllain I.H, në vlerën totale 1.400.000 lekë. Kontributi im monetar ka qenë në shumën 200.000 lekë, të ardhura këto që burojnë nga paga ime si prokuror në Prokurorinë e Tiranës. Apartamenti është regjistruar pranë ZVRPP-së Kavajë me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, Kavajë dhe në momentin e përpilimit të deklaratës *Vetting* zotëroja 1/3-33.3%*”. Subjekti ka deklaruar se siç ka deklaruar në ILDKPKI në procesverbalin e mbajtur datë 15.3.2016, shtysë për blerjen e kësaj banese është bërë një marrëveshje midis vëllait të tij I.H, rezident në Austri, i cili drejton një studio arkitekture “****”. Subjekti ka vijuar të shpjegojë: “*...ai/vëllai kishte rënë në marrëveshje me shtetasit V.H, bashkëshorti i E.V dhe A.V dhe vëllain e tij A.H për projektin e një hoteli në T., Vlorë, ku shpërblimi do të ishte 1.200.000 lekë. Nga im vëlla projekti është bërë në kohë dhe i është dorëzuar atij, por nuk i është likuiduar pagesa nga porositësit. Në vitin 2005 ata i kanë ofruar në këmbim të shumës një apartament garsoniere në G., në kompleksin e ndërtuar nga “****” sh.p.k. Nisur nga ky fakt im vëlla më ofroi që unë të paguaja diferencën prej 200.000 lekësh dhe unë të isha bashkëpronar në këtë apartament me 1/3. Meqenëse ai është jashtë shtetit dhe unë merresha edhe me mirëmbajtjen dhe dokumentacionin e nevojshëm, ramë dakord në mirëkuptim që edhe regjistrimi në hipotekë të bëhej me pjesë takuese, ai 2/3 kurse unë 1/3. Burimi i vlerës 200.000 lekë, plus edhe ndonjë shpenzim për mobilimin, janë nga të ardhurat nga paga. Sqaroj Komisionin se unë asnjëherë, as në DPV-në e vitit 2005 dhe as para ILDKPKI-së, nuk kam deklaruar se kontributi im për blerjen e kësaj pasurie është në proporcion të drejtë me pjesën time takuese në të, që do të ishte $1.400.000 : 3 = 466.600$ lekë. Në deklaramin tim të dhënë para ILDKPKI-së, të datës 15.3.2016, kam shpjeguar në mënyrë të detajuar rrethanat e blerjes së kësaj pasurie, pjesën e kontributit tim monetar për blerjen dhe mobilimin e saj. Blerja e kësaj prone, në një farë mënyre, ka qenë një zgjedhje e detyruar për vëllain tim, nisur nga koha e gjatë e mosshlyerjes së detyrimit prej shtetasve A. dhe V.H ndaj tij për projektin e porositur. Kontributi im monetar ka qenë pjesa që nuk mbulohej nga vlera e projektit, në shumën 200.000 lekë. Sjell në vëmendjen tuaj faktin që vëllai im nuk ka paguar ndonjë shumë në lekë për këtë apartament. Natyrisht që kjo shumë ka qenë plotësisht/lehtësisht e përballueshme për t’u paguar vetë nga vëllai im dhe nuk ishte pamundësia për sigurimin e kësaj shume që e ka shtyrë atë të më*

⁷ Me email-in datë 9.6.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

ofrojë që të bëhemi bashkëpronarë me të në këtë pasuri. Qëllimi i bashkëpronësisë në këtë rast lidhet edhe me administrimin dhe mirëmbajtjen e banesës, gjë që do të duhej të bëhej nga ana ime, nisur nga fakti se im vëlla jeton jashtë shtetit dhe do ta frekuentonte atë për pushime vetëm një herë në vit familjarisht. Kjo rrethanë vlerësohej shumë prej tij, nisur edhe nga fakti që prona nuk ndodhej në Tiranë dhe se mua do më duhej të isha prezent në G. për çdo problematikë lidhur me këtë pronë dhe ndërkohë që gjithë shpenzimet e mirëmbajtjes së këtij apartamenti do të bëheshin nga unë. Në çdo rast këto shpenzime nuk kanë qenë më shumë se 20.000-30.000 lekë në vit. Vëllai im ju ka sqaruar me anë të një letre⁸ që ju ka dërguar shpjegime lidhur me rrethanat e blerjes së kësaj prone dhe qëndrimin e tij lidhur me sa ju kërkoni shpjegime. Për këtë shkak, me propozimin e vëllait tim që këtë banesë ta kishim në bashkëpronësi, unë kam kryer pagesën e shumës të sipërpërmendur në marrëveshje dhe me mirëkuptim të plotë mes nesh, gjë që ka ekzistuar përherë, dhe ramë dakord që prona të regjistrohej në raport 2/3 me 1/3, që mendoj se është një raport i arsyeshëm për një pasuri modeste, për më tepër që kjo pronë nuk ishte blerë për qëllim fitimi material apo nga e cila do të siguroheshin të ardhura. Marrëdhënia e krijuar në këtë rast nuk është një marrëdhënie tregtare, por marrëdhënie tepër e ngushtë familjare mes dy vëllezërve ose e posaçme. Vlera prej 200.000 lekësh nuk lidhej me aftësinë time paguese të 1/3 të çmimit të banesës, por përcaktohej nga diferenca mes çmimit të blerjes dhe vlerës së projektit të palikuiduar. Edhe në rast se mua do të më duhej që të paguaja të plotë kontributin tim në raport të drejtë me pjesën takuese që unë kam përfutur, pra gjithë shumën prej 466.600 lekësh, sipas analizës financiare që vetë ju keni bërë, unë kam pasur mundësi pagese deri në shumën 370.000 lekë dhe për të plotësuar gjithë shumën prej 466.600 lekësh do të më duhej një shumë prej vetëm 96.000 lekësh, shumë që unë mund ta siguroja përmes një kredie apo huaje të vogël dhe të cilën unë do të mund ta shlyeja pa shumë mundim me të ardhurat që kisha. Çdo veprim juridik i kryer lidhur me këtë pronë është kryer në mirëkuptim dhe harmoni të plotë dhe mes nesh nuk ka asnjë paqartësi apo pretendim të ndërsjellë për këtë gjë. Me kërkesën time, vëllai im I.H, në pamundësi të ardhjes personalisht, ju ka dërguar një deklaratë⁹ të nënshkruar para noterit publik në G., që konfirmon sa ju kam parashtruar më sipër. Mendoj se shpjegimet e mësipërme janë të plota dhe bindëse për të kuptuar se në rastin konkret kjo marrëdhënie është tërësisht në përputhje me ligjin, nuk është shkelur asnjë kod etik i figurës së magjistratit dhe nuk janë prekur interesat e shtetit apo të ndonjë shtetasi”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

17.8 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, si dhe të dokumentacionit të administruar, për të konkluduar, vlerësoi dhe çmoi disa fakte të rëndësishme lidhur me shumën e paguar për këtë pasuri në raport me pjesën takuese, sikurse subjekti ka deklaruar 1/3. Trupi gjykues përgjatë hetimit vërejtë se subjekti ka qenë konsistent në deklarinimin e tij, duke deklaruar gjithnjë të njëjtën pjesë takuese, 1/3 e saj. Ndarja e pjesëve takuese për secilin bashkëpronar 2/3 me 1/3 është konfirmuar edhe në kontratën e shitblerjes nr.*** rep., nr. *** kol., datë 23.9.2005. Fakti që subjekti nuk ka deklaruar kontributin e tij në deklaratën periodike vjetore për vitin 2005 mbetet një pasaktësi pa pasojë në këtë proces, për sa kohë ai e ka korrigjuar këtë mangësi në deklaratën *Vetting*, sipas kërkesës së udhëzimit të Inspektorit të Lartë të ILDKPKI-së, nr. ***, datë 10.10.2016. Nga ana tjetër, trupi gjykues në këtë çështje konstaton se ka bazë të mjaftueshme faktesh, të cilat konfirmojnë marrëdhënien e posaçme midis vëllezërve, të cilët kanë zgjedhur të pranojnë reciprokisht pjesën takuese, përkatësisht 2/3 me 1/3, pavarësisht vlerës së kontribuar nga secili prej tyre. Po ashtu, për sa kohë nuk u provua e kundërta e deklarinimeve të subjektit të rivlerësimit apo ndonjë kundërshti e vëllait të tij lidhur me kontributin e subjektit në këtë pasuri, përkundër faktit të provuar se i vëllai ka

⁸ Përcjellë elektronikisht me prapësimet datë 23.6.2023.

⁹ Depozituar me prapësimet datë 23.6.2023.

deklaruar raportin me subjektin e rivlerësimit, vullnetin e lirë të shprehur mes tyre, dakordësinë e bashkëpronësinë në këtë pasuri, pjesët takuese dhe kontributin e secilit, trupi gjykues nuk ngre dyshime për raportin e krijuar midis pjesës takuese 1/3 dhe kontributit të dhënë nga subjekti në shumën 200.000 lekë. Trupi gjykues në këtë çështje objekt vlerësimi, duke konstatuar se edhe në variantin e përlllogaritjes financiare të vlerës 466.666 lekë në raport me pjesën takuese 1/3, subjekti rezulton në balancë negative të papërfillshme në shumën 96.000 lekë, krijojnë bindjen se subjekti ka deklaruar me vërtetësi raportin e drejtë të shumës me pjesën takuese, pra atë çfarë realisht ka paguar, ndërthurur kjo edhe me faktet e dala dhe shpjegimet e subjektit në të gjithë hetimin e thelluar për këtë pasuri, arsyetuar në vijim në këtë vendimmarrje.

17.9 Komisioni, referuar gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar, hetoi mbi mospasqyrimin e pjesëve takuese të kësaj pasurie në kartelën e pasurisë, nga ku dukej se subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i tij ishin bashkëpronarë në pjesë të barabarta.

Subjekti, pasi është pyetur¹⁰ mbi këtë konstatim, ka deklaruar: “...kjo pronë figuron deri në vitin 2018 e regjistruar në ish-ZVRPP-në Kavajë në bashkëpronësi mes meje dhe vëllait tim I.H, në raportin 1/3 unë dhe 2/3 I.H. Kjo pasqyrohet në kontratën e shitjes të datës 23.9.2025, ku citohet: “Urdhërohet ZQRPP-ja që në bazë të nenit 11 të ligjit të bëjë regjistrimin e këtij apartamenti në emër të blerësve Saimir Hysa me 1/3 pjesë dhe I.H me 2/3 pjesë”. Lidhur me mospasqyrimin e kësaj ndarjeje në kartelën e pronësisë nuk kam pasur dijeni dhe nuk mund të jap dot asnjë shpjegim përse nga punonjësit e ZVRPP-së Kavajë është pasqyruar në këtë mënyrë pa u përmendur pjesa takuese e secilit. Pra, në asnjë akt nuk shkruhet se kjo pasuri është e regjistruar me 1/2 pjesë secilit”. Subjekti ka depozituar: (i) certifikatën për vërtetim pronësie me nr. serial *** dhe hartën treguese; (ii) akt pranim dhurimin nr. ***, nr. *** kol., datë 12.7.2018, të noteres G.SH, ku pasqyrohet se ai i ka dhuruar vëllait të tij pjesën takuese prej 1/3 të pronës.

17.10 Në analizë të shpjegimeve dhe dokumentacionit të depozituar, trupi gjykues iu referua kontratës së shitjes datë 23.9.2005, nga verifikimi i së cilës konstatoi se ishin përcaktuar pjesët takuese të secilit bashkëpronar, ku subjekti i rivlerësimit rezulton zotëruar në 1/3 e pasurisë, ndërsa vëllai i tij në 2/3 e saj. Po ashtu, në kontratë ishte parashikuar urdhërimi që ZQRPP-ja, në bazë të nenit 11 të ligjit, të bëjë regjistrimin e këtij apartamenti në emër të blerësve Saimir Hysa me 1/3 pjesë dhe I.H me 2/3 pjesë. Sipas certifikatës së pronësisë të depozituar nga subjekti, para dhurimit të bërë datë 9.7.2018, subjekti rezulton në 1/3 pjesë takuese, ndërsa vëllai i tij 2/3. Sipas deklaratës së dhurimit të pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.7.2018, të noteres G.SH, pasqyrohet fakti se subjekti i ka dhuruar vëllait të tij pjesën takuese prej 1/3 të pronës dhe aktualisht vëllai i subjektit është pronar 100%. Mospasqyrimi i pjesëve takuese në kartelën e pasurisë, sikurse ishte parashikuar në kontratën e shitjes, nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe as nuk ndikon në procesin e rivlerësimit të tij, për sa kohë në kartelën e pasurisë në rubrikën përkatëse, përveçse pasqyrohet bashkëpronësia e pasurisë, në rubrikën “Shënime” përshkruhet se pasuria është regjistruar sipas kontratës së shitjes. Në këtë drejtim, duke iu referuar kontratës së shitjes, rezulton se pjesët takuese janë 2/3 me 1/3. Pasqyrimi i pjesëve takuese në certifikatën e pronësisë konfirmon regjistrimin e pasurisë në përputhje me kontratën e shitjes, por gjithashtu specifikon qartë pjesën takuese të subjektit të rivlerësimit. Në vlerësimin e trupit gjykues, kontrata e shitjes është ligj për palët që e nënshkruajnë atë dhe, për pasojë, veprimi juridik kryesor që bën pronar blerësin është ky akt, ndërsa certifikata e pasurisë dhe kartela shoqëruese e saj cilësohen si akte të cilat publikojnë pronësinë dhe shërbejnë posaçërisht për tjetërsimin e pasurisë. Siç edhe ka arsyetuar vendimi unifikues i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 6.1.2009: “Sipas frymës

¹⁰ Me pyetësorin nr. 10, datë 30.6.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

së legjislacionit tonë çasti i kalimit të së drejtës së pronësisë është çasti i lidhjes së kontratës ose momenti i realizimit të veprimit juridik. Është kontrata ajo që transferon mes palëve pronësinë e sendit të paluajtshëm, krijon të drejta reale mbi sendin dhe legjitimon pronarin të kërkojë dhe mbrojë këto të drejta. Sipas legjislacionit shqiptar sistemi i regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nuk ka efekt krijues, por thjesht publikues, njohës, pasi janë aktet bazë mbi të drejtat reale të pronësisë që krijojnë, ndryshojnë apo mbarojnë të drejtat përkatëse dhe jo regjistrimi i akteve”. Nën këto parashikime ligjore, konfirmohet sërish vërtetësia e deklaramentit të pjesës takuese 1/3 e subjektit, ku, për rrjedhojë, në vitin 2018 ai ka dhuruar pikërisht 1/3 pjesë takuese vëllait të tij, ashtu sikurse kishte përfutur nëpërmjet kontratës së blerjes së pasurisë.

17.11 Komisioni, referuar gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar, hetoi mbi dyshimin e ngritur për çmimin 1.400.000 lekë të shpenzuar për këtë pasuri, pasi kjo vlerë dukej mjaft e ulët në krahasim me të dhënat e Entit Kombëtar të Banesave. Sipas EKB-së, çmimi mesatar për atë vit në qytetin e Durrësit do të ishte 52.792 lekë/m², ndërsa çmimi i aplikuar në këtë rast është përafërsisht 34.000 lekë/m², vlerë kjo pa marrë parasysh çmimin në tregun e lirë që mund të ishte aplikuar për të tjerët.

17.12 Në lidhje me këtë konstatim, Komisioni, bazuar në praktikën e ASHK-së, konstatoi se pasuria në fjalë ka vendndodhje në Kavajë dhe jo në Durrës.

17.13 Për të verifikuar çmimin real të kësaj pasurie, në raport me të dhënat e EKB-së, sipas udhëzimit nr. 5, datë 23.11.2005, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit “k” për vitin 2005”, rezultoi se kostoja e shitjes në tregun e lirë të apartamenteve për qytetin e Kavajës është 42.037 lekë/m². Rezultoi se pasuria objekt vlerësi sipas EKB-së ka çmimin 41.6 m² (sipërfaqja e apartamentit) x 42.037 lekë/m² = 1.748.739 lekë.

17.14 Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime, pasi dukej se çmimi mesatar për atë vit do të ishte 42.037 lekë/m², ndërsa çmimi i aplikuar në këtë rast ishte përafërsisht 33.654 lekë/m², si dhe i kërkoi të depozitonte kontrata të ngjashme të nënshkruara nga shtetas të tjerë, të cilat të datonin thuajse në të njëjtin vit kalendarik (2005) për apartamente të ndodhura në të njëjtën godinë dhe ku përafërsisht të pasqyrohej e njëjta sipërfaqe.

17.15 Subjekti ka deklaruar se nuk është dakord me referencën e përdorur lidhur me çmimin që citohet nga Komisioni ku është referuar udhëzimit nr. 5, datë 23.11.2005, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit “k” për vitin 2005”, nga ku ka rezultuar se kostoja e shitjes në tregun e lirë të apartamenteve për qytetin e Kavajës është 42.037 lekë/m² dhe se kjo pasuri sipas EKB-së duhej të kishte çmimin: 41.6 m² x 42.037 lekë/m² = 1.748.739 lekë. Subjekti ka kundërshtuar, duke sqaruar se, *së pari* prona nuk ndodhet në Kavajë, por në fshatin K. dhe nuk mund të jetë çmimi i njëjtë në të gjithë zonën e Kavajës. Subjekti ka deklaruar se në vitin 2005 zona ku ishte ndërtuar pallati ishte pothuaj në nivelin e zonave informale, larg të qenit një zonë turistike si po shndërrohet sot, pa infrastrukturë të përfunduar (rrugë, kanalizime etj.), pa ujë të pijshëm nga rrjeti, pothuaj pa asnjë shërbim pastrimi dhe me shumë mangësi të tjera. Vlera prej 42.000 lekësh për metër katror është vlerë mesatare për qytetin e Kavajës dhe jo për fshatin K. Subjekti ka shpjeguar mënyrën se si është blerë kjo pronë, ku për të është paguar si këmbim në masën 80% me vlerën e projektit të papaguar edhe shuma 200.000 lekë paguar prej tij. Ai ka sqaruar se çmimi i blerjes së kësaj prone është dukshëm mbi koston mesatare të ndërtimit dhe shfrytëzimit që përcaktohet në këtë vendim, koeficient që gjithashtu mund të mos jetë i njëjtë me qytetin e Kavajës, pasi çmimi i truallit në qytet duhet të jetë më i lartë. Subjekti ka deklaruar: “Pra çmimi 1.400.000 lekë është çmimi i vendosur në dakordësi të marrëdhënies që e kam sqaruar me detaje dhe jo thjesht një çmim tregtar”. Subjekti i rivlerësimi ka depozituar 6 kontrata të marra pranë zyrës të noterës E.K për shitjen e apartamenteve në të njëjtën godinë gjatë periudhës shtator –

tetor 2005, kohë kur është blerë edhe apartamenti i tyre. Ai konfirmon se kontratat vërtetojnë tërësisht se edhe shtetas të tjerë e kanë blerë me të njëjtin çmim ose edhe më të ulët, për më tepër që banesa ndodhet në katin e parë/përdhes dhe jo në pozicion panoramik etj., rrethana që ndikojnë në çmim. Subjekti ka deklaruar se në procedurat për blerjen e kësaj prone nuk ka asnjë deklaram fiktiv apo në vlerë më të ulët, pasi në rast se do të ishte e domosdoshme edhe me çmimin 42.000 lekë për metër katror kjo banesë do të kishte qenë e përballueshme financiarisht prej tyre.

17.16 Komisioni, të dhënat nga kontratat e ngjashme të depozituara nga subjekti, i ka përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 1

Data e kontratës	Sipërfaqja e apartamentit	Vlera	Çmimi lekë/m ²
5.10.2005	67.7	16,900 €	30,590
	41.6	10,400 €	30,635
7.9.2005	67.7	1,950,000 ALL	28,804
	41.6	1,250,000 ALL	30,048
	65	1,900,000 ALL	29,231
13.10.2005	41.6	10,000 €	29,457
28.9.2005	67	24,800 \$	38,248
28.9.2005	67	26,000 \$	40,098
23.9.2005	67.7	26,000 \$	39,684

17.17 Në vijim, po për këtë pasuri, Komisioni hetoi në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi midis subjektit të rivlerësimit për shkak të ushtrimit të funksionit të tij dhe shitësve të pasurisë E.H, L dhe A.V. Subjekti depozitoi përgjigjen¹¹ e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku informohet se nga verifikimi i kryer në indekset e kallëzimeve dhe statistikave të procedimeve penale për periudhën kohore 2004 – 2023 nuk ka rezultuar që ndaj shtetasve të cituar të jenë regjistruar kallëzime apo procedime të hetuara nga prokurori Saimir Hysa.

17.18 Nga analizimi i të dhënave të dokumentacionit të administruar, trupi gjykues konstatoi se pasuria me sip. 41.6 m², e blerë prej subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij, rezultoi në çmimin 33.654 lekë/m², pra më shtrenjtë se çmimi mesatar për metër katror i pjesës më të madhe të kontratave të depozituara. Trupi gjykues, bazuar thelbësisht në faktet e dala për këtë pasuri, por edhe në të dhënat e grumbulluara nga kontratat e ngjashme, të cilat identifikuan vlera më të ulëta për blerje të pasurive në të njëjtin vend dhe thuajse në të njëjtën periudhë kohore, ndërthurur kjo situatë edhe me mosekzistencën e subjektit në ndonjë konflikt të mundshëm interesi me shitësit e kësaj pasurie, për shkak të detyrës, çmon se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm vërtetësinë e shumës 1.400.000 lekë të shpenzuar për këtë pasuri.

17.19 Komisioni, referuar gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar, hetoi edhe lidhur me deklaramin konsistent të subjektit se vëllai ofronte shërbime të cilat ende nuk ishin paguar nga persona të tretë dhe që shlyheshin me blerjen e këtij apartamenti, por që ky version nuk ishte përshkruar në kontratën e shitjes së pasurisë. Në lidhje me kërkimin e Komisionit për të depozituar dokumentacion për porosinë e bërjes së projektit, marrëveshjes për hartimin e projektit, dorëzimin e tij, moskryerjen e pagesave nga persona të tretë, subjekti ka deklaruar se në asnjë rast nuk ka qenë pjesë e këtyre

¹¹ Me shkresën nr. *** prot., A. N., datë 1.6.2023, bashkëngjitur me pyetësorin e dërguar datë 25.5.2023.

bisedave. Subjekti ka konfirmuar se këto pyetje ia ka referuar vëllait të tij dhe shtetasit V.H (shtetasi A.H nuk jeton më), të cilët e kanë autorizuar të deklarojë se të gjitha këto bisedime nuk janë dokumentuar me shkrim prej tyre. Subjekti ka sqaruar se vëllai i tij me një nga porositësit V.H ka pasur njohje që përpara viteve '90, por edhe me të ndjerin A.H njihej më parë dhe çdo bisedë është bërë në kuadër të një njohjeje dhe miqësie të konsoliduar dhe mes tyre nuk është lidhur ndonjë kontratë porosie apo akt tjetër i shkruar që të mund ta vendoste në dispozicion. Subjekti ka deklaruar se sa i takon lidhjes së pasurisë (pronar të truallit, godinës apo çfarë) së shitur në G. me porositësit e projektit, godina ku ndodhet apartamenti i blerë prej tyre është ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k. me administrator A.V, ortakë të së cilës ishin me nga 50% secili, A.V dhe V.H, në truallin në pronësi të familjes V. Apartamenti që ai dhe vëllai kanë blerë ka qenë në pronësi të shtetaseve L.V dhe E.V. Shtetasit A.V dhe E.V janë fëmijët e L.V dhe V.H është bashkëshorti i E., njëkohësisht kunati i A. dhe dhëndri i L. Shtetasit A.H dhe V.H janë vëllezër mes tyre. Subjekti ka parashtruar se: “Dyshimet që hidhen mbi këtë marrëdhënie nuk kanë të bëjnë vetëm me mua, por automatikisht përfshijnë edhe njerëz të tjerë të nderuar të cilët do të ishin “bashkëpunëtorët e mi” në këto veprime”. Subjekti bën me dije për Komisionin dhe vëzhguesit ndërkombëtarë se: “Shtetasja L.V, personi që ai dhe vëllai i tij i kanë blerë banesën, është vajza e personalitetit të shquar të diasporës shqiptare, z. XH.F, që i ka lënë trashëgimi një pasuri tepër të madhe familjes së tij. A. dhe E. janë mbesat e tij dhe qytetarë të nderuar të këtij vendi, që nuk kanë asnjë arsye të implikohen me mua në veprime juridike fiktive për shuma kaq të ulëta për ta apo për të fshehur ndokush pasurinë. Po kështu edhe vëllai im është një qytetar tepër i respektuar në Austri, i integruar më së miri dhe tepër i suksesshëm në aktivitetin e tij si arkitekt, por edhe ndërtues/biznesmen, njeri që i bën nder vendit të tij të origjinës. Lidhur me këto dyshime që ngrihen për këtë marrëdhënie, dua t’ju referoj me shumë sinqeritet se e kam pasur të vështirë t’ju shpjegoj atyre për dyshimet që ngrihen lidhur për blerjen e këtij apartamenti. Më vjen keq t’ju them se gjithë këto dyshime janë ngritur thjesht mbi bazën e deklaramit tim të sinqertë për mënyrën se si është blerë ky apartament. Po e rideklaroj se shuma prej 1.400.000 lekësh ka qenë tërësisht e përbalueshme prej nesh dhe unë mund ta kisha deklaruar si pasuri të blerë me para në dorë dhe jo pjesërisht me klering. Qëllimi im ka qenë vetëm deklarimi i së vërtetës para ILDKPKI-së dhe më pas përpara jush, pasi nuk kisha arsye të vepra ndryshe”. Subjekti ka sqaruar se po i kërkohen shpjegime edhe sa i takon sjelljes së vëllait të tij I.H, gjë që nuk është objekt i rivlerësimit të tij dhe nuk mund ta penalizojë atë në kuadër të këtij procesi. Subjekti ka sqaruar se: “Nga ana ime është zbatuar detyrimi ligjor për t’ju vënë në dispozicion çdo dokument që më keni kërkuar, që ka lidhje me të si person i lidhur për pjesën e pasurisë”.

17.20 Trupi gjykues, në vlerësim dhe analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, nuk ngre dyshime lidhur me marrëdhëniet e hershme të krijuara mes vëllait të subjektit dhe shtetasve H. e V, apo edhe mbi ekzistencën e ndonjë marrëdhënieje të mundshme të krijuar në heshtje për këmbimin e pasurisë për shkak të mosshlyerjes së shumës së një projekti të porositur nga të tretë dhe i realizuar nga vëllai i subjektit, por, për sa kohë nuk administroi dokumentacion provues ku të pasqyroheshin shërbimet e ofruara nga vëllai i subjektit si mënyrë e likuidimit të kësaj pasurie, referuar gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar, vlerësoi të hetojë lidhur me mundësinë financiare të vëllait të subjektit për të krijuar shumën 1.200.000 lekë, ku sipas kontratës së shitjes thuhej se është investuar në vlerë monetare.

17.21 Për të konkluduar mbi këtë fakt, paraprakisht Komisionit (por referuar edhe gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar) i rezultoi se vëllai i subjektit kishte investuar në blerjen e një apartamenti në Tiranë në vitin 2005, në shumën 58.000 euro. Subjekti, pasi është pyetur mbi këtë shpenzim, ka deklaruar: “...për blerjen e kësaj banese ai (vëllai) dhe bashkëshortja e tij E.W kanë marrë një kredi në G., në bankën “****” në shumën 62.000 euro ose vlerën ekuivalente në franga zvicerane. Për marrjen e kësaj kredie, që është dhënë më qëllimin për të blerë “një objekt banimi në Shqipëri”,

citim nga kontrata, është vënë në hipotekë banesa e ndodhur në G., Austri, në pronësi të vjehrrës së vëllait tim, shtetases R.W. Kjo kredi është marrë në datën 25.5.2005 dhe është tërhequr e gjitha në cash nga vëllai im dhe bashkëshortja e tij dhe është sjellë në Shqipëri në disa pjesë gjatë udhëtimeve që ata kanë bërë në Shqipëri në vitin 2005. Paraprakisht më lejoni t'ju sqaroj se lidhur me deklarimin e këtyre shumave në kufi/doganë vëllai im më referon se nuk mban mend detaje, por kujton se pagesat janë kryer në arkën e shoqërisë, në tre apo katër këste, në total 58.000 euro. Ditën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, më 7.5.2005, vëllai im ka bërë një pagesë në shumën 20.000 euro në arkën e shoqërisë “***” nga të ardhurat e tij. Pagesat e tjera janë bërë më pas me burim kredinë e sipërpërmendur, por prej tij nuk janë gjetur dokumente për këto pagesa dhe ai disponon vetëm një dokument pagese, atë të parapagimit prej 20.000 euro që ishte bashkëlidhur me kontratën e sipërmarrjes. Nga ana ime është bërë kërkesë pranë shoqërisë “***” sh.p.k. për dokumentacionin e pagesave dhe më është bërë e ditur se nuk disponojnë asnjë të dhënë tej periudhës 10-vjeçare. Në muajin shtator 2005 nga vëllai im është blerë edhe një garazh në shumën 7.000 euro po në këtë pallat, me burim të ardhurat nga kredia. Ky garazh është shitur prej tij rreth një vit pas shitjes së banesës, mbase 2010, pasi nuk është blerë nga blerësja e apartamentit por nga një shtetas tjetër. Vëllai më referoi se aktualisht nuk disponon asnjë dokument për hipotekimin apo shitjen e këtij garazhi që ndodhej në katin përdhës të pallatit ku ndodhej banesa e tij. Ai nuk e kujton çmimin e shitjes, por mendon se ka qenë pothuaj i njëjtë me atë të blerjes. Pagesa është bërë nga blerësi në dorë, me para cash dhe i vetmi dokument që ai ka gjetur lidhur me këtë pasuri është i pagesës që ai ka bërë në arkën e shoqërisë për blerjen e tij në shumën 7.000 euro më 24.9.2005. Lidhur me mundësitë financiare të vëllait tim për të paguar shumën prej 1.200.00 lekësh për apartamentin në K., dua t'ju ridekloj se nga vëllai im nuk është paguar kjo shumë për blerjen e kësaj prone, ashtu siç kam shpjeguar edhe më sipër, por ajo ka qenë vlera e projektit të porositur. Gjithsesi, sipas kërkesës tuaj, pyetjen tuaj ia referova vëllait tim që më ka dërguar dy vërtetime nga Instituti i Pensioneve në Austri, sipas të cilit të ardhurat e tatueshme të tij (person fizik) dhe bashkëshortes për vitin 2005 kanë qenë në shumën 41.000 euro, shumë në të cilën nuk përfshihen të ardhurat e vëllait tim nga biznesi i tij në formën e dividendëve që ka përfutuar nga shoqëritë ku është aksioner, të cilat kanë qenë edhe më të mëdha. Këto të ardhura, si dhe kredia e sipërpërmendur, tejkalojnë ndjeshëm vlerën e të dyja pronave, për të cilat ju keni ngritur dyshime dhe provojnë plotësisht aftësitë paguese të vëllait tim për blerjen e tyre”.

17.22 Subjekti ka depozituar: (i) disa printime nga regjistri kombëtar i gjendjes civile për marrëdhëniet familjare të shitësve të pasurisë; (ii) dokumentacionin llogari pensioni nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për vëllain e tij I.H për periudhën 1998 – 2022 dhe bashkëshorten e tij E.H për periudhën 1989 – 2022; (iii) kontratën e kredisë datë 25.5.2005, në vlerën 62.000 euro; (iv) kontratën e sipërmarrjes datë 7.5.2005, për apartamentin në Tiranë; (v) vërtetim pagese datë 7.5.2005, në shumën 20.000 euro, për apartamentin dhe vërtetim pagese datë 24.9.2005, në shumën 7.000 euro, për blerje garazhi.

17.23 Komisioni ka paraqitur në tabelën e mëposhtme informacionin e dokumentacionit të depozituar nga ana e subjektit lidhur me të ardhurat nga punësimi i vëllait dhe bashkëshortes së tij. Gjithashtu, në përllogaritje është mbajtur në konsideratë fakti se të ardhurat janë bruto dhe në to nuk janë përfshirë të ardhurat nga aktiviteti tregtar në Austri.

17.23.1 Në përllogaritjet e kryera, shpenzimet e jetesës janë bazuar në Eurostat për një familje prej 4 anëtarësh, 2 të rritur + 2 fëmijë nën 14 vjeç. Sipas tabelës së mëposhtme mundësia për kursim për periudhën 1998 – 2011 rezulton në vlerën 280.084 euro. Komisioni e ka shtrirë analizën përtej vitit 2005, pra deri në vitin 2011, sepse ky është viti kur është dhënë hua, si dhe marrëdhënia e fundit mes dy vëllezërve.

Tabela nr. 2

Viti	Shuma e bazave të kontributeve për I.H (1)	Shuma e bazave të kontributeve për E.H (2)	Total 3 = (1+2)	Shpenzime jetese (2 të rritur + 2 fëmijë nën 14 vjeç) (4)	Mundësia për kursim 5 = (4-3)
1998	14,930.42	3,865.49	18,795.91	17,913	882.91
1999	18,050.99	14,995.33	33,046.32	18,119	14,927.32
2000	18,669.00	14,502.24	33,171.24	19,047	14,124.24
2001	6,453.36	18,717.48	25,170.84	19,263	5,907.84
2002	8,108.28	15,396.85	23,505.13	19,263	4,242.13
2003	11,987.28	15,571.08	27,558.36	19,694	7,864.36
2004	13,157.04	28,467.17	41,624.21	21,249	20,375.21
2005	13,459.68	27,724.55	41,184.23	22,375	18,809.23
2006	13,922.28	24,796.29	38,718.57	22,496	16,222.57
2007	37,306.32	24,142.56	61,448.88	22,876	38,572.88
2008	55,020.00	25,292.58	80,312.58	24,461	55,851.58
2009	35,314.32	26,644.68	61,959.00	25,791	36,168.00
2010	20,856.48	27,401.90	48,258.38	26,533	21,725.38
2011	16,367.64	35,085.48	51,453.12	27,043	24,410.12
	283,603.09	302,603.68	586,206.77	306,123	280,083.77

17.23.2 Komisioni, nisur nga faktet se: (i) pasuria apartament në K., Kavajë, është blerë në shtator të vitit 2005; (ii) në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar referohen të dhëna për investime të vëllait në këtë vit në një pasuri tjetër të paluajtshme - apartament në qytetin e Tiranës, sipas kontratës së sipërmarrjes datë 7.5.2005, me vlerë 64.400 euro, ku vëllai i subjektit ka paguar 58.000 euro; (iii) subjekti ka shpjeguar që ky apartament është blerë më anë të një kredie që vëllai i tij ka marrë në Austri në vlerën 62.000 euro, për të cilën ka depozituar kontratën e kredisë datë 25.5.2005, ku citohet qëllimi për blerje objekt banimi në Shqipëri – kreu analizën financiare për të konkluduar nëse vëllai i subjektit kishte mundësi financiare të investonte në shumën 1.200.000 lekë (konvertuar me kursin e vitit 2005 në vlerën 9.793 euro) për blerjen e apartamentit në K., Kavajë, si dhe të përballonte investimet e tjera financiare. Komisioni në analizën financiare ka përfshirë vetëm të ardhurat bruto nga punësimi dhe jo ato të përfituara nga aktiviteti tregtar, si dhe investimet e identifikuar deri në datën 23.9.2005, kur është blerë apartamenti në K..

Tabela nr. 3

Nr.	Përshkrimi	1998 – 23.9.2005
1	TË ARDHURA	292,328 euro
	Të ardhura nga paga I.H	100,329
	Të ardhura nga paga E.H	129,999
	Të ardhura nga kredia (25.5.2005)	62,000
2	SHPENZIME	151,801 euro
	Shpenzime jetese sipas Eurostat-it	149,465
	Shpenzime disbursimi kredia sipas kontratës	2,336
3	PASURI	67,793 euro

	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Apartament në Tiranë (7.5.2005)	58,000
	Apartament në Kavajë (23.9.2005)	9,793
	Mundësia për kursim (1-2-3)	72,735 euro

17.24 Për sa rezultoi më sipër nga shpjegimet e subjektit, provat e administruara dhe analiza financiare e kryer, trupi gjykues konkludoi se vëllai i subjektit ka pasur mundësi të investojë në blerjen e 2/3 pjesë takuese në pasurinë e paluajtshme objekt vlerësimi në K., Kavajë, në shumën 1.200.000 lekë, por edhe të kryejë investimet e tjera apo shpenzimet familjare. Pra, edhe në variantin dominant të këtij vlerësimi, në kushtet kur nuk u provua bindshëm se shuma 1.200.000 lekë në të vërtetë nuk është paguar nën deklarin e subjektit se ishte përlllogaritur nga shitësit e pasurisë si shlyerje e detyrimit të këtyre të fundit për projektin e porositur, vëllai i subjektit rezultoi në aftësi paguese për të paguar këtë shumë.

17.25 Komisioni, referuar gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar, hetoi edhe lidhur me përdorimin e kësaj pasurie, për faktin se dukej e paqartë se nga kush është përdorur ajo, a ka banuar subjekti i rivlerësimit në këtë pasuri, a është dhënë me qira dhe, nëse po, kush është kujdesur për kontratat e nevojshme, marrjen e qirasë, pagesën e shpenzimeve etj. dhe se në emër të kujt janë regjistruar këto shërbime utilitare.

17.25.1 Subjekti, lidhur me përdorimin e kësaj pasurie, ka deklaruar¹²: “...që nga momenti i blerjes kjo pasuri është përdorur nga unë dhe bashkëshortja ime, vëllai im I.H me familjen e tij, prindërit e mi deri para disa vitesh dhe vëllai im N.H, sipas rastit. Në raste të veçanta është përdorur edhe nga miq apo të afërm tanë të tjerë që kanë qëndruar atje për periudha të shkurtra, pa pagesë. As unë dhe askush tjetër nuk ka banuar në këtë pasuri në mënyrë permantente. Banesa është përdorur vetëm gjatë muajve të verës, për fundjavë ose periudha pushimesh nga personat e sipërpërmendur me kohëzgjatje nga 1-2 deri në 10-15 ditë. Lidhur me përdorimin e kësaj banese, natyrisht që në aspektin kohor nuk është bërë në proporcion me pjesët takuese 1/3 me 2/3, por sa herë kemi pasur nevojë. Vëllai im I. e ka përdorur përgjithësisht në periudhën e pushimeve (gusht-shtator) kur vinte bashkë me familjen e tij dhe rrallë kur ka ardhur vetëm. Për t’i dalë para gjetjeve të tjera të mundshme, po ju sqaroj në avancë se në drejtim të përdorimit dhe administrimit, pavarësisht se prej vitit 2018 unë nuk jam më bashkëpronar i saj, banesa vazhdon të përdoret edhe nga unë, njësoj si më parë. Edhe sa i takon shërbimeve “utilitare” si pagesë e energjisë elektrike apo marrëdhëniet me administratorin, vazhdojnë të bëhen nga unë pa asnjë ndryshim me periudhën në të cilën isha bashkëpronar në këtë pasuri, veprime të kryera natyrisht me mirëkuptimin e plotë të pronarit të banesës. Kjo pasuri nuk është dhënë asnjë ditë me qira. Nuk ka pasur shpenzime dhe angazhime të kësaj natyre pasi prona nuk është dhënë me qira. Që nga momenti i blerjes së banesës kontrata e furnizimit me energji elektrike nr. 20908 ka qenë regjistruar me emrin “***”. Dua t’ju shpjegoj se emri “***” bëhet fjalë për shtetasin A.V, shitësi i pronës, dhe “***” bëhet fjalë për vëllain tim I.H, që është shënuar gabimisht “***”. Nuk i di rrethanat se përse është bërë regjistrimi i kontratës me këtë emër dhe në këtë mënyrë, pasi unë vetë nuk disponoj një kontratë me OSHEE-në. Lidhur me pagimin e ujit të pijshëm, ende banesa nuk ka një kontratë me UKT-në për furnizimin me ujë, pasi për shumë vjet është furnizuar me ujë pusi dhe nga depozitat. Pas përfundimit të rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm nuk është lidhur ende kontrata me UKT Kavajë, kontratë që duhet të lidhet nga pronari i banesës”.

¹² Në përgjigje të pyetësorit nr. 10, datë 30.6.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

17.25.2 Subjekti ka depozituar kopje të librezës së pagesave të energjisë elektrike për këtë banesë, si i vetmi dokument që kanë (sikurse shprehet subjekti), si dhe një printim të marrë nga sistemi i OSHEE-së.

17.26 Në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të depozituar, trupi gjykues konstatoi se kontrata e furnizimit me energji elektrike nr. *** është e regjistruar me emrin “****”. Në analizë të qartësimit të bërë nga subjekti lidhur me shkrimin e gabuar të emrit të vëllait nga I. në ***, por edhe të shtetasit V, krijohet bindja për lapsuse të mundshme të bëra në shkrim, për sa kohë mes emrit *** dhe I. duket se ka ngjashmëri. Nga ana tjetër, nga dokumentacioni i administruar nuk u identifikua ndonjë i tretë si titullar i kësaj pasurie apo librezës së shërbimit me energji elektrike. Në analizë të shpjegimeve të plota të subjektit lidhur me përdorimin e kësaj pasurie dhe për sa kohë në asnjë rast përgjatë hetimit nuk u provua e kundërta e deklarimeve, nuk u diktua ndonjë kontratë qiraje e padeklaruar apo nuk u përcollën pretendime të ndryshme të të tretëve për përdorim të kësaj banese, trupi gjykues nuk konkludon në problematika, përkundër konkludon se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi përdorimin e kësaj pasurie.

17.27 Komisioni, referuar gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar, hetoi edhe mbi transferimin e pjesës takuese (1/3) të subjektit të rivlerësimit në apartamentin objekt hetimi tek i vëllai në vitin 2018, si shlyerje e huas 15.000 euro, marrë pa interes për blerjen e pasurisë së trajtuar në vijim në këtë vendimmarrje, pasi dukej si një veprim deklarativ dhe jo i provuar.

17.27.1 Subjekti, në prapësimet e tij pas riçeljes së hetimit, e kundërshtoi këtë konstatim paraprak, duke deklaruar se *pjesa takuese e kësaj pasurie nuk ka kaluar nga ai tek i vëllai “në mënyrë deklarative”, por në bazë të një akti dhurimi të nënshkruar para noterit publik i depozituar nga ASHK-ja, duke prodhuar pasoja juridike, ku ai ka humbur të drejtën mbi pronësinë në masën 1/3 të kësaj pasurie dhe vëllai i tij aktualisht e zotëron atë 100%*. Subjekti ka kundërshtuar, duke qartësuar se *kjo procedurë nuk mund të konsiderohet “deklarative” kur prona ka lëvizur nga ai tek i vëllai dhe për të janë bërë shënimet përkatëse në regjistrat e ASHK-së*. Subjekti ka theksuar se, sikurse ka shpjeguar edhe më parë, nga momenti i blerjes deri në momentin që ka kryer këtë veprim ka një distancë kohore prej 14 vjetësh. Sipas subjektit nuk është “fair” që të thuhet se ka paguar 200.000 lekë dhe ka përfituruar 15.000 euro. Subjekti ka qartësuar se në vitin 2018 prona kushtonte shumë më tepër. Ai ka deklaruar se mes tij dhe të vëllait nuk është bërë asnjëherë llogaritje se sa para duhet t’i jepte të vëllait për të plotësuar shumën që ai kishte marrë hua, për të cilën ka qartësuar se i kishte mundësitë financiare ta bënte, por ka vijuar të qartësojë se diferenca nuk është e madhe dhe nuk e kuptonte se çfarë ai duhet të provonte në këtë rast. Subjekti ka deklaruar se për sa i takon vullnetit të vëllait të tij për të dyja këto veprime, është shprehur në kontratën e blerjes së apartamentit të vitit 2005 dhe në deklaratën noteriale të vitit 2018, me të cilën e konsideron të shlyer huan me kalimin e 1/3 të apartamentit që ishte në pronësinë e tij. Subjekti thekson se këtë vullnet i vëllai ia ka shprehur edhe Komisionit me deklaratën noteriale (datë 22.6.2023, G.) që ka depozituar. Subjekti ka qartësuar se i vëllai, si person madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, ka të drejtën të kryejë veprime juridike dhe të disponojë si të dojë mbi pasuritë që ka. Ai ka theksuar se: *“Unë, duke pranuar pasojat e këtyre akteve, nuk kam shkelur asnjë ligj apo cenuar figurën e magjistratit”*. Subjekti ka deklaruar: *“Shuma/diferenca mes huas dhe vlerës së 1/3 të apartamentit nuk ishte e papërbalueshme prej nesh, pasi kursimet tona të deklaruara në DPV-në e vitit 2018 ishin rreth 3.000.000 lekë dhe 7.300 euro, ndaj dhe atë diferencë mund ta kishim paguar pa asnjë lloj problemi”*. Gjithashtu subjekti ka deklaruar: *“Ky veprim juridik bazën e ka të mosdakordësia jonë për mbajtjen ose jo të kësaj pasurie, për të cilën kishim mendime të ndryshme, pasi unë doja ta shisnim dhe vëllai jo dhe këtë e zgjidhëm duke i kaluar të gjitha në pronësi të vëllait tim në këmbim të shlyerjes së huas. Vëllai im nuk pranoi*

asnjë kompensim tjetër, duke e quajtur të mjaftueshme kalimin e 1/3 të pronës dhe unë nuk kisha asnjë arsye mos ta pranoja”.

17.28 Në analizë të shpjegimeve dhe dokumentacionit të depozituar, trupi gjykues konstatoi se pjesa takuese 1/3 e subjektit të rivlerësimit në këtë pasuri është tjetërsuar tek i vëllai i tij I.H nëpërmjet veprimeve ligjore që parashikon ligji dhe jo atyre deklarative, si dhurimi i subjektit dhe regjistrimi hipotekor në emër të vëllait të tij sipas certifikatës për vërtetim pronësie. Në analizë të dokumentacionit të administruar u konstatua se fillimisht subjekti është bërë pronar i 1/3 së pasurisë në vitin 2005. Më tej, kjo pasuri është regjistruar në emër të dy bashkëpronarëve në pjesë takuese 1/3 me 2/3. Në vijim, thuajse pas 14 viteve, subjekti ka dhuruar pjesën e tij tek i vëllai, duke u dakordësuar me njëri-tjetrin për shlyerjen e huas prej 15.000 euro. Trupi gjykues në këtë rast, përveçse vlerëson vullnetin e palëve, mban në konsideratë edhe faktin që vlera e pasurisë, sigurisht pas 14 viteve, nuk mund të ketë të njëjtin çmim sikurse ajo ishte blerë. Pra, të gjithë veprimet kronologjike janë kryer konform rregullave dhe ligjeve në fuqi për regjistrimin dhe tjetërsimin e pasurisë. Për sa kohë subjekti dhe vëllai i tij, thënë ndryshe të dy palët kontraktore të blerjes së pasurisë në bashkëpronësi dhe më tej të tjetërsimit të saj në një pronar të vetëm, janë dakordësuar jo vetëm për kryerjen e vullnetshme të këtyre veprimeve, por edhe për ta quajtur të ezauruar shlyerjen e huas 15.000 euro, konsideruar këtu edhe sqarimi i subjektit për vlerat e ndryshme variuese të shitblerjes së pasurisë, referuar kohës në të cilat kanë ndodhur veprimet përkatëse, çdo hamendësim tjetër duket se del jashtë kornizës së këtij hetimi dhe tejkalon vullnetin e palëve pa ndonjë arsye të qenësishme apo ndonjë provë tjetër të prezantuar që kundërshton dakordësinë e palëve dhe, për pasojë, të mund të ndryshonte konkludimin e trupit gjykues.

17.29 Në përfundim për këtë pasuri, trupi gjykues, duke qenë se përgjatë gjithë procesit për këtë subjekt, kundrejt një hetimi gjithëpërfshirës dhe të thelluar, nuk evidentoi ndonjë fakt apo rrethanë të ndryshme nga ajo e deklaruar nga subjekti apo dokumentacioni i administruar në dosje, pa pasur gjithashtu kurrfarë *indicie* apo dyshim lidhur me raportin e subjektit në tërësi me këtë pasuri, si dhe në mungesë të çdo informacioni negativ nga organet ligjzbatuese për figurën e tij në çështjen objekt vlerësimi, çmon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar me saktësi e vërtetësi pjesën e tij takuese, përdorimin e kësaj pasurie, ka pasur mundësi financiare për të kontribuar në shumën 200.000 lekë për blerjen e saj, si dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit për shkak të detyrës dhe, për pasojë, nuk ka asnjë rrethanë që afekton procesin e tij të rivlerësimit.

18. Apartament me sipërfaqe 71.2 m², i ndodhur në rrugën “***”, Tiranë. Blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.10.2011, para noterës A.S, Tiranë. Në bashkëpronësi me bashkëshorten E.T. Regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë me nr. *** regjistri hipotekor, datë 21.10.2011. Vlera: 60.000 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimet e blerjes së kësaj prone janë:

- Shuma prej 400.000 lekësh depozitë e përbashkët me znj. E.T në Intesa Sanpaolo Bank, hapur në maj të vitit 2011 dhe tërhequr e gjitha më 4.8.2011.
- Shuma prej 17.000 euro kursime të znj. E.T në ISP Bank, tërhequr më 5.8.2011. Kjo shumë, së bashku me shumën e mësipërme prej 400.000 lekësh, në datën 5.8.2011 i është dhënë *cash* shitësit A.L, sipas mandatit nr. ***, datë 5.8.2011, lëshuar prej tij.
- Kredia bankare në shumën 25.000 euro, marrë nga subjekti dhe znj. E.T në Credins Bank, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.11.2011, lidhur para noterit J.ZH, për një afat 15-vjeçar. Me marrjen e kësaj kredie është hipotekuar vetë apartamenti që është blerë, sipas kontratës së hipotekimit datë 1.11.2011, e cila i ka kaluar firmës ndërtuese “****” sh.p.k. Kjo është shlyer me një hua të marrë nga shtetasi A.H.H në shumën 25.000 euro, kryer me transfertë bankare nga llogaria nr. *** e shtetasit A.H drejt Credins Bank, në datën 22.12.2011. Huaja ndaj

këtij shtetasi është shlyer totalisht në vitin 2016, sipas deklaratës noteriale të datës 25.1.2017, lëshuar nga shtetasi A.H para noteres M.SH.

- Huaja në shumën 15.000 euro, marrë nga shtetasi I.H, vëllai, shumë e cila i është paguar *cash* shoqërisë “****” sh.p.k., z. A.L. Për këtë hua është lidhur kontrata e huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.11.2011, para noteres B.A. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente¹³.

18.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë.

Hetimi i Komisionit

18.2 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë blerjen e kësaj pasurie në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë për vitin 2011, me përshkrimin “Blerë një apartament me sip. 71.2 m², sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.10.2011, lidhur para noteres A.S, nga shoqëria “****” sh.p.k., me përfaqësues z. A.L. Prona ka nr. ***, nr. *** regjistri hipotekor, datë 21.10.2011, në z. k. ***, Tiranë. Vlera: 60.000 euro. Pjesa takuese: 50%.

Në rubrikën e detyrimeve të po kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar:

- marrjen e një kredie pranë Credins Bank në shumën 25.000 euro, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.11.2011, e cila është shlyer tërësisht në datën 22.12.2011, me anë të një huaje pa afat dhe pa interes nga shtetasi A.H.H;

¹³ Kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.10.2011, ku Saimir Hysa dhe E.T blejnë nga shoqëria “****” sh.p.k. apartamentin me sip. 71.2 m², i ndodhur në rrugën “****”, Tiranë. Çmimi i shitjes është 60.000 euro; vërtetim nga dokumentet hipotekore datë 23.9.2011, për apartamentin me sip. 71.2 m², në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.; hartë treguese e regjistrimit dhe planimetri; vërtetim nga dokumentet hipotekore datë 21.10.2011, për apartamentin me sip. 71.2 m², në emër të Saimir Hysa dhe E.T; hartë treguese e regjistrimit dhe vërtetim i njësisë me origjinalin nr. ***, datë 25.10.2016; mandatarkëtim nr. ***, datë 5.8.2011, nga Saimir Hysa për “****” sh.p.k., në shumën 20.000 euro, shoqëruar me vërtetimin e njësisë me origjinalin nr. ***, datë 20.1.2017; kontratë bankare në shumën 25.000 euro në Credins Bank nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.11.2011, me afat 15-vjeçar për blerje apartamenti dhe praktika; vërtetim i njësisë me origjinalin nr. ***, datë 20.1.2017, për kontratë hipotekimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.11.2011, bashkëlidhur; deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.1.2012, për lirim e pasurisë apartament me sip. 71.2 m² nga inskripti që e rëndon në favor të Credins Bank; konfirmim nga ISP Bank datë 25.1.2017, sipas të cilit Saimir dhe E.H kanë pasur llogari të përbashkët hapur më 3.5.2011 dhe mbyllur më 8.8.2011; *statement* bankar datë 25.1.2017 nga ISP Bank, ku figuron transferata në shumën 400.000 lekë, datë 3.5.2011; *statement* bankar datë 25.1.2017 nga ISP Bank, ku figuron tërheqja e shumës 300.000 lekë datë 4.8.2011 dhe transferimi i shumës 103.761 lekë ndërmjet llogarive; konfirmim bankare nga ISP Bank, ku figuron tërheqja *cash* e shumës 17.000 euro, datë 5.8.2011, nga llogaria e E.T; transfertë bankare nga llogaria nr. *** drejt Credins Bank, me datë valutë 22.12.2011 dhe përfitues Saimir Hysa, me përshkrimin “Hua pa interes”, në shumën 25.000 euro; konfirmim bankare nga ISP Bank datë 3.8.2012, 6.6.2012, 1.6.2012, 30.4.2012, 18.4.2012, 30.3.2012, 2.3.2012, 2.2.2012, 3.1.2012 etj., për likuidim huaje nga E.T tek A.H; deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.1.2017, për hua në shumën 25.000 euro, dhënë nga A.H në vitin 2011; kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.11.2011, sipas së cilës I.H i ka dhënë në gusht 2011 Saimir Hysës shumën 15.000 euro, pa afat dhe pa interes, me qëllim blerjen e një apartamenti pranë shoqërisë “****” sh.p.k.; dokumentacion në gjuhën gjermane shoqëruar me vërtetim të njësisë me origjinalin nr. ***, datë 21.11.2016, të “ekstraktit nga regjistri tregtar për I.H, lëshuar nga Bashkia G, Zyra e Shërbimit të Publikut, datë 23.5.2016”, bashkëlidhur dokumentet e përkthyer; ekstrakt nga regjistri tregtar datë 23.5.2016, ku I.H me shtetësi austriake ka aktivitet me objekt “Zyra teknike - zyra inxhinierike (ingjinier konsulente) në fushën e arkitekturës së interierit. Licensimi i aktivitetit datë 18.5.2006. Selia e ushtrimit të aktivitetit *** G., ***. Njësia administrative ***, ****; ekstrakt me të dhënat aktuale, data e kërkimit 17.2.2012, ku shoqëria “****” ***, me seli në Njësinë Administrative G., ka aktivitet me objekt “****” dhe kapital 35.000 euro me administrator I.H dhe F.S; vërtetim nënshkrimi nr. ***, datë 21.11.2016 dhe vërtetim i njësisë me origjinalin nr. ***, datë 21.11.2016, për listëpagesa dhe njoftime për periudhën 1.1.2011 – 31.12.2011, lëshuar nga Drejtoria e Tatim-Taksave G. - qytet, datë 22.11.2011, bashkëlidhur listë paga për periudhën 1.1.2011 – 31.12.2011, në shumën bruto 35.461 euro dhe shumë të tatueshme 24.688 euro; vërtetim nënshkrimi nr. ***, datë 21.11.2016 dhe vërtetim i njësisë me origjinalin nr. ***, datë 21.11.2016, të dokumentacionit në gjermanisht “ekstrakt nga regjistri tregtar për shoqërinë “****” ***, lëshuar më 7.7.2016, bashkëlidhur ekstrakti; vërtetim nënshkrimi nr. ***, datë 21.11.2016 dhe vërtetim i njësisë me origjinalin nr. ***, datë 21.11.2016, të dokumentacionit në gjermanisht “vlerësim mbi tatimin mbi të ardhurat 2011 për I.H, datë 10.10.2012”, bashkëlidhur vlerësimi mbi tatimin mbi të ardhurat 2011; vërtetim nënshkrimi nr. ***, datë 21.11.2016 dhe vërtetim i njësisë me origjinalin nr. ***, datë 21.11.2016, të dokumentacionit në gjermanisht “vlerësim mbi tatimin mbi të ardhurat 2011 për I.H, datë 10.10.2012”, bashkëlidhur vlerësimi mbi tatimin mbi të ardhurat 2011; vërtetim nënshkrimi nr. ***, datë 21.11.2016.

- hua pa afat dhe pa interes nga shtetasi I.H (vëllai) në shumën 15.000 euro, e cila është marrë në gusht të vitit 2011 me qëllim blerjen e apartamentit.

18.3 ZVRPP-ja Tiranë¹⁴ konfirmon se në emër të z. Saimir Hysa figuron e regjistruar pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji apartament me sip. 71.2 m², në bashkëpronësi me znj. E.T.

Në praktikën e përcjellë, kjo drejtori ka bashkëlidhur: kartelën e pasurisë së paluajtshme, ku konfirmohet apartamenti me sip. 71.2 m² në emër të shtetasve Saimir Hysa dhe E.T, me datë regjistrimi 9.3.2014; vërtetimin nga dokumentet hipotekore datë 23.9.2011, për apartamentin me sip. 71.2 m², në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.; kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.10.2011, ku shtetasit Saimir Hysa dhe E.T blejnë nga shoqëria “****” sh.p.k. apartamentin me sip. 71.2 m², ndodhur në rrugën “****”, Tiranë. Çmimi i shitjes është 60.000 euro.

18.4 FSHU-ja¹⁵ informon se në emër të z. Saimir Z. Hysa identifikohet një abonent me kontratën e furnizimit nr. ***, në instancën Tiranë.

Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

18.5 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se si burim krijimi ka shërbyer tërheqja e shumave 400.000 lekë dhe 17.000 euro nga Intesa Sanpaolo Bank, shuma 25.000 euro nga Credins Bank dhe një hua prej 15.000 euro marrë prej vëllait të tij.

Komisioni hetoi për ligjshmërinë e secilit burim të krijimit të pasurisë.

18.5.1 Në lidhje me shumën 400.000 lekë, depozitë e përbashkët me znj. E.T në Intesa Sanpaolo Bank, hapur në maj të vitit 2011 dhe tërhequr e gjitha më 4.8.2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar¹⁶ se si burim krijimi i kësaj depozite kanë shërbyer të ardhurat nga punësimi (pagat dhe shpërblimet).

18.5.2 Nga korrespondenca e Komisionit me Intesa Sanpaolo Bank¹⁷ rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij E.T kanë hapur një llogari të përbashkët më 7.10.2010. Konstatohet se kjo llogari është furnizuar herë pas herë nëpërmjet transfertave të kryera nga llogaria personale e znj. T ose depozitime *cash* nga kjo e fundit.

18.5.3 Rezultoi se në datën 3.5.2011 shuma e akumuluar në llogarinë e përbashkët prej 400.000 lekësh është investuar në depozitë me afat 3-mujor. Pas maturimit dhe interesave të përfituara, nga kjo depozitë është tërhequr shuma 300.000 lekë nga znj. E.T, në datën 4.8.2011 dhe pjesa tjetër prej 103.761,07 lekësh është transferuar në llogarinë personale të znj. T.

18.6 Në lidhje me shumën 17.000 euro, kursime të znj. E.T në Intesa Sanpaolo Bank, tërhequr më 5.8.2011

18.6.1 Nga korrespondenca e Komisionit me Intesa Sanpaolo Bank¹⁸ rezulton se bashkëshortja e subjektit, znj. E.T, ka hapur një llogari në monedhën euro, duke depozituar fillimisht në datën 31.7.2006 shumën 4.000 euro. Në këtë llogari, që prej çeljes së saj në vitin 2006 e në vazhdim, janë kryer depozitime dhe tërheqje nga znj. T. Në datën 11.1.2011, shuma e akumuluar në këtë llogari prej 10.000 euro është investuar në depozitë, prej së cilës janë përfitur edhe interesa pas maturimit.

¹⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 8.11.2018, aneks nr. 29 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 23.10.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁶ Pyetësor nr. 2, datë 30.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 20.10.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 20.10.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

Në këtë llogari rezulton se znj. T. ka depozituar në datën 4.8.2011 shumën 4.000 euro dhe, më pas, në datën 5.8.2011 është kryer tërheqja e vlerës 17.000 euro, e akumuluar deri në atë datë në llogari.

18.6.2 Lidhur me këto kursime, Komisioni kreu analizën financiare për të parë mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij për të krijuar shumat 400.000 lekë dhe 17.000 euro, të cilat më pas janë tërhequr për të paguar një nga këstet e kësaj pasurie. Komisioni fillimisht analizoi derdhjen prej 4.000 euro në datën 31.7.2006, periudhë kjo kur subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në një bashkëjetesë me bashkëshorten e tij.

18.6.3 Komisioni e ka pyetur¹⁹ subjektin lidhur me burimin e krijimit të shumës 4.000 euro prej bashkëshortes së tij, i cili në përgjigje ka sqaruar: *“Burimi i krijimit të kësaj shume janë të ardhurat e bashkëshortes time E.T nga puna e saj pranë “***” sh.p.k., *** dhe “***” sh.a., për periudhën mars 1999 – korrik 2006, të cilat ajo i ka futur në një depozitë të vetme më 31.7.2006”*.

18.6.4 Subjekti ka depozituar vërtetimin mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto me shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2023, të lëshuar nga Drejtoria e Arkivit Qendror, ku konfirmohen të ardhurat e realizuara nga znj. E.T për periudhën dhjetor 2004 – tetor 2006.

18.6.5 Komisioni kreu analizën financiare (pasqyruar në tabelën nr. 4) për periudhën dhjetor 2004 – korrik 2006, kur është kryer depozitimi i shumës 4.000 euro. Komisioni në analizën financiare nuk ka konsideruar të ardhurat përpara kësaj periudhe, pasi nuk konfirmohen nga ISSH - Drejtoria e Arkivit Qendror.

Tabela nr. 4

Nr.	Përshkrimi	Dhjetor 2004 – 31.7.2006
1	Të ardhura nga paga + shpërblime ²⁰ E.T	689,712
2	Shpenzime jetese	181,287
3	Likuiditete në bankë ²¹	617,920
	Diferenca (1-2-3)	- 109,495

18.6.6 Nga analiza financiare e kryer, Komisioni konstatoi se dukej se bashkëshortja e subjektit nuk kishte pasur mundësi në shumën 109.495 lekë të depozitonte 4.000 euro, si dhe të përballonte shpenzimet jetike dhe, për pasojë, i kaloi subjektit barrën e provës²² për të provuar të kundërtën e rezultatit konstataues, si dhe të depozitonte dokumentacionin justifikues në mbështetje të shpjegimeve të tij.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

18.6.7 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera në prapësimet e tij, ka deklaruar: *“Sipas raportit në analizë financiare nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortes pranë shoqërisë “***” sh.p.k. për periudhën 3.3.1999 – 3.1.2001, ku ajo ka përfituar pagë në total shumën 550.000 lekë dhe në IPEP, ku në total ka përfituar pagë në total shumën 700.000 lekë. Mospagimi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga punëdhënësit e sipërpërmendur, gjë që ka qenë detyrim i tyre, nuk duhet të përbëjë shkak për mosnjohjen e këtyre të ardhurave, duke më penalizuar padrejtësisht, pasi bëhet fjalë për një periudhë për rreth 5 vjet dhe*

¹⁹ Me pyetësorin nr. 5, datë 15.5.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁰ Sipas vërtetimit nga “***”, datë 24.10.2016, në aneksin nr. 4/12, në dosjen e ILDKPKI-së.

²¹ Është përfshirë gjendja në llogarinë në lekë në Intesa Sanpaolo Bank, si dhe depozitimi prej 4.000 euro po në këtë bankë, i konvertuar me kursin e datës 31.7.2006, sipas arkivit të kursit të këmbimit në Bankën e Shqipërisë.

²² Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

*është e padrejtë të pretendohet se ajo ka qëndruar pa punuar dhe pa siguruar të ardhura për jetesë në moshën 24 - 29 vjeç”. Subjekti ka deklaruar se ka depozituar gjatë hetimit administrativ një kopje të librezës së punës së bashkëshortes së tij, hapur në janar të vitit 2007, në krye të së cilës figurojnë shënimet e administratorit të shoqërisë “***” sh.p.k., z. V.H, dhe ato të drejtorit ekzekutiv të IPEE-së, z. G.J.B, dhe më pas shënimet në vazhdimësi. Subjekti ka deklaruar se këto shënime janë hedhur në librezë shumë vite para se të fillonte procesi i rivlerësimit dhe kjo gjë duhet çmuar si provë me fuqi të lartë provuese për nga vjetërsia, por edhe për nga konteksti kohor kur është lëshuar. Subjekti ka deklaruar se bashkëshortja e tij ka nisur marrëdhëniet e punës që në datën 3.3.1999 (para njohjes me të) në shoqërinë “***” sh.p.k., fakt ky i provuar nga librezja e punës (dokument zyrtar me fuqi të plotë provuese). Subjekti deklaroi se: “Unë jam njohur me faktin që punëdhënësit e saj nuk i kanë paguar sigurimet shoqërore gjatë procesit të rivlerësimit. Duke qenë se bëhet fjalë për një kohë kur pagat nuk kalonin nëpërmjet sistemit bankar por paguheshin në cash, jam në pamundësi objektive për të vërtetuar, përveç me dokumentacionin e lëshuar nga punëdhënësi, pagesën e marrë nga bashkëshortja, por sigurisht ajo ka marrë pagesë sipas vërtetimeve të lëshuara, sepse është jologjike të mendohet se ajo ka punuar pa pagesë. Vërtetimet e shoqërive punëdhënëse të paraqitura gjatë hetimit administrativ, si dhe librezja e punës kanë vlerën e provës në lidhje me masën e pagës së dakordësuar mes punëdhënësve dhe punëmarrësit. Ndërsa, sa i takon vlerësimit të ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, në kuadër të standardit të vendosur nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pavarësisht se nga hetimi ka rezultuar se për këto të ardhura të krijuara nga bashkëshortja (përpara se të njihej me mua) nuk janë përmbushur detyrimet tatimore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, fakti që ky detyrim, referuar parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bie mbi palën punëdhënëse, unë si subjekt rivlerësimi dhe personi i lidhur, bashkëshortja, nuk mund të penalizohemi në kuadër të procesit të rivlerësimit, në drejtim të vlerësimit të ligjshmërisë së të ardhurave të realizuara nga punësimi, për sa kohë mospërmbushja e detyrimeve të palës punëdhënëse nuk ka qenë e ditur as nga unë dhe as nga bashkëshortja. Në kuadër të vlerësimit të qenies në mirëbesim të bashkëshortes në lidhje me pagesat e detyrimeve që lindin nga paga, Komisioni duhet të mbajë në konsideratë faktin që punëdhënësit kanë bërë shënimet në librezën e punës, dokument i cili plotësohet pikërisht nga punëdhënësi për shkak të vjetërsisë në punë, meqenëse ky i fundit është subjekti përgjegjës i ngarkuar nga ligji për pagesën edhe të sigurimeve shoqërore (si dhe detyrimeve tatimore). Punëdhënësit, për efekt dokumentacioni, konfirmonin pagën e marrë nga ana e bashkëshortes, çka duhet të vlerësohet nga Komisioni se personi i lidhur me mua si subjekt rivlerësimi nuk ka qenë në kushtet për të vënë në dyshim se lidhur me pagesat e përfituara nga punësimi i tij nuk ishin shlyer nga punëdhënësit detyrimet me natyrë tatimore ndaj shtetit. Të njëjtin qëndrim si më sipër ka mbajtur në disa vendimmarrje edhe Kolegji i Posaçëm i Apelit (vendimi nr. 35/2022, vendimi nr. 4/2023 etj.)”. Subjekti ka paraqitur analizën financiare, për të cilën saktëson se janë përfshirë të ardhurat nga punësimi në shoqërinë “***” sh.p.k. dhe IPEE dhe sqaron se nga analiza rezulton se bashkëshortja ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës 4.000 euro. Subjekti sqaron: “Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar gjatë hetimit administrativ, argumentet e sipërcituara, jurisprudencën e Kolegjit, si në faktin që balanca negative është e vogël mendoj se bashkëshortja ime i ka pasur tërësisht mundësitë që të kursejë shumën 4.000 euro, të depozituar prej saj në datën 31.7.2006, kursime të realizuara prej saj në një periudhë më shumë se 7-vjeçare”.*

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

18.6.8 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve dhe dokumentacionit të depozituar, çmon të konsiderojë si dokumente provuese të marrëdhënies së punësimit të bashkëshortes së subjektit të

rivlerësimit librezën e punës dhe vërtetimin e pagës mujore nga punëdhënësi i ngarkuar me pagimin e detyrimit tatimor. Në vlerësim të këtyre provave, faktit që të ardhurat nga punëdhënësi janë kaluar në rrugë bankare dhe, për pasojë, pagimi i kontributeve ka qenë detyrim i punëdhënësit²³, si dhe faktit se këto të ardhura datojnë përpara njohjes së subjektit me bashkëshorten e tij dhe se balanca negative e rezultuar është në një masë të papërfillshme, trupi gjykues i çmon këto fakte e rrethana në harmoni me njëra-tjetrën dhe në përfundim konkludon se nuk përbëjnë shkak për të penalizuar subjektin e rivlerësimit.

18.6.9 Në vijim, Komisioni, lidhur me kursimet e deklaruara, dhe konkretisht lidhur me krijimin e shumës 400.000 lekë, si dhe shtimin e kursimeve në shumën 17.000 euro, analizoi periudhën 2006 – 2010, duke kryer përlllogaritjet përkatëse për të verifikuar mundësitë e kursimit në raport me shpenzimet e identifikuar në këtë periudhë. Nga analiza financiare e kryer përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi të krijojnë kursimet e tyre.

18.6.10 Nga hetimi i kryer, Komisionit i rezultoi se nga depozita prej 400.000 lekësh është tërhequr shuma 300.000 lekë nga znj. E.T, në datën 4.8.2011 dhe pjesa tjetër prej 103.761,07 lekësh është transferuar në llogarinë personale të znj. T. Njëkohësisht rezultoi se znj. T. ka depozituar në datën 4.8.2011 shumën 4.000 euro, e cila duket se vjen si rezultat i dy tërheqjeve të kryera më 4.8.2011 nga llogaria në monedhën lekë, konkretisht shumat 259.600 lekë dhe 300.000 lekë. Shuma e këtyre dy tërheqjeve në monedhën lekë, duke u konvertuar me kursin e këmbimit të kohës, duket se krijon vlerën 4.000 euro, të depozituar në po të njëjtën datë me dy tërheqjet e kryera nga llogaria në lekë. Lidhur me këto transaksione, Komisioni e ka pyetur subjektin²⁴, pasi dukej se në total ishin tërhequr vetëm shuma 17.000 euro, ndërkohë që kësti ishte paguar në shumën 20.000 euro.

18.6.11 Subjekti në përgjigje ka sqaruar: *“Pavarësisht datave të njëjta kur kanë ndodhur këto transaksione, pasi po grumbullojmë shumën prej 20.000 euro për të paguar këstin e parë, shuma prej 4.000 euro e depozituar për të plotësuar vlerën 17.000 euro, që është tërhequr në datën 5.8.2011 ishte e akumuluar në banesë deri në atë datë. Tërheqjet e kryera gjatë vitit nga llogaritë tona personale, unë dhe bashkëshortja ime i kemi konvertuar në momente të ndryshme gjatë vitit, kur kursi i këmbimit ka qenë i volitshëm dhe më pas e kemi depozituar në bankë. Ndërsa shuma prej 400.000 lekësh pas tërheqjes është konvertuar për të plotësuar vlerën e këstit që kemi paguar në datën 5.8.2011, prej 20.000 euro”*.

18.6.12 Komisioni ka pasqyruar në tabelën e mëposhtme analizën financiare me përlllogaritje deri në datën e pagesës së këstit të parë prej 20.000 euro, kryer sipas mandatarkëtimit nr. ***. Në zërin “Shpenzime” për këtë periudhë, Komisioni ka përlllogaritur si shpenzime të përballuara prej subjektit të rivlerësimit shpenzimin e kryer për udhëtimin jashtë vendit në datën 23.1.2011, për të cilin subjekti ka deklaruar se është udhëtim pune, trajnim në Romë, Itali, por nuk ka depozituar dokumentacion justifikues.

18.6.13 Nga përlllogaritjet e kryera Komisioni konstatoi se dukej se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 135.911 lekë të paguajë këstin e kësaj pasurie, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare dhe, për pasojë, i kaloi²⁵ barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

²³ Referuar vendimit të Kolegjit nr. 34/2022, datë 21.9.2022.

²⁴ Me email-in datë 25.5.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁵ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

18.6.14 Në qëndrimin e tij subjekti ka sqaruar se udhëtimi në Itali është kryer në periudhën 23.1.2011 – 30.11.2011, i cili ka qenë për qëllim trajnimi profesional pranë Guardia di Finanza në Itali, periudhë në të cilën ai dhe tre kolegë janë akomoduar në hotelin/konviktin e shkollës së Guardia di Finanza në Lido di Ostia, Romë, pa pagesë. Subjekti ka shpjeguar se shpenzimet e udhëtimit janë paguar nga Prokuroria e Përgjithshme ku kanë marrë edhe dietat në shumën 50 euro në ditë, me të cilat kanë paguar shpenzimet për ushqim. Për të provuar këtë fakt subjekti ka depozituar urdhrin nr. ***, datë 18.11.2011, të Prokurores së Përgjithshme I.R. Subjekti ka sqaruar se duke qenë se ky urdhër provon tërësisht faktin se për këtë udhëtim nuk ka pasur shpenzime, ka kërkuar që nga shuma 135.911 lekë të zbriten shpenzimet e këtij udhëtimit, që janë llogaritur në 480 euro, të cilat me kursin e vitit 2011 (sipas arkivit të kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë) është në shumën 480 x 138.6 = 66.528 lekë. Lidhur me diferencën e mbetur prej 69.383 lekësh, subjekti ka deklaruar se kjo shumë nuk duhet të konsiderohet si pamundësi financiare, pasi në analizë nuk është marrë parasysh fakti se bashkëshortja e tij ka disponuar kursime gjendje *cash* në banesë çdo vit, që i ka çdo familje, të cilat nuk i ka deklaruar, pasi nuk ka qenë subjekt deklarues deri në ndryshimin e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë” në vitin 2012. Subjekti ka deklaruar se ai dhe bashkëshortja kanë lidhur martesë në qershor të vitit 2013 dhe nga viti 2006 deri në qershor 2013 ajo ka qenë bashkëjetuesja e tij. Ai ka deklaruar se *ajo ka pasur një punë me pagë të kënaqshme dhe burime të ligjshme të mjaftueshme për të kursyer dhe çdo vit ka pasur kursime cash, që ai sot nuk mund të përcaktojë saktë shumat e kursyera, por deri në momentin që kanë blerë banesën ka kursyer mesatarisht 100.000 lekë çdo vit. Kështu, deri në fund të vitit 2010 ajo ka kursyer një shumë ndjeshëm më të lartë se balanca negative e mbetur prej 69.383 lekësh.*

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

18.6.15 Trupi gjykues arsyeton për këtë çështje në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të depozituar prej tij. Në këtë këndvështrim rezultoi se në urdhrin nr. ***, datë 18.1.2011, lëshuar nga Prokuroria e Përgjithshme, për kursin që do të zhvillohej në datat 24.1.2011 deri më 28.1.2011, emri i subjektit të rivlerësimit renditet në listën e pjesëmarrësve dhe po ashtu thuhet se të gjitha shpenzimet e këtij trajnimi mbulohen nga institucioni. Në këto kushte, Njësia e Shërbimit Ligjor kreu rillogaritjet duke zbritur nga shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit këtë udhëtim pune, të cilin subjekti e provoi me dokumentacionin përkatës. Nga analiza rezultoi që balanca negative nga 135.911 lekë shkoi në 69.527 lekë. Duke qenë se lidhur me këtë balancë subjekti ka pretenduar që bashkëshortja në këtë periudhë ka qenë bashkëjetuesja e tij dhe për shkak të ligjit të kohës ajo nuk mbartte detyrimin për deklarim, por sigurisht që mund të kishte siguruar gjendje *cash*, trupi gjykues çmon ta konsiderojë këtë sqarim dhe pretendim të subjektit dhe të neutralizojë këtë balancë të ulët negative vetëm me 69.527 lekë me kursimet e krijuara prej saj, për më tepër që viti kalendarik 2010 është mbyllur me balancë pozitive nga ana e subjektit dhe bashkëjetueses së tij.

18.6.16 Në lidhje me kredinë bankare në shumën 25.000 euro, marrë nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij në Credins Bank me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.11.2011, me palë kredihënëse Credins Bank, kredimarrës Saimir Hysa dhe dorëzanëse E.T.

i. Nga korrespondenca e Komisionit me Credins Bank²⁶ rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka marrë një kredi hipotekore në nëntor të vitit 2011. Kontrata e kredisë është lidhur më 1.11.2011, me qëllim blerje apartamenti.

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 20.10.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

ii. Rezultoi se për kredinë e marrë është lidhur gjithashtu edhe kontratë hipotekimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.11.2011, ku në hipotekë është vendosur pasuria apartament, objekt vlerësimi.

iii. Nga analizimi i *statement*-it rezulton se kredia është disbursuar në datën 11.11.2011 dhe më 15.11.2011 shuma 25.000 euro është transferuar për llogari të shoqërisë ndërtimore “****” sh.p.k., me përshkrimin “Kalim për blerje apartamenti Hysa Saimir”.

iv. Meqenëse kontrata e kredisë ishte lidhur më 1.11.2011 dhe kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie ishte nënshkruar në datën 15.10.2011, në të citohej se çmimi i shitjes prej 60.000 euro ishte shlyer jashtë zyrës noteriale, Komisioni i kërkoi²⁷ shpjegime subjektit mbi këtë fakt. Subjekti i rivlerësimit në përgjigje ka sqaruar: *“Shuma prej 25.000 euro, sipas kredisë së sipërcituar, ka qenë një nga burimet financiare të përdorura për blerjen e kësaj pasurie. Kjo citohet edhe në nenin 2 të kontratës, ku theksohet se qëllimi i marrjes së kësaj kredie është “blerje apartamenti”. Në të njëjtën datë që është lidhur kontrata e kredisë është lidhur edhe kontrata për hipotekimin e pasurisë të blerë në favor të Credins Bank, si garanci për shlyerjen e kësaj kredie. Kjo kredi i ka kaluar në rrugë bankare shitësit “****” sh.p.k. dhe nuk është përdorur nga ne për asnjë qëllim tjetër. Noteri në citimin e bërë se “palët kanë deklaruar se është paguar jashtë zyrës në noteriale” nuk ka vërtetuar kryerjen e pagesës së plotë prej 60.000 euro, por thjesht ka cituar atë që i kanë deklaruar palët dhe unë personalisht nuk merrja përsipër asnjë risk nga ky citim standard i noterit.*

Ka qenë një kërkesë standarde e bankës që paraprakisht të lidhej kontrata e shitjes, pasi në bazë të vlerës së kontratës së shitjes bëhej edhe përlllogaritja e vlerës së kredisë, pasi banka financon deri në një vlerë të caktuar të blerjes dhe në bazë të aftësive paguese-shlyese, si dhe për të bërë të mundur vendosjen e pasurisë si kolateral për këtë kredi. Mes palëve ka ekzistuar një marrëdhënie besimi, për më tepër që për dhënie e kredisë banka kërkonte që prona të ishte regjistruar në emër të marrësit dhe më pas të vendosej si kolateral. Prona është regjistruar në emrin tonë më 21.10.2011 dhe më pas është vendosur si kolateral për marrjen e kredisë. Të gjitha veprimet janë reale dhe të kryera në rrugë bankare dhe të dokumentuara me akte noteriale”.

18.6.17 Komisioni hetoi në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi midis subjektit të rivlerësimit për shkak të ushtrimit të funksionit të tij dhe shoqërisë ndërtimore “****” sh.p.k., si dhe administratorit të saj, shtetasit A.L.

Në përgjigjen e dhënë²⁸ subjekti ka deklaruar: *“Gjatë gjithë periudhës që kam ushtruar detyrën e prokurorit nuk kam hetuar apo gjykuar çështje me shoqërinë “****” sh.p.k., si dhe shtetasin A.L”.* Subjekti ka depozituar shkresën²⁹ e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku citohet se nuk rezulton që ndaj shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit A.L të jenë regjistruar kallëzime apo procedime të hetuara nga prokurori Saimir Hysa.

18.6.18 Komisioni hetoi gjithashtu në lidhje me ndonjë trajtim të mundshëm preferencial në përfitimin e kësaj pasurie. Komisioni i është referuar udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2011”. Sipas këtij udhëzimi rezulton se kostoja e shitjes në tregun e lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës, në zonën *** ku ndodhet pasuria e subjektit, është 91.900 lekë/m² sipërfaqe e shfrytëzueshme. Apartamenti i porositur nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2011 është me sipërfaqe 71.2 m². Duke u bazuar në çmimet referuese rezulton se vlera e apartamentit është 6.543.280 lekë (71.2 m² x 91.900 lekë/m²). Kjo vlerë rezulton më e ulët nga çmimi që ka paguar subjekti, pasi

²⁷ Pyetësor nr. 2, datë 30.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁸ Me pyetësorin nr. 2, datë 30.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁹ Nr. *** prot., datë 22.5.2023 dhe nr. *** prot., datë 19.5.2023, me pyetësorin nr. 6, datë 15.5.2023.

apartamenti është blerë në vlerën 8.298.000 lekë³⁰. Nën këtë analizë të bazuar në fakte e prova duket se nuk ekziston ndonjë trajtim preferencial i mundshëm në blerjen e kësaj pasurie nga subjekti, për sa kohë që ajo është blerë më shtrenjtë sesa çmimet referuese.

18.6.19 Komisioni, duke konstatuar se: (i) sipas kontratës së shitjes datë 15.10.2011, shuma 60.000 euro është likuiduar jashtë zyrës noteriale; (ii) kontrata e kredisë në shumën 25.000 euro është nënshkruar në datën 1.11.2011 dhe disbursimi i saj është bërë në datën 11.11.2011; (iii) në datën 15.11.2011, shuma 25.000 euro është transferuar për llogari të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., me përshkrimin “Kalim për blerje apartamenti Hysa Saimir”, deri në fazën e mbylljes së rezultateve të hetimit – i kaloi subjektit barrën e provës, lidhur me konstatimin se: (a) dukej se kjo pasuri është likuiduar përpara marrjes së kredisë; (b) dukej se vlera reale e kësaj pasurie është shuma 60.000 euro, si dhe kredia prej 25.000 euro, referuar parashikimit kontraktor nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.10.2011, ku deklarohet se shuma 60.000 euro është likuiduar jashtë zyrës noteriale, si dhe faktit se kredia është disbursuar pas një muaji.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

18.6.20 Në qëndrimin e tij subjekti ka ripërsëritur thujtë të njëjtin deklaram të bërë më parë në pyetësorin nr. 2, datë 12.4.2023. Ndër të tjera, subjekti ka sqaruar se kjo kredi hipotekore është marrë prej tij dhe bashkëshortes në Credins Bank me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.11.2011, me palë dhënëse Credins Bank, marrës Saimir Hysa dhe dorëzanëse E.T, me qëllim blerje apartamenti. Për kredinë e marrë është lidhur gjithashtu edhe kontratë hipotekimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.11.2011, ku hipotekë është vendosur pasuria - apartamenti që do të blihej. Nga analizimi i *statement*-it rezulton se kredia është disbursuar në datën 11.11.2011 dhe më 15.11.2011 shuma 25.000 euro është transferuar për llogari të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., me përshkrimin “Kalim për blerje apartamenti Saimir Hysa”. Në vijim ai ka sqaruar se shuma prej 25.000 euro ka qenë një nga burimet financiare të përdorura për blerjen e kësaj pasurie. Ai ka deklaruar se kjo citohet edhe në nenin 2 të kontratës së kredisë, ku theksohet se qëllimi i marrjes së kësaj kredie është “Blerje apartamenti”. Subjekti ka theksuar: *“Në të njëjtën datë që është lidhur kontrata e kredisë është lidhur edhe kontrata për hipotekimin e pasurisë të blerë në favor të Credins Bank si garanci për shlyerjen e kësaj kredie. Kjo kredi i ka kaluar në rrugë bankare shitësit “****” sh.p.k. dhe nuk është përdorur nga ne për asnjë qëllim tjetër. Ka qenë një kërkesë standarde e bankës që paraprakisht të lidhej kontrata e shitjes, pasi në bazë të vlerës të kontratës së shitjes bëhej edhe përllogaritja e vlerës së kredisë, pasi banka financon deri në një vlerë të caktuar të blerjes, në rastin konkret deri në 70% dhe në bazë të aftësive paguese-shlyese, si dhe për të bërë të mundur vendosjen e pasurisë si kolateral për këtë kredi, për të cilën gjithashtu Credins Bank kërkonte një mbulim të kredisë së dhënë me kolateral në masën mbi 130%”*. Subjekti ka deklaruar se kërkohej që detyrimisht pasuria të ishte e regjistruar në emër të kredimarrësit ose garantuesit dhe disbursimi i kredisë bëhej vetëm pasi paraqitej nga kredimarrësi dokumenti i bllokimit të pronës së vënë si kolateral në favor të bankës. Subjekti ka deklaruar se mes palëve ka ekzistuar një marrëdhënie besimi reciprok dhe pas nënshkrimit të kontratës në datën 15.10.2021 prona është regjistruar në emrin e tyre më 21.10.2011 dhe më pas është vendosur si kolateral për marrjen e kredisë me të cilën do të paguhej edhe pjesa e mbetur prej 25.000 euro. Subjekti ka sqaruar se të gjitha veprimet janë reale dhe të kryera në rrugë bankare dhe të dokumentuara me akte noteriale.

18.6.21 Subjekti ka konfirmuar se për blerjen e kësaj banese ai dhe bashkëshortja kanë paguar vetëm çmimin e përcaktuar në kontratë 60.000 euro, 35.000 + 25.000. Ai ka theksuar se: *“Çdo dyshim se*

³⁰ 60.000 euro e konvertuar me kursin mesatar për vitin 2011, sipas Bankës së Shqipërisë.

nga ne është paguar shuma 60.000 + 25.000 euro, nuk qëndron, dhe argumentin më bindës për këtë unë e gjej në raportin tuaj”.

Subjekti ka theksuar edhe konstatimin e rezultuar nga hetimi i Komisionit se në blerjen e kësaj banese nuk ka pasur asnjë trajtim preferencial ndaj tij. Ai ka vënë në dukje faktin se Komisioni ka konstatuar se banesa është blerë me një çmim dukshëm më të lartë se çmimet referuese të përcaktuara në udhëzimin nr. 4, datë 23.11.2011, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2011”. Subjekti ka shpjeguar se sipas këtij udhëzimi rezulton se kostoja e shitjes në tregun e lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës, në zonën *** ku ndodhet pasuria që ai ka blerë, është 91.900 lekë/m² sipërfaqe e shfrytëzueshme. Subjekti ka sqaruar në detaje mbi çmimet referuese. Ai ka deklaruar: “...Apartamenti i porositur nga unë dhe bashkëshortja ime është me sipërfaqe 71.2 m². Duke u bazuar në çmimet referuese rezulton se vlera e apartamentit është 6.543.280 lekë (71.2 m² x 91.900 lekë/m²), vlerë që rezulton dukshëm më e ulët nga çmimi që ka paguar subjekti, pasi apartamenti është blerë në vlerën 60.000 euro/8.298.000 lekë³¹/116.544 lekë m². Në rast se do të supozohej se unë përveç shumës prej 60.000 euro kam paguar edhe 25.000 euro përmes kredisë bankare, atëherë çmimi i kësaj banese do të shkonte 85.000 x 138.6 = 11.781.000 lekë, me një çmim për m² - 165.463 lekë, çmim shumë më i lartë se çmimi i tregut në atë kohë dhe më i lartë se çmimi i referencës, edhe sot pas 12 vjetësh, që është 132.000 lekë (VKM Nr. 132, datë 7.3.2018). Ky fakt provon në mënyrë të pakundërshtueshme se shuma prej 25.000 euro është e përfshirë në çmimin e përgjithshëm prej 60.000 euro, me të cilin është blerë kjo banesë dhe ka shërbyer si burim për blerjen e saj. Unë mendoj se duke nënshkruar kontratën e shitjes të datës 15.10.2011, të formuluar në atë mënyrë, nuk kam shkelur asnjë ligj, nuk kam thyer asnjë kod etik apo moral të magjistratit dhe nuk kam dëmtuar apo prekur interesat e shtetit apo të ndonjë personi fizik apo juridik dhe kam qenë korrekt në detyrimet që kam marrë përsipër. Asnjë palë e përfshirë në këtë marrëdhënie juridike nuk ka ngritur ndonjë pretendim ndaj meje dhe për çdo veprim të kryer nga shteti janë paguar taksat përkatëse, nga unë taksa për marrjen e kredisë në masën 1% të shumës së saj apo dhe atë që ka paguar shitësi”.

Subjekti ka depozituar: (a) deklaratë noteriale të detajuar lidhur me rrethanat dhe çmimin e blerjes së këtij apartamenti, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.6.2023, noter A.S, të ish-administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., z. A.L, për të cilën sqaron se është konfirmuar plotësisht sa ai ka shpjeguar më sipër se prej tij është paguar në total vetëm shuma 60.000 euro; (b) Manual për Politikën dhe Procedurat e Kredisë për Individë të Credins Bank, të vitit 2011, ku në pikën 4/3 të saj përcaktohet se “Garancia do të jetë hipoteka e radhës së parë mbi një pasuri të paluajtshme në pronësi të kredimarrësit ose garantuesit”. Subjekti ka sqaruar se kjo provon deklarin e tij se ai dhe shitësi i pronës kanë vepruar në bazë të procedurave që kërkonte banka, që lidheshin me nënshkrimin e kontratës përfundimtare të shitjes, regjistrimin e pronës në emër të blerësit dhe më pas hipotekimin e saj për llogari të garantimit të kredisë. Subjekti ka vijuar të deklarojë se më pas banka do të bënte kalimin e shumës së kredisë tek shitësi i pronës dhe në këtë moment mbyllej pagesa e plotë. Për të provuar këtë fakt subjekti ka dorëzuar edhe 3 kontrata³² të tjera të blerjes së apartamenteve, po në këtë pallat, të lidhura në tetor të vitit 2011, në të njëjtin muaj me të.

Subjekti ka cituar konkretisht vendimin nr. ***, datë 24.11.2022 dhe vendimin nr. ***, datë 7.6.2019, të dy subjekteve të rivlerësimit, duke shtuar që të dy këta shtetas banojnë në të njëjtën

³¹ 60.000 euro e konvertuar me kursin mesatar për vitin 2011, sipas Bankës së Shqipërisë.

³² Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.10.2011, shitës “****” sh.p.k. dhe blerës “X”, me çmim shitjeje për metër katror 97.832 lekë ose 705 euro; kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2011, shitës “****” sh.p.k. dhe blerës “X”, me çmim shitjeje për metër katror 88.000 leke ose 634 euro; kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.10.2011, shitës “****” sh.p.k. dhe blerës “X”, me çmim shitjeje për metër katror 124.700 lekë ose 900 euro.

shkallë ku ndodhet apartamenti në pronësinë e tij dhe në të dyja rastet çmimi i blerjes së banesave prej tyre, ku të dy e kanë blerë në një vit me të, 2011, është më i ulët se ai që e ka blerë ai. Subjekti i parë me një çmim prej 92.902 lekësh - 670 euro/m² dhe subjekti i dytë 9.646.000 lekë, 110.302 lekë ose 798 euro/m². Subjekti i rivlerësimit beson se trupi gjykues mbi këto fakte do të krijojë bindjen se çmimi i vetëm dhe real i blerjes së këtij apartamenti ka qenë 60.000 euro = 8.316.000 lekë, aq sa citohet edhe në kontratë, me një çmim për metër katror prej 842 euro ose 116.797 lekë.

Subjekti ka deklaruar se në 5 raste që citoi, çmimi për metër katror është 634, 640, 705, 798, 900 euro, në një kohë që me çmimin 60.000 euro ai ka pasur një çmim prej 842 euro/m², kurse me çmimin 85.000 euro (60.000 + 25.000) çmimi për metër katror shkon 1.193 euro. Subjekti shprehet se është e pabesueshme që ai të ketë blerë banesë në atë kohë me këtë çmim që shkon 50-100% më i lartë nga referencat që solli, duke “abuzuar” me detyrën që të rrisë çmimin e pronës që ka blerë.

Subjekti ka deklaruar se gjatë punës së Komisionit kjo situatë është hasur rëndom në shqyrtimin e çështjeve të subjekteve të tjera, ku kjo praktikë nuk është gjetur penalizuese as nga Komisioni dhe as nga Kolegji. Subjekti ka cituar disa vendime të Komisionit³³, ku ai është ndodhur në të njëjtën situatë me ta lidhur me marrjen e kredisë pas lidhjes së kontratës, në të cilën është shënuar se është likuiduar e gjithë shuma. Në të gjitha këto raste Komisioni ka pranuar se lidhja e kontratës në këtë mënyrë nuk ka cenuar besimin e publikut tek drejtësia, duke i konfirmuar në detyrë me të drejtë këto subjekte, por edhe në rastet kur janë shkarkuar nuk ka qenë ky shkaku i shkarkimit. Subjekti beson se do të ketë edhe raste të tjera të kësaj natyre, gjë që tregon se kjo ka qenë një mënyrë të vepruari normale për kohën. Subjekti është shprehur i bindur mbi pasjen e njohurive lidhur me këtë fakt dhe për të gjithë argumentet dhe faktet e sipërpërmendura e konsideron edhe këtë barrë prove të përmbysur dhe njëkohësisht i konsideron shpjegimet bindëse dhe shteruese.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

18.6.22 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, provave e rrethanave të konstatuara, si dhe dokumentacionit të depozituar prej tij, arsyeton si vijon:

- Duke iu referuar kontratës së shitjes datë 15.10.2011, rezulton se shuma 60.000 euro është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Vetëm dy javë më pas, në datën 1.11.2020, është nënshkruar kontrata e kredisë për shumën 25.000 euro. Faktet: (i) që kjo kredi ka si qëllim blerje apartamenti; (ii) po kjo pasuri është lënë kolateral për sigurimin e shlyerjes së saj; (iii) kredia pas disbursimit ka kaluar në rrugë bankare në favor të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., me përshkrimin “Kalim për blerje apartamenti Hysa Saimir” – përbëjnë provën e pakontestueshme të përfitimit të një pasurie të vetme, për të cilën trupi gjykues nuk ngre ndonjë dyshim të arsyeshëm. Sa i përket çmimit të paguar për këtë pasuri, trupi gjykues çmon se në raport vetëm me kontratën e shitjes realizuar nga palët pak kohë përpara disbursimit të kredisë, konkurrojnë disa fakte e prova, të cilat konfirmojnë shumën e pasqyruar në kontratë se kjo pasuri është blerë në shumën 60.000 euro. Trupi gjykues, duke iu referuar kontratave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, vëren se qëndrojnë pretendimet e subjektit se blerës të tjerë në të njëjtën godinë, në të njëjtin vit, për sipërfaqe të njëjta apo edhe të ndryshme, të cilët kanë blerë tek e njëjta shoqëri ndërtuese, përfshirë këtu edhe subjekte rivlerësi, për të cilët Komisioni është shprehur me vendimmarrje, rezultojnë që kanë paguar shumën edhe më të vogla (Ilogaritur në metër katror për sipërfaqe) se sa ka paguar subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri. Ky fakt duket se tejkalon çdo dyshim lidhur me çmimin për metër katror të sipërfaqes së

³³ Vendim nr. ***, datë 7.6.2021, për subjektin e rivlerësimit V. Ç.; vendim datë 12.6.2023, për subjektin e rivlerësimit Y. B.; vendim nr. ***, datë 12.1.2021, për subjektin e rivlerësimit L. Z., ankimuar nga KP për shkaqe të tjera; vendim nr. ***, datë 22.12.2022, për subjektin e rivlerësimit E. M.; vendim nr. ***, datë 1.11.2022, për subjektin e rivlerësimit E. K.

pasurisë objekt hetimi dhe nuk mund të rëndojë subjektin në një shpenzim i cili nuk i përgjigjet realitetit sipas fakteve të dala nga hetimi.

Në përmbyllje të këtij arsyetimi çmohet edhe fakti se Komisionit nga hetimi nuk i rezultoi se subjekti të ishte trajtuar me çmim preferencial për këtë pasuri, nuk u gjend në ndonjë situatë të konfliktit të interesit me shoqërinë ndërtimore për shkak të detyrës dhe as nuk u identifikuan pagesa të tjera të padeklaruara nga subjekti për këtë pasuri, përveç shumës 60.000 euro.

18.7 Në lidhje me huan e marrë shtetasit A.H, në shumën 25.000 euro

18.7.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2011 se ka marrë hua nga shtetasi A.H.H për të shlyer kredinë prej 25.000 euro, të marrë në Credins Bank.

18.7.2 Së bashku me deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratën noteriale³⁴ nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.1.2017, në të cilën shtetasi A.H.H deklaroi: “...Në vitin 2011 i kam dhënë një hua në shumën 25.000 euro z. Saimir Hysa, me qëllim shlyerjen e një kredie që ai kishte marrë pranë Credins Bank. Kjo hua është dhënë nëpërmjet një transferte bankare. Kjo hua është dhënë pa afat dhe pa asnjë interes, me qëllim për të ndihmuar z. Saimir Hysa për blerjen e banesës nisur nga marrëdhëniet tona të miqësisë së vjetër që ne kemi. Huaja do të shlyhej prej tij sipas mundësive. Sot, në datën 25.1.2017, deklaroj se z. Saimir Hysa e ka shlyer tërësisht këtë hua dhe nuk ka asnjë detyrim ndaj meje”.

18.7.3 Komisioni i ka kërkuar³⁵ subjektit të deklarojë marrëdhënien me z. H, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së marrë hua nga ky shtetas. Subjekti ka deklaruar: “Me shtetasin A.H nuk kam asnjë lidhje familjare, krushqie apo të natyrës profesionale. Me të më lidh një miqësi e thellë të krijuar që në fillim të viteve '90 dhe deri më sot. Lidhur me huan e marrë prej tij ka qenë vetë ky shtetas që më është vetofruar për të zëvendësuar kredinë që sapo kisha marrë me një hua pa interes dhe pa afat, me qëllimin e vetëm për të më ndihmuar, pasi në aspektin ekonomik do të kisha përfitim nisur nga fakti se nuk do të më duhej të paguaja interes mbi huan, si dhe shlyerja e saj do të bëhej në mirëkuptim mes nesh”. Ndërsa, lidhur me burimin e krijimit, subjekti ka sqaruar se: “Burimi i ligjshëm i kësaj huaje janë të ardhurat që huadhënësi A.H ka pasur nga puna e tij si Drejtor Ekzekutiv në ISB. ...Ky shtetas ka pasur edhe të ardhura të tjera të konsiderueshme nga veprimtaria e tij si person i njohur publik në media apo të ardhura nga trashëgimitë si pasardhës i një familjeje ish-pronarësh të mëdhenj, por besoj se në proporcion me huan e dhënë të ardhurat e përftuara nga puna në ISB janë plotësisht të mjaftueshme”.

18.7.4 Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka depozituar vërtetimin³⁶ e lëshuar nga ISB, i cili konfirmon punësimin e shtetasit A.H pranë këtij institucioni prej vitit 1999. Në vërtetim citohet se të ardhurat bruto nga punësimi për periudhën dhjetor 1999 – nëntor 2011 janë në vlerën 27.260.420 lekë. Nga këto të ardhura bruto janë mbajtur dhe derdhur sigurimet shoqërore, shëndetësore, si dhe tatimet përkatëse. Paga neto i është transferuar rregullisht në llogarinë e tij bankare në Intesa Sanpaolo Bank. Gjithashtu, subjekti ka depozituar edhe një ekstrakt për gjendjen e llogarisë bankare të këtij shtetasi të lëshuar nga Intesa Sanpaolo Bank, sipas të cilit gjendja e llogarisë së shtetasit A.H në euro pranë kësaj banke, më 1.12.2011, ka qenë 75.207, në USD ka qenë 38.506 dhe në lekë 5.412.177.

18.7.5 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se kjo hua është dhënë nëpërmjet transaksionit bankar. Rezultoi se shtetasi A.H.H ka transferuar nga llogaria e tij në Intesa Sanpaolo Bank në llogarinë e

³⁴ Aneks nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁵ Pyetësor nr. 2, datë 30.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

³⁶ Nr. ***prot., datë 7.4.2023, depozituar me pyetësorin nr. 2, datë 30.3.2023.

subjektit të rivlerësimit në Credins Bank shumën 25.000 euro, në datën 28.12.2011, me përshkrimin “Hua pa interes”.

Nga verifikimi përkatës rezultoi se subjekti këtë shumë e ka përdorur në datën 3.1.2012, për të mbyllur kredinë e marrë në Credins Bank.

18.7.6 Komisioni, nga analizimi i llogarisë bankare të shtetasit A.H në Intesa Sanpaolo Bank, vërejtje se vërtetohet kalimi çdo muaj i pagës prej 270.000 lekësh. Rezultoi se në llogaritë e z. H. ka kreditime edhe në shuma më të larta, jo vetëm prej pagës mujore, por edhe për honorare apo pagesa të tjera për shkak të profesionit të tij.

18.7.7 Komisioni thelloi hetimin lidhur me këtë çështje, referuar edhe gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar³⁷.

18.7.8 Komisionit, nga riverifikimi i vërtetimit të pagave nga ISB, i rezultoi se për vitin 2011 paga mujore bruto e z. H. ishte në vlerën 300.000 lekë. U konstatua se kjo e dhënë përputhej edhe me formularin DIVA, ku ishin deklaruar të ardhura bruto vjetore në vlerën 3.600.000 lekë (pra 12 muaj x 300.000 lekë).

18.7.9 Në përllogaritjet e kryera, Komisioni nuk përfshiu asnjë të ardhur nga aktivitetet tregtare të z. H., por përllogaritjet janë kryer vetëm me të ardhurat e vitit 2011 nga paga.

18.7.10 Komisioni konstatoi se raportimet nga bankat për veprimet/transaksione që ky shtetas kishte kryer në llogarinë e tij bankare ishin kryesisht depozitime, me përshkrim “Kursime ose transfertat brenda llogarive”.

18.7.11 Nga korrespondenca e Komisionit me DPT-në rezultoi kjo e fundit, nëpërmjet Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë (shkresë nr. *** prot., datë 1.12.2020), informonte se z. H. është i regjistruar si individ privat për përgjegjësinë tatimore, Deklarim Individual Vjetor i të Ardhurave (DIVA). Në vijim, informacioni tregonte se ky shtetas ka depozituar deklaratën individuale të të ardhurave për vitin 2011, nga ku rezulton se:

- të ardhurat bruto nga paga apo shpërblime nga marrëdhëniet e punësimit janë në vlerën 3.600.000 lekë;
- të ardhurat bruto nga interesat bankarë në vlerën 169.117 lekë;
- të ardhurat bruto të tjera në vlerën 5.327.967 lekë;
- shuma e të ardhurave bruto është në vlerën 9.097.084 lekë, për të cilin është paguar tatim në vlerën 909.709 lekë.

18.7.12 Komisioni konstatoi se të ardhurat e z. H. vetëm për vitin 2011 duket se kanë qenë më se të mjaftueshme për të dhënë huan. Në këtë të fundit nuk është përfshirë asnjë e ardhur tjetër përveçse të ardhurat nga punësimi (paga) për vitin 2011.

18.7.13 Komisioni, pas hetimit të thelluar në analizimin e dokumentacionit të administruar, duke parë të ardhurat e përfituara nga z. H, si dhe gjendjen në llogaritë e tij bankare në momentin e dhënies së huas, konkludoi se z. H. ka pasur burime të ligjshme për krijimin e shumës 25.000 euro në momentin e dhënies së saj.

18.8 Në lidhje me shlyerjen e huas shtetasit A.H

³⁷ Nr. *** prot., datë 26.5.2023, administruar në dosjen e Komisionit në versionin anglisht dhe në përkthimin shqip.

18.8.1 Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar shlyerjen e huas në deklaratat periodike në mënyrë kronologjike që prej marrjes së saj në vitin 2011 e në vazhdim. Ai ka deklaruar çdo vit shumën e shlyer dhe detyrimin e mbetur deri në likuidimin total të saj në vitin 2016.

18.8.2 Nga verifikimi i deklaratave periodike rezulton se deri në vitin 2016 ishin shlyer 26.000 euro dhe jo 25.000 sa ishte huaja e marrë pa interes.

18.8.3 Në tabelën e mëposhtme Komisioni ka pasqyruar të dhënat e deklaruara nga subjekti lidhur me vlerën e shlyer çdo vit dhe detyrimin e mbetur nga kjo hua.

Tabela nr. 5

Viti	Shuma e shlyer (në euro)	Detyrimi i mbetur (në euro)
2011	2,000	23,000
2012	7,000	16,000
2013	3,000	13,000
2014	3,000	10,000
2015	2,000	9,000
2016	9,000	-
TOTAL	26,000	

18.8.4 Lidhur me këtë mospërputhje, ku dukej sikur ishte shlyer shuma 26.000 euro, Komisioni i ka kërkuar subjektit sqarime. Subjekti ka deklaruar: “...Këtë mospërputhje e kam sqaruar para ILDKPKI-së në deklarin e vitit 2016, ku në DPV-në e vitit 2012 është shënuar gabimisht 7.000 euro, në një kohë që shlyerja në total ka qenë 6.000 euro”.

18.8.5 Në mbështetje të deklaramit, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale³⁸ nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.3.2016.

18.8.6 Subjekti, me depozitim e deklaratës, ka sqaruar se deklarimi i huadhënësit përputhet me deklarin e tij ndër vite, 2.000 euro në 2011-ën, 6.000 euro në 2012-ën, 3.000 euro në 2013-ën, 3.000 euro në 2014-ën dhe 2.000 euro në 2015-ën, në total 16.000 euro.

18.8.7 Nga verifikimi i aktit, Komisioni konstatoi se huadhënësi ka deklaruar: “...në vitin 2011 i kam dhënë një hua në shumën 25.000 euro z. Saimir Hysa, me qëllim shlyerjen e një kredie që ai kishte marrë pranë Credins Bank. Kjo hua është dhënë nëpërmjet një transferte bankare. Kjo hua është dhënë pa afat dhe pa asnjë interes, me qëllim për të ndihmuar z. Saimir Hysa për blerjen e banesës, nisur nga marrëdhëniet tona të miqësisë së vjetër që ne kemi. Huaja do të shlyhej prej tij sipas mundësive. Nga ana e z. Saimir Hysa deri në datën 31.12.2015 nga kjo hua është shlyer në rrugë bankare dhe në dorë shuma prej 16.000 euro”.

18.8.8 Nga hetimi Komisionit i ka rezultuar se shlyerja e kësaj huaje është kryer në rrugë bankare dhe cash. Më konkretisht, gjatë vitit 2012, bashkëshortja e subjektit prej muajit janar deri në tetor ka kryer depozitime cash në llogarinë e shtetasit A.H në ISP Bank. Totali i këtyre depozitimeve rezultoi në shumën 6.000 euro.

18.8.9 Komisioni konstatoi se kjo shumë përputhet me deklarin e subjektit që në vitin 2012 ai ka shlyer 6.000 euro nga huaja dhe jo 7.000 euro. Përveç përlllogaritjeve lehtësisht të verifikueshme, ky

³⁸ Me pyetësorin nr. 2, datë 30.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

fakt mbështetet edhe me deklaratën noteriale të z. H, i cili pranon se deri në fund të vitit 2015 i janë shlyer 16.000 euro.

18.8.10 Gjithashtu, në vitin 2016 rezultoi se bashkëshortja e subjektit ka tërhequr nga llogaria e saj bankare në ISP Bank vlerën 9.000 euro, me përshkrimin “Tërheqje për likuidim detyrimi” dhe e ka depozituar më 6.6.2016 në llogarinë e shtetasit A.H. Konstatohet se me këtë depozitim është mbyllur totalisht huaja ndaj z. H, konfirmuar kjo edhe me deklaratën noteriale të datës 25.1.2017, të lëshuar nga huadhënësi para noteres M.SH.

18.8.11 Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 2011 – 2016, për të konkluduar mbi aftësinë paguese të subjektit të rivlerësimit në shlyerjen e kësaj huaje dhe i rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të investojë në blerjen e pasurisë apartament, të shlyejë huan, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

18.8.12 Komisioni hetoi në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi midis subjektit të rivlerësimit, për shkak të ushtrimit të funksionit të tij, dhe shtetasit A.H.H.

18.8.13 Në përgjigjen e dhënë³⁹ subjekti ka deklaruar: *“Gjatë gjithë periudhës që kam ushtruar detyrën e prokurorit nuk kam hetuar apo gjykuar çështje me shtetasin A.H”*.

18.8.14 Subjekti ka depozituar shkresën⁴⁰ e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku citohet se nuk rezulton që ndaj shtetasit A.H.H të jenë regjistruar kallëzime apo procedime të hetuara nga prokurori Saimir Hysa.

18.9 Komisioni hetoi në lidhje me marrjen e kësaj huaje në dhjetor të vitit 2011, pra një muaj pas disbursimit të kredisë në nëntor të po këtij viti, duke i kërkuar subjektit të japë shpjegime bindëse mbi këtë konstatim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

18.10 Subjekti në prapësimet e tij, ndër të tjera, ka deklaruar se kishin planifikuar të merrnin një kredi bankare pasi e kishin marrë një hua dhe me bashkëshorten kishin vendosur që kredinë ta merrnin me afat të gjatë shlyerjeje dhe me një këst të arsyeshëm, që të mos bëhej barrë në jetën e tyre të përditshme. Për këtë shkak kredinë e kishin marrë për një afat 15-vjeçar dhe sipas kontratës kësti mujor ishte 254 euro/muaj (principal + interes), që ishte normalisht i përballueshëm prej tyre me të ardhurat që kishin. Pavarësisht se kishin marrë kredinë me afat të gjatë plani i tyre kishte qenë që ta mbyllnin në një afat sa më të shkurtër, ndaj kishin insistuar që për këtë veprim të mos kishte penalitet financiar dhe sipas subjektit ai është interesuar në disa banka që në rast të shlyerjes së menjëhershme të pjesës së mbetur të kredisë të mos kishin penalitet dhe e vetmja bankë që kishte pranuar këtë kërkesë ishte Credins Bank, pasi bankat e tjera aplikonin penalitet në përqindje të vlerës së mbetur të kredisë. Subjekti ka deklaruar se ndërtuesi i pallatit dhe shitësi njëkohësisht, z. A.L, i kishte ndihmuar që edhe kjo gjë të zgjidhej dhe në kontratë ishte përcaktuar se në rast të prishjes së kontratës banka nuk do të aplikonte penalitetet, pika 7.5 e saj. Subjekti ka deklaruar: *“Nisur edhe nga fakti se ishte hera e parë që merrja kredi nuk i dhashë rëndësi grafikut të shlyerjes që i bashkëngjitet kontratës ose treguesit të “amortizimit të kredisë”, term që e mësova dhe kuptova çfarë ishte më pas”*. Subjekti ka deklaruar se pasi ka paguar këstin e parë ka konstatuar se raporti i pagesës principal - interes për vitet e para ishte 1/6 dhe në rast se ai do ta shlyente kredinë më parë përsëri nuk do të kishte asnjë avantazh, nisur nga fakti se banka me këstet e viteve të para arkëtonte interesin e kredisë dhe më pas fillonte pagimi i principalit të kredisë prej 25.000 euro. Subjekti ka

³⁹ Me pyetësin nr. 2, datë 30.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴⁰ Nr. *** prot., datë 19.5.2023, me pyetësin nr. 6, datë 15.5.2023.

shpjeguar: “Kjo më ka shtyrë të mendoj për të shlyer kredinë me një hua pa interes ose me interes të ulët dhe në këtë kuadër miku im A.H më ofroi shlyerjen e kredisë me një hua të dhënë prej tij pa asnjë interes. Natyrisht që unë isha dakord me këtë fakt dhe me transfer të bankare nga llogaria e tij A. ka kaluar shumën prej 25.000 euro, me të cilën është shlyer plotësisht kredia. Si dhe ju keni analizuar në raport, huaja është shlyer nga ana ime për një periudhë 6-vjeçare. Huadhënësi, një person i njohur publik, analist i shquar dhe që ka mbajtur poste të larta shtetërore (gjë që gjithashtu duhet vlerësuar nga ana juaj), ka pasur plotësisht mundësi financiare, madje shumë më tepër për dhënien e kësaj huaje dhe unë i kam pasur mundësitë për shlyerjen e saj”.

Subjekti ka theksuar se nuk mund të dijë të japë një tjetër sqarim bindës më të saktë sesa çfarë ka dhënë vetë huadhënësi A.H në deklaratën që ka dorëzuar. Subjekti ka deklaruar se qëllimi i dhënies së saj ka qenë vetëm për ta ndihmuar dhe ai ka treguar korrektesë në shlyerjen e saj në një afat sa më të shkurtër. Subjekti ka deklaruar se kjo hua është reale, e dhënë përmes sistemit bankar dhe shlyerja e saj është bërë me bankë. Subjekti ka theksuar se kjo gjë hedh poshtë çdo dyshim dhe është një shpjegim më se bindës.

Subjekti i është përgjigjur pyetjes së përse mori kredi kur ndërkohë kishte njohje të hershme me huadhënësin, duke deklaruar se nuk e kishte vlerësuar mundësinë e marrjes së një huaje të dytë, nisur nga fakti se edhe kredia ishte e përballeshme financiarisht me të ardhurat e tij familjare dhe nuk kishte zgjedhur mes dy alternativave që mund t'i ishin vënë përpara njëkohësisht, kredinë para huas. Subjekti ka theksuar se natyrisht në këtë rast do të zgjidhte huan, por kredia dhe huaja janë veprime të kryera në kohë të ndryshme dhe nga pikëpamja financiare për të ishte më e volitshme huaja pa interes, e cila iu mundësua pas marrjes së kredisë dhe që miku i tij ia kishte ofruar me bujari. Subjekti ka deklaruar se nuk kishte arsye për ta refuzuar huan dhe se ka menduar që është treguar korrekt me të për kthimin, por edhe me deklarimin e saj në ILDKPKI.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

18.11 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve dhe fakteve të konkluduara lidhur me mundësinë e dhënies së huas dhe kthimin e saj, çmon se shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe se ato duhen vlerësuar në kontekstin e të gjithë rrethanave të konstatuara. Në këtë drejtim, trupi gjykues vlerëson se në këtë çështje provohet se: (i) kjo marrëdhënie huaje është ndërtuar në bazë të vullnetit të palëve, për të cilët nuk u provua ndonjë kundërshti në dhënien dhe shlyerjen e saj; (ii) huadhënësi ka pasur burime të ligjshme për dhënien e huas, e transferuar me rrugë bankare; (iii) subjekti e ka deklaruar këtë hua dhe shlyerjen e saj në kohë reale në çdo DPV; (iv) në rrethanat konstatuese nuk rezultojnë pasoja në dëm të palëve (huadhënës-huamarrës-institucion bankar), duke konkluduar se për këtë çështje në tërësi nuk diktohen problematika.

18.12 Komisioni hetoi në lidhje me huan e marrë nga subjekti i rivlerësimit vëllait të tij I.H, si një ndër burimet e tjera të krijimit të kësaj pasurie.

18.12.1 Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2011 se ka marrë hua pa afat dhe pa interes nga shtetasi I.H (vëllai) në shumën 15.000 euro. Shuma është marrë në gusht të vitit 2011, me qëllim blerjen e apartamentit.

18.12.2 Në deklaratën *Vetting* rezultoi se subjekti ka deklaruar që huaja e marrë nga vëllai i tij i është paguar *cash* në dorë drejtuesit të shoqërisë “***” sh.p.k., z. A.L.

18.12.3 Për të vërtetuar këtë marrëdhënie huaje, subjekti ka depozituar kontratë huaje⁴¹ nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.11.2011, me palë huadhënëse I.H dhe huamarrës Saimir Hysa. Nga verifikimi i aktit rezultoi se huadhënësi deklaroi se i ka dhënë në gusht të vitit 2011, jashtë zyrës noteriale, z. Saimir Hysa një hua me vlerë 15.000 euro, pa afat dhe pa interes, me qëllim blerjen nga ana e huamarrësit të një apartamenti pranë shoqërisë “****” sh.p.k.

18.12.4 Komisioni i ka kërkuar⁴² subjektin të deklarojë burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së marrë hua nga vëllai i tij. Subjekti ka deklaruar: *“Lidhur me mundësitë e vëllai tim për të më dhënë këtë hua, deklaroj se vëllai im ka mundësi të plota për të dhënë një hua në këto përmasa. Vëllai im I.H prej muajit janar të vitit 1991 jeton në G.-Austri, ku është diplomuar për arkitekturë në vitin 1998, profesion që e ushtron edhe sot në Austri. Ai është drejtues/administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë/studio arkitekture “****” ***, i shoqërisë “****” (shih web www.***), shoqëri që ka pasur aktivitet të konsiderueshëm në fushën e ndërtimit në G.. Po kështu është aksioner në shoqërinë “****” ***, me qendër në Vienë, shoqërinë “****” Limited, me qendër në Londër-UK etj. Që në fillimet e punës së tij ai ka punuar duke paguar rregullisht detyrimet për sigurimet shoqërore apo edhe tatimore ndaj shtetit austriak, si shtetas i atij shteti. Përveç aktivitetit në Austri ka ushtruar dhe ushtron edhe sot aktivitet tregtar edhe në Shqipëri si administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., si dhe ka kryer projekte/projektme të ndryshme publike (projekti për rikonstruksionin e ***) dhe private. Në vitin 2009 ai ka shitur një banesë që ka pasur në pronësi në Tiranë, blerë në vitin 2005 kundrejt një shume prej 85.000 euro, shumë e shitjes të së cilës ka qenë e depozituar në ish-Bankën Popullore dhe më pas Societe Generale Bank. Nga kjo shumë 20.000 euro janë tërhequr cash, kurse pjesa tjetër është transferuar në Austri në rrugë bankare...”*

18.12.5 Në mbështetje të deklaramentit, subjekti ka depozituar kontratë për çelje depozite me afat nr. ***, datë 9.10.2009, në shumën 55.050 euro, lidhur mes Bankës Popullore dhe vëllait të tij I.H. Subjekti ka depozituar⁴³ aktmarrëveshjen nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.10.2009, për shitjen e pasurisë apartament me sip. 103.1 m², në vlerën 85.000 euro. Sipas kësaj aktmarrëveshjeje parashikimi i pagesave ka qenë: kësti i parë në shumën 55.000 euro do të paguhet nëpërmjet bankës; kësti i dytë në shumën 23.600 euro do të paguhet brenda muajit tetor 2009; kësti i tretë dhe i fundit në shumën 6.400 euro.

18.12.6 Nga hetimi rezultoi se në llogarinë bankare në OTP (ish-Banka Popullore) të shtetasit I.H është kryer transfertë prej 55.000 euro në datën 2.10.2009, me përshkrimin “Pagesë nga M.E për blerjen e shtëpisë nga E.M”. Më pas rezultoi se kjo shumë në datën 9.10.2009 është investuar në depozitë. Pas maturimit në datën 16.12.2010 rezultoi se nga kjo depozitë janë përfituar edhe interesat.

18.12.7 Gjithashtu rezultoi se në këtë llogari shtetasi I.H ka depozituar në datën 20.10.2009 shumën 21.400 euro, me përshkrimin “Depozituar nga I.H, K.M”.

18.12.8 Komisioni konstaton se përputhen këto dy pagesa me parashikimin kontraktor. Vërehet se vëllai i subjektit në këtë llogari ka kryer transaksione si, depozitime, tërheqje apo transferime. Konkretisht, rezultoi se ai ka transferuar në shtetin ku jeton shumat 42.000 euro në datën 16.12.2010 dhe 23.144 euro në datën 11.1.2011 dhe ka realizuar tërheqjet në *cash* pas përfitimit të të ardhurave nga shitja e pasurisë, në total në shumën 19.400 euro, për periudhën tetor 2009 – prill 2010.

18.12.9 Për të provuar të ardhurat e vëllait në shtetin austriak, së bashku me deklaratën *Vetting*, subjekti ka depozituar dokumentacion edhe mbi aktivitetin tregtar të vëllait në Austri.

⁴¹ Aneks nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së dhe pyetësor nr. 2, datë 30.3.2023.

⁴² Pyetësor nr. 2, datë 30.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴³ Me pyetësorin nr. 6, datë 15.5.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

18.12.10 Më konkretisht, subjekti ka depozituar:

- i) Ekstrakt nga regjistri tregtar, me datë regjistrimi 23.5.2006. Nga verifikimi i aktit Komisioni konstatoi se pronar i shoqërisë është vëllai i subjektit, shtetasi I.H, me aktivitet zyrë inxhinierike.
- ii) Ekstrakt nga regjistri tregtar për shoqërinë “***” ***. Nga verifikimi i aktit Komisioni konstatoi se vëllai i subjektit, shtetasi I.H, është ortak dhe administrator.
- iii) Listë paga për periudhën 1.1.2011 – 31.12.2011, të lëshuar nga Drejtoria e Tatim-Taksave G. Nga verifikimi i kësaj liste Komisioni konstatoi se të ardhurat bruto janë në shumën 35.461,14 euro.
- iv) Vlerësim nga Drejtoria e Tatim-Taksave G. për tatimin mbi të ardhurat për vitin 2011 për shtetasin I.H. Nga verifikimi i dokumentit Komisioni konstatoi se shuma e përgjithshme e të ardhurave është 16.713,48 euro.
- v) Vlerësim nga Drejtoria e Tatim-Taksave G. për tatimin mbi të ardhurat për vitin 2011 për shtetasen E.C.H. Nga verifikimi i dokumentit Komisioni konstatoi se shuma e përgjithshme e të ardhurave është 28.309,72 euro.
- vi) Në tërësi u konstatua se totali i të ardhurave bruto për vitin 2011 ishte në shumën 80.484,34 euro. Sipas Eurostat-it⁴⁴ shpenzimet e jetesës në shtetin austriak për dy të rritur me dy fëmijë⁴⁵ rezultuan në vlerën 27.043 euro për vitin 2011. Në këto kushte, me këto të dhëna të grumbulluara, duke u kryer përlllogaritjet deri në muajin korrik, pasi huaja është dhënë në muajin gusht, rezultoi se të ardhurat bruto ishin në vlerën 46.949,2 euro dhe shpenzimet e jetesës për dy të rritur me dy fëmijë ishin në shumën 15.775,08 euro.

18.12.11 Komisioni e shtriu hetimin për këtë çështje referuar edhe gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar⁴⁶, pasi disa aktivitete të vëllait të subjektit datonin pas dhënies së huas në mënyrë deklarative, transferimi i shumës 15.000 nuk ishte sqaruar dhe dokumentuar dhe se për shumën e dhënë 15.000 euro në gusht të vitit 2011, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në pyetësonin nr. 2, nuk ka asnjë deklaratë të gjendjes *cash* të vëllait që ka hyrë në Shqipëri me më shumë se 10.000 euro.

18.12.12 Për të konkluduar mbi këto çështje, Komisioni e ka pyetur⁴⁷ subjektin e rivlerësimit, për të cilat ka deklaruar se *shuma 15.000 euro i është dhënë nga vëllai cash në banesën e tij, datën nuk e kujton, por deklaroi se ka qenë muaji gusht 2011. Lidhur me mënyrën e sjelljes së kësaj shume, subjekti ka deklaruar se ka pyetur të vëllanë, i cili i ka referuar të deklarojë se nuk ka pasur arsye ta deklarojë atë në doganë, pasi një pjesë të saj e ka pasur gjendje në Shqipëri, kurse një pjesë e ka sjellë nga Austria në gusht të vitit 2011, por ka qenë nën shumën për të cilën ka detyrimin ta deklarojë. Shifrat konkrete me saktësi ai nuk i mban mend, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar.*

18.12.13 Komisioni verifikoi sistemin TIMS, nga ku i rezultoi se vëllai i subjektit për vitin 2011 kishte hyrë në Shqipëri, përkatësisht në datat: 3.4.2011, ora 14:38; 24.6.2011, ora 14:41; 19.8.2011, ora 17:52; 25.8.2011, ora 19:46; 18.11.2011, ora 15:14.

18.12.14 Në vijim të gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar është konstatuar edhe se dokumenti i përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave nr. *** prot., datë 22.10.2020, tregon lëvizjet e vlerave monetare nga vëllai dhe babai ndër vite, nga ku duket se këto lëvizje shumash ndikojnë në përlllogaritjet e kryera për të konkluduar nëse vëllai i subjektit kishte mjete financiare për të dhënë huan.

⁴⁴ https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_LI01_custom_6254640/default/table?lang=en

⁴⁵ Sipas deklarimit të subjektit në pyetësonin nr. 5, datë 15.5.2023, që vëllai është i martuar dhe ka 2 fëmijë.

⁴⁶ Nr. *** prot., datë 26.5.2023, administruar në dosjen e Komisionit në versionin anglisht dhe në përthimin shqip.

⁴⁷ Me pyetësonin nr. 10, datë 30.6.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

18.12.15 Komisioni, bazuar në përlllogaritjet e pasqyruara edhe më lart në tabelën nr. 2, ka konstatuar se të ardhurat e vëllait të subjektit janë në vlera të konsiderueshme, pasi kursimi i rezultuar, pa marrë në konsideratë të ardhurat nga aktiviteti i tij tregtar (i cituar në gjetje se daton pas dhënies së huas), duket se mbulon veprimet e kryera në llogaritë bankare përkatëse nga babai dhe vëllai i subjektit.

18.12.16 Komisioni vëren se të ardhurat vjetore të familjes së vëllait të subjektit janë në vlera të konsiderueshme për të përballuar shpenzimet, përfshirë këtu edhe shlyerjen e kredisë së marrë në vitin 2006 në Austri.

18.12.17 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe provave të administruara, konkludon se huadhënësi, vëllai i subjektit të rivlerësimit, nga të gjitha përlllogaritjet e kryera rezultoi se ka pasur mundësi për të krijuar shumën 15.000 euro, me burim të ligjshëm deri në momentin e dhënies së saj në gusht të vitit 2011. Po ashtu, rezultoi se kjo hua është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike të kohës, ndërkohë konsiderohet fakti se marrëdhënia e krijuar është një marrëdhënie e posaçme familjare, por edhe pse e tillë duket se nuk ka mbetur thjesht në nivel deklarativ, por është konkretizuar po në kohë reale me kontratën përkatëse. Në kushte të tilla, dyshimi për dhënien e saj duket se nuk qëndron, ndërsa u provua edhe fakti i mundësisë së krijimit të saj me burime të ligjshme, sikurse parasheh ligji. Nga ana tjetër, nga hetimi rezultoi se për krijimin e kësaj shume nuk ndikojnë aktivitetet e vëllait të subjektit, të cilat datojnë pas dhënies së huas, pasi të dhënat e verifikuara janë të mjaftueshme deri në momentin e dhënies së saj. Po ashtu, në këtë vlerësim ndikon edhe konstatimi se të ardhurat e përfituara në shtetin austriak ishin të mjaftueshme për të përballuar jetesën familjare, ndërsa vlerësohet se lëvizjet bankare të vëllait të subjektit dhe babait të tij nuk mund të kenë ndikim dominant në këtë marrëdhënie. Po ashtu, u provua nga vetë sistemi TIMS (i hyrje-daljeve në kufi) se vëllai i subjektit kishte hyrë katër herë në territorin shqiptar gjatë vitit 2011, deri në dhënien e huas. Në përfundim, trupi gjykues çmon se shpjegimet e subjektit dhe analiza financiare duket se nuk identifikojnë problematika lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj huaje, sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

19. Apartament me sipërfaqe 89 m², në rrugën “****”, pallati ***, shkalla ***, apartamenti ***, Tiranë. Regjistruar në ZVRPP-në Tiranë me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***. Burimi i krijimit: përfituar nga privatizimi i banesave. Vlera: 30.000 lekë. Pjesa takuese: 16.6%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës certifikatën për vërtetim pronësie datë 15.4.2003⁴⁸, për apartament me sip. 89 m², në rrugën “****”, ku shtetasi Saimir Hysa zotëron në bashkëpronësi 1/6 pjesë takuese.

19.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë.

Hetimi i Komisionit

19.2 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri në DPV-në e vitit 2003, me përshkrimin “Shtëpi banimi (apartament) në rrugën “****”, pallati ***, shkalla ***. Pjesa takuese: 1/6. Burimi i krijimit: privatizimi i banesave.

19.3 Në DPV-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar:

i) Në bazë të vendimit nr. *** akti, datë 15.4.2015, të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Tiranë, marrë formë të prerë më 22.7.2016, pjesa takuese prej 1/6 e apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, pallati ***, shkalla ***, apartamenti ***, Tiranë, i ka kaluar pesë bashkëpronarëve të tjerë, Z., D., N., I. dhe Saimir Hysa. Për këtë vendim nuk janë kryer ende veprimet për regjistrimin e tij pranë ZVRPP-së Tiranë.

⁴⁸ Aneks nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

ii) Me anë të deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.8.2016, para noterës G.SH, vëllai I.H i ka dhuruar subjektit pjesën takuese (1/6) të apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë. Nga ana e subjektit nuk është bërë ende deklarata për pranimin e dhurimit dhe nuk janë kryer veprimet përkatëse pranë ZVRPP-së Tiranë.

iii) Me anë të deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.6.2016, para noterës G.SH, vëllai N.H i ka dhuruar subjektit pjesën takuese (1/6) të apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë. Nga ana e subjektit nuk është bërë ende deklarata për pranimin e dhurimit dhe nuk janë kryer veprimet përkatëse pranë ZVRPP-së Tiranë.

19.4 ZVRPP-ja Tiranë⁴⁹ konfirmon se në emër të z. Saimir Hysa figuron e regjistruar pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji apartament me sip. 89 m², në bashkëpronësi. Praktika ka të bashkëlidhur kartelën e pronësisë me datë regjistrimi 2.7.2018, për apartamentin me sip. 89 m², në rrugën “****”, në bashkëpronësi të shtetasve Saimir, Z., I. dhe N. Hysa, me shënimin “Dëshmi trashëgimie”. Sipas kontratës së shitjes apartamenti është përfituar nga Ndërmarrja Komonale Banesa nr. ***, vërtetuar me vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., nr.*** kol., datë 16.7.1993. Nga praktika e administruar rezulton se apartamenti është rivlerësuar në vitin 2012, në vlerën 16.910.000 lekë.

19.5 Komisioni, për të qartësuar deklaratimet e subjektit lidhur me pjesët takuese të bashkëpronarëve të tjerë, për të cilët nuk ishin kryer ende veprimet mbi dhurimet e bëra në favor të tij, referuar edhe gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar, i kërkoi subjektit të shpjegojë dhe të dokumentojë statusin aktual të pasurisë në konsideratë të dhurimit të ofruar.

19.6 Subjekti në shpjegimet e tij⁵⁰ ka deklaruar se: “...jo vetëm I., me deklaratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.8.2016, notere G.SH, por edhe vëllai im N.H, me deklaratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.6.2016, notere G.SH, më kanë dhuruar pjesën takuese të banesës të ndodhur në rrugën “****” pallati ***, të përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore në vitin 1993. Regjistrimi i tyre nuk është bërë, pa pasur ndonjë shkak të veçantë që lidhej me vullnetin e deklaruesve apo timin, pasi mirëkuptimi mes nesh ishte i plotë. Nga ana ime nuk është refuzuar ky dhurim apo marrë ndonjë vendim për mos ta pranuar atë. Pas nënshkrimit të këtyre deklaratave, që koïncidoi me periudhën e pushimeve, nuk kam bërë veprimet në ZVRPP, për shkak të sëmundjes së papritur të nënës tonë, e cila vdiq disa ditë më pas, më 19.9.2016, dhe për një periudhë disamujore nuk u mora fare me këtë gjë. Më pas kaloi edhe afati për regjistrimin e tyre në ZVRPP dhe duheshin paguar penalitete për regjistrimin e këtyre akteve, ndaj mendova të ribëja deklaratat edhe një herë nga e para, pasi me të dy vëllezërit nuk kisha asnjë lloj problemi për t’i ribërë ato dhe nga ngarkesa e përditshme e kam lënë pas dore. Në prill të 2022 u “bëra mbarë” për të kryer veprimet që duheshin në ASHK për sa më sipër, por edhe për nxjerrjen e certifikatës për apartamentin e ndodhur në rrugën “****”, për të cilin madje kisha harruar të hiqja bllokimin e pronës pas shlyerjes së kredisë në vitin 2011. Në datën 19.4.2022, të dy vëllezërit e mi I. dhe N.H, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., lidhur para noterit J.ZH, më kanë dhuruar pjesët takuese të tyre në apartamentin/pasurinë nr. ***, prej ¼ pjesë dhe aktualisht unë zotëroj ¾ pjesë të kësaj pasurie, sipas certifikatës së lëshuar më 19.4.2022. Po kështu, më 20.4.2022 jam pajisur me certifikatë pronësie edhe për banesën tjetër të ndodhur në rrugën “****””.

- Subjekti ka depozituar certifikatë për vërtetim pronësie.

⁴⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 8.11.2018, aneks nr. 29 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁰ Me pyetësorin nr. 10, datë 30.6.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

19.7 Trupi gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, konstatoi se pas veprimeve noteriale pasuria objekt hetimi, e prejardhur nga privatizimi i banesave shtetërore, është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe babait të tij, duke identifikuar në këtë mënyrë statusin juridik të saj. Në këto kushte, shpjegimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e administruar dhe, për rrjedhojë, nuk identifikohen problematika lidhur me origjinën dhe mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie në emër të subjektit, në pjesë takuese $\frac{3}{4}$.

20. Automjet tip “Renault Megane”, me targë *.** Burimi i krijimit: shitja e automjetit tip “Renault Megane” me targë ***, sipas kontratës nr.*** rep., nr. *** kol., datë 7.7.2016, lidhur para noteres A.GJ. Vlera: 5.700 euro plus 170.040 lekë detyrimi doganor. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁵¹.

20.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja.

Hetimi i Komisionit

20.2 Subjekti rivlerësimit e ka deklaruar blerjen e kësaj pasurie në DPV-në e vitit 2015, me përshkrimin “Blerë automjeti “Renault Megane Scenic” me targë ***. Blerë me të ardhurat nga shitja e makinës së vjetër, si dhe të ardhurat nga paga. Vlera: 5.750 euro + 1.200 euro detyrim doganor”.

20.3 DPSHTRR-ja⁵² konfirmon se shtetasi Saimir Z. Hysa ka të regjistruar automjetin me targë ***. Kjo drejtori ka përcjellë dosjen e mjetit, në të cilën përfshihet kontrata e blerjes së automjetit në shtetin austriak, në vlerën 5.750 euro, si dhe praktika e zhdoganimit të tij.

20.4 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, nga hetimi i kryer Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Renault Megane”, me targë ***, ndërsa në DPV-në e vitit 2015 ka deklaruar të ardhurat nga shitja e makinës së vjetër, si dhe të ardhurat nga paga.

20.5 Gjatë hetimit të Komisionit, subjekti ka sqaruar⁵³ se në datën 7.5.2015 ka udhëtuar me avion për të shkuar te vëllai i tij I.H në G., Austri, me qëllimin për të sjellë në Shqipëri automjetin tip “Renault Megane”, me targë ***.

20.6 Nga verifikimi i hyrje-daljeve⁵⁴ të subjektit të rivlerësimit, Komisionit i rezultoi se subjekti ka dalë nga territori i vendit në datën 7.5.2015 nga pika kufitare *** dhe ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë në datën 10.5.2015 nga pika kufitare *** me automjetin me targë ***.

20.7 Sipas praktikës së administruar për këtë automjet rezulton se kontrata e blerjes për mjetin me targë *** është firmosur nga z. Saimir Hysa në datën 4.4.2015⁵⁵ dhe zhdoganimi i tij është kryer në datën 11.5.2015, një ditë pas hyrjes në Shqipëri. Pas zhdoganimit mjeti ka marrë targën ***.

⁵¹ Deklaratë zhdoganimi datë 11.5.2015, në emër të z. Saimir Hysa, për automjetin e përdorur “Renault”, me eksportues nga Austria. Vlera e automjetit: 5.750 euro. Vlera e taksave doganore: 170.040 lekë; vërtetim nr. ***, datë 20.10.2016, nga DPDoganaVe, sipas të cilit z. Saimir Hysa, në datën 11.5.2015, me deklaratën doganore nr.*** ka kryer zhdoganimin e automjetit tip “Renault Megane”, vit prodhimi 2010 dhe detyrim doganor të paguar 170.040 lekë; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.7.2015, ku z. Saimir Hysa shet automjetin tip “Renault” në vlerën 4.000 euro (aneks nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁵² Me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

⁵³ Pyetësor nr. 1, datë 23.7.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

⁵⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 20.10.2020, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

⁵⁵ Sipas sistemit TIMS, subjekti ka qenë jashtë territorit të vendit. Subjekti ka deklaruar se ka qenë në G. të Austrisë.

20.8 Subjekti ka deklaruar se një nga burimet e krijimit të kësaj pasurie kanë qenë të ardhurat e përfituara nga shitja e mjetit tip “Renault Megane”, me targë ***, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.7.2016.

20.9 Nga hetimi⁵⁶ rezulton se mjeti tip “Renault Megane”, me targë ***, është shitur nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.7.2015, me palë shitëse shtetasin Saimir Hysa dhe palë blerëse shtetasin A.P (vendosja e vitit 2016 duhet të jetë lapsus i subjektit). Në këtë kontratë citohet se çmimi i blerjes së mjetit është caktuar 4.000 euro dhe blerësi ia ka likuiduar shumën tërësisht jashtë kësaj zyre dhe para përpilimit të kësaj kontrate.

20.10 Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit kontratën për blerjen e mjetit me targë *** e ka nënshkruar në Austri në datën 4.4.2015, ndërsa kontratën e shitjes së mjetit me targë *** e ka nënshkruar në datën 7.7.2015, për rrjedhojë dukej se të ardhurat e përfituara nga shitja e mjetit me targë *** nuk mund të kishin shërbyer si burim krijimi për pasurinë objekt hetimi.

20.11 Komisioni vlerësoi të kryejë analizën financiare në datën kur është nënshkruar kontrata për blerjen e mjetit, pra në datën 4.4.2015.

20.12 Nga analiza financiare: (i) dukej se subjekti i rivlerësimit nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 706.720 lekë për të investuar në pasurinë automjet, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare; (ii) dukej se të ardhurat nga shitja e automjetit me targë *** nuk mund të kishin shërbyer si burim krijimi për këtë pasuri, pasi mjeti ishte shitur 3 muaj pasi ishte blerë mjeti me targë ***.

20.13 Për sa më sipër⁵⁷, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit, si dhe për të depozituar dokumentacion justifikues në mbështetje të shpjegimeve të tij.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

20.14 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, ndër të tjera, ka deklaruar se është e vërtetë që në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si burim të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Renault Megane”, me targë ***, ndërsa në DPV-në e vitit 2015 ka deklaruar të ardhurat nga shitja e makinës së vjetër, si dhe të ardhurat/kursimet nga pagat. Subjekti ka shpjeguar se ka vlerësuar në këtë mënyrë sepse ky është burimi real përfundimtar për blerjen e automjetit. Ai ka deklaruar se pagesa e kryer nga vëllai i tij (e cila mund të konsiderohet si hua e përkohshme nga Komisioni) ishte shlyer prej tij brenda vitit dhe prandaj nuk kishte deklaruar në DPV, pasi në fund të vitit nuk kishte asnjë detyrim për të deklaruar. Subjekti ka vijuar të shpjegojë, sikurse ka shpjeguar edhe gjatë hetimit, se në datën 7.5.2015 kishte udhëtuar me avion për të shkuar te vëllai i tij I.H në G., Austri, me qëllimin për të sjellë në Shqipëri automjetin tip “Renault Megane”, me targë ***. Ai sqaron se nga verifikimi i hyrje-daljeve ka dalë nga territori i vendit në datën 7.5.2015 nga pika kufitare *** dhe ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë në datën 10.5.2015 nga pika kufitare *** me automjetin me targë ***. Subjekti deklaroi se sipas praktikës së administruar për këtë automjet rezulton se kontrata e blerjes për mjetin me targë *** është firmosur prej tij në datën 4.4.2015 dhe zhdoganimi i tij është kryer në datën 11.5.2015, një ditë pas hyrjes në Shqipëri. Pas zhdoganimit, mjeti ka marrë targën ***. Subjekti ka deklaruar se në momentin e përpilimit të deklaratës *Vetting* i është përmbajtur deklarimeve periodike dhe ka vlerësuar se nuk duhej deklaruar huaja e përkohshme e marrë vetëm për disa javë. Ai ka deklaruar se nga data 23.3.2015 deri më 7.4.2015 ka udhëtuar me bashkëshorten në Austri me automjetin e tij tip “Renault Megane” me targë *** dhe, sikurse ka deklaruar në pyetësorin nr. 1, qëllimi i këtij udhëtimi ka qenë një kontroll rutinë shëndetësor i bashkëshortes. Subjekti ka shpjeguar se: “Gjatë qëndrimit në G.-Austri, në mënyrë rastësore kam parë një mjet të

⁵⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 27.10.2020, nga DPSHTRR-ja.

⁵⁷ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

markës “Renault-Megane”, i ngjashëm me mjetin që kisha, që ishte në shitje nga pronari i tij dhe jam interesuar për ta blerë, nisur nga fakti se automjeti që kisha ishte 12 vjet dhe me mbi 165.000 km. Pasi kam biseduar me shitësin nëpërmjet vëllait tim dhe kam parë se ishte një raport optimal kualitet-çmim kemi rënë dakord për ta blerë mjetin, nisur edhe nga fakti që çmimi i tij ishte i përbalueshëm për mua. Në atë moment natyrisht që unë nuk e kisha me vete shumën 5.750 euro, me të cilën u ble mjeti, pasi udhëtimi im kishte qëllim tjetër dhe ramë dakord me vëllain tim që mjetin ta paguante ai dhe unë t’ia jepja paratë më pas, pasi të shisja dhe automjetin që kisha në atë kohë në pronësi me targë ***. Pasi u bë pagesa dhe u mor mjeti në dorëzim, unë jam kthyer në Shqipëri me mjetin me targë ***, kurse mjetin që bleva e kam lënë në oborrin e banesës të një të njohuri të vëllait tim. Në datën 7.5.2015 unë kam udhëtuar vetëm vajtje me avion, enkas për të sjellë mjetin në Shqipëri dhe pasi kam marrë mjetin e blerë jam kthyer me të në Tiranë në datën 10.5.2015. Në datën 11.5.2015 kam paguar detyrimin doganor për këtë mjet. Shumën e blerjes së mjetit prej 5.750 euro ia kam dhënë vëllait tim në Tiranë gjatë udhëtimeve të tij të shpeshta në Shqipëri. Nga të dhënat e TIMS-it rezulton se ai në periudhën prill-gusht ka qenë në Shqipëri në periudhat 10.4.2015 – 13.4.2015, 18.6.2015 – 21.6.2015 dhe 13.8.2015 – 27.8.2015. Në datën 15.5.2015, bashkëshortja ime ka tërhequr nga llogaria e saj në Raiffeisen Bank shumën prej 350.000 lekësh, enkas për pagesën e mjetit dhe pas shitjes së automjetit të vjetër në shumën 4.000 euro, kam plotësuar shumën që vëllai im kishte paguar për mjetin tim, shumë që ia kam dhënë në një prej ardhjeve të tij në Tiranë në verën e vitit 2015, saktësisht e kam të pamundur ta përcaktoj”.

Subjekti ka deklaruar se duke u parë hyrje-daljet e tij nga territori i Shqipërisë, në raport edhe me datën e blerjes së automjetit, kuptohet se ngjarja ka ndodhur në rrethanat e sipërcituara dhe nën këto argumente ka kërkuar që shuma 4.000 euro, që është përfituar nga shitja e mjetit me targë ***, të përfshihet në analizën financiare dhe të pranohet si burim për blerjen e mjetit me targë ***, për më tepër ka theksuar se sipas kontratës së shitjes palët janë likuiduar para lidhjes së saj, veprim që nuk lidhet me ditën e shitjes, por disa javë përpara kur ishte bërë shitja de facto e mjetit dhe kontrata është lidhur në datën 7.7.2015. Subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale nga blerësi i mjetit, z. A.P. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se e ka të pamundur të sjellë dokument për pagesën me bankë të kryer nga vëllai i tij për mjetin në Austri, pasi sipas legjislacionit austriak bankat nuk ruajnë dokumentet financiare, përshirë edhe *statement*, pas kalimit të një periudhe 7-vjeçare. Subjekti ka depozituar një vërtetim të marrë nga vëllai i tij në bankën “Sparkasse Bank”, ku ai mban llogarinë e tij bankare, sipas të cilit banka nuk disponon dokumente për periudhën mbi 7-vjeçare. Subjekti ka deklaruar se në këto kushte është në pamundësi objektive për të vërtetuar pagesën e kryer prej tij me bankë, duke u ndodhur në kushtet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, duke e lënë vlerësimin e kësaj situatë në çmim të trupit gjykues nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme apo jo. Subjekti ka deklaruar se i vëllai ka pasur mundësi financiare për të bërë pagesën paraprake dhe se shumën nuk e dispononte me vetë në shtetin austriak, jo se nuk e kishte atë të disponueshme në Shqipëri. Subjekti nuk dikton ndonjë arsye që të rezultojë në balancë negative. Ai shton se duket qartë se blerja e mjetit ka qenë e rastësishme sepse nëse do të kishte pasur qëllim blerjen e një automjeti nuk do të kishte udhëtuar me atë që kishte në pronësi. Subjekti mendon se me shpjegimet dhe dokumentet bashkëlidhur këtij prapësimi e ka përmbysur barrën e provës së njoftuar nga Komisioni për blerjen e mjetit me targë *** dhe nëse në analizën financiare përfshihet shuma prej 4.000 euro e përfituar nga shitja e automjetit me targë *** (e këmbyer me kursin e euros në 2015-ën, $4.000 \times 139.8 = 559.920$ lekë), si dhe të ardhurat/kursimet e realizuara, atëherë balanca është pozitive si në fund të vitit, ashtu edhe po të kryhet në secilën prej periudhave kur vëllai ka qenë në Shqipëri, kur realisht i është kthyer shuma për blerjen e këtij automjeti.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

20.15 Trupi gjykues, në analizë të parashtrimeve të subjektit dhe dokumentacionit të depozituar lidhur me pagesën e këtij automjeti, arsyeton si vijon:

- Pretendimet e subjektit lidhur me pagesën e këtij mjeti se më parë është paguar nga vëllai i tij dhe shlyer më pas nga subjekti, nuk mund të merren në konsideratë, për sa kohë shpjegimi i dhënë pas nisjes së rezultateve nuk është deklaruar në deklaratat periodike, në deklaratën *Vetting* apo edhe gjatë hetimit. Për sa më sipër, balanca negative mbetet e pandryshueshme në shumën 706.720 lekë. Nën këtë logjikë, arsyetimi se çdo pretendim tjetër i subjektit që lidhet me pamundësinë e provueshmërisë me dokumentacion për kryerje pagese nga i vëllai për mjetin etj., nuk vlerësohen për t'u arsyetuar. Në kushte të tilla, balanca negative mbetet e pandryshueshme në shumën 706.720 lekë.

21. Llogari në euro/kartë krediti me limit 800 euro pranë Raiffeisen Bank. Balanca aktuale zero. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës⁵⁸ *statement* bankar nga Raiffeisen Bank e llogarisë në euro, datë 23.1.2017, dhe fatura të kartës së kreditit, datë 25.1.2017, me limit 800 euro, balancë 0 (zero).

21.1 Raiffeisen Bank⁵⁹ konfirmon kartë krediti Master Card në euro, në emër të subjektit, me gjendje 0 (zero) euro, datë 28.1.2017.

21.2 Nga verifikimi përkatës trupi gjykues konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga Raiffeisen Bank.

Detyrime financiare

22. Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar “Mbetur pa shlyer huaja e marrë për blerjen e banesës nga “****” sh.p.k. ndaj shtetasit I.H, vëllai, në shumën 15.000 euro, marrë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.11.2011, para noterës B.A”.

22.1 Gjithashtu, Komisionit i rezultoi se detyrimin e mbetur për huan e marrë në vitin 2011 nga shtetasi I.H, subjekti e ka deklaruar periodikisht. Po ashtu rezultoi se deri në datën e depozitimit të deklaratës *Vetting* është deklaruar se kjo hua nuk ishte shlyer.

22.2 Rezultoi se subjekti në pyetësorin standard ka deklaruar: “...Kjo hua është shlyer në vitin 2018, duke u shkëmbyer me pjesën time takuese, 1/3, e një apartamenti me sip. 41.7 m² të ndodhur në G-Kavajë, regjistruar pranë ZVRPP-së Kavajë me nr. ***, vol. ***, f. ***, në z. k. ***, Kavajë. Nga vëllai im për shlyerjen e kësaj huaje me këtë kalim është nënshkruar deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.8.2018, para noterës G.SH në Tiranë, ku pranon se kjo hua konsiderohet tërësisht e shlyer dhe heq dorë nga çdo pretendim për të dhe aktualisht kjo pasuri figuron 100% në emër të vëllait tim I.H”.

22.3 Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka depozituar⁶⁰ deklaratën noteriale nr. ***, datë 31.8.2018, si dhe certifikatën e pronësisë dhe kartelën e saj.

22.4 Komisioni, nga verifikimi i aktit noterial, konstaton se shtetasi I.H deklaroi që vëllai i tij Saimir Hysa, në pamundësi të shlyerjes në të holla të detyrimit financiar prej 15.000 euro, i ka dhuruar pjesën e vet prej 1/3 titull bashkëpronësie mbi pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, K., apartament me sip. 41.6 m². Ky deklarim noterial provohet me tjetërsimin e pasurisë tek pronari i vetëm I.H, sipas certifikatës së pronësisë dhe kartelës shoqëruese si akte të depozituara nga subjekti i rivlerësimit.

⁵⁸ Referuar aneksit nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 3.11.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶⁰ Me email-in e datës 23.5.2023.

22.5 Lidhur me këtë çështje, ku përfshihet marrëdhënia e posaçme familjare, provueshmëria e dhënies së huas dhe burimi i krijimit të saj, mënyra e kthimit të saj, dakordësia mes vëllezërve për ta quajtur të shlyer shumën nëpërmjet tjetërsimit të pjesës takuese të pasurisë, raporti i shumës së kontribuar në vitin 2004 dhe shlyerja e huas nëpërmjet kthimit në natyrë nga subjekti të pjesës së tij takuese, konsiderimi i vlerës së pasurisë në kohën e blerjes dhe natyrshëm ndryshimi i vlerës në kohën e dhurimit pas 14 viteve, etj., subjekti ka dhënë shpjegimet e tij në prapësime dhe njëkohësisht trupi gjykues i ka arsyetuar në mënyrë të detajuar të gjithë situatat më sipër në këtë vendimmarrje dhe, për këtë arsye, nuk vlerëson të bjerë në përsëritje.

Deklarimi i pasurive të bashkëshortes së subjektit, znj. E.T

23. Apartament me sipërfaqe 63 m², në rrugën “****”, pall. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë, regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, Tiranë. Burimi i krijimit: përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore. Pjesa takuese: 20%. Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka depozituar disa dokumente⁶¹.

23.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: Përputhet deklarami i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe konfirmimin e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë.

Hetimi i Komisionit

23.2 Nga dokumentacioni i administruar Komisionit i rezultoi se ASHK Drejtoria Vendore Tiranë *** konfirmon⁶² pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k.***, lloji apartament me sip. 63 m², në bashkëpronësi midis bashkëpronarëve D.T, I.T, D.T dhe E.T, si pasuri e përfituar fillimisht nga privatizimi i banesave shtetërore (1/5 secili) dhe më pas edhe nga çelja e dëshmisë së trashëgimisë testamentare nr. ***, datë 6.3.2017⁶³, e së ndjerës V.T (nëna e bashkëshortes së subjektit), e cila pjesën e saj takuese nga bashkëpronësia në privatizimin e banesës ia ka trashëguar vajzës E.T.

23.3 Pasuria, e cila fillimisht e ka pasur origjinën nga privatizimi i banesave shtetërore, konfirmohet sipas kontratës së shitblerjes datë 25.3.1994⁶⁴, nënshkruar në emër të blerësit D.T etj., ku përfshihet si një ndër 5 blerësit e saj edhe bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. E.T. Pasuria sipas kësaj kontrate rezulton e likuiduar në shumën 13.490 lekë.

23.4 Komisionit, nga verifikimi i dokumentacionit, nuk i rezultuan problematika lidhur me origjinën dhe mënyrën e përfitimit të pjesës takuese të kësaj pasurie në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

24. Llogari rrjedhëse e pagës pranë Raiffeisen Bank, në shumën 714.953 lekë. Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka depozituar *statement* bankar datë 25.1.2017, nga Raiffeisen Bank, për gjendjen e llogarisë në shumën 714.953 lekë, datë 16.1.2017⁶⁵.

24.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: Përputhet deklarami i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga Raiffeisen Bank.

⁶¹ Certifikatë për vërtetim pronësie datë 13.6.2012, ku znj. E.T figuron bashkëpronare në pasurinë apartament me sip. 63 m², në rrugën “****”, Tiranë. Kartela e pasurisë apartament me sip. 63 m², në rrugën “****”, Tiranë, ku znj. E.T figuron bashkëpronare. Shuma e paguar: 23.290 lekë. Aneks nr. 4/8 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶² Me materialin e përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 28.12.2020, të ASHK-së, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶³ Shihni aktin e administruar në aneksin nr. 29, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁴ Administruar po në praktikën e ASHK-së, nr. *** prot., datë 28.12.2020.

⁶⁵ Aneks nr. 4/9, në dosjen e ILDKPKI-së.

24.2 Komisionit, nga korrespondenca me Raiffeisen Bank⁶⁶, i rezultoi se konfirmohet gjendja e llogarisë në shumën 714.953,88 lekë, në datën 28.1.2017.

24.3 Nga verifikimi përkatës, trupi gjykues konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga Raiffeisen Bank.

25. Llogari kursimi pranë Intesa Sanpaolo Bank, në shumën 1.004 euro. Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka depozituar gjendjen e përgjithshme të klientit nga ISP Bank për gjendjen e llogarisë në shumën 1.004 euro, datë 27.1.2017⁶⁷.

25.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ISP Bank.

25.2 Nga korrespondenca me Intesa Sanpaolo Bank⁶⁸ konfirmohet llogari rrjedhëse me gjendje 1.044,44 euro, në datën 28.1.2017, në emër të znj. E.T.

25.3 Nga verifikimi përkatës, trupi gjykues konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga Intesa Sanpaolo Bank.

26. Llogari kursimi pranë Intesa Sanpaolo Bank, në shumën 925.697 lekë. Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka depozituar gjendjen e përgjithshme të klientit nga ISP Bank për gjendjen e llogarisë në shumën 925.697 lekë, datë 27.1.2017⁶⁹.

26.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ISP Bank.

26.2 Nga korrespondenca me Intesa Sanpaolo Bank⁷⁰ konfirmohet llogari rrjedhëse me gjendje 925.697,66 lekë, datë 28.1.2017, në emër të znj. E.T.

26.3 Nga verifikimi përkatës, trupi gjykues konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga Intesa Sanpaolo Bank.

27. Llogari rrjedhëse pranë Raiffeisen Bank, në shumën 1.600 euro (kartë krediti me limit 1.600 euro). Balanca aktuale zero euro. Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka depozituar *statement* bankar të llogarisë në euro, datë 25.1.2017, për kartë krediti me limit 1.600 euro dhe fatura të kartës së kreditit, datë 25.1.2017⁷¹.

27.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga Raiffeisen Bank.

27.2 Nga korrespondenca me Raiffeisen Bank⁷² konfirmohet kartë krediti në euro në emër të znj. E.T, me gjendje 0 (zero) euro, datë 28.1.2017.

27.3 Nga verifikimi përkatës, trupi gjykues konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga Raiffeisen Bank.

⁶⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 3.11.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶⁷ Aneks nr. 4/10, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 20.10.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶⁹ Aneks nr. 4/10, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 20.10.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷¹ Aneks nr. 4/11, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷² Shkresë nr. *** prot., datë 3.11.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

Gjetje të tjera

Gjatë hetimit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore investime në pasuri të luajtshme dhe tjetërsimin e tyre, përveç atyre të deklaruara në deklaratën *Vetting*.

Komisioni ka analizuar secilën prej tyre, si më poshtë detajuar:

28. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2004 blerjen e një automjeti tip “Opel”, me targë ***, në prill të vitit 2004.

28.1 Gjatë hetimit⁷³ subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.4.2004, me palë shitëse I.E (T) dhe palë blerëse Saimir Hysa, për automjetin tip “Opel”, në vlerën 100.000 lekë. Së bashku me kontratën subjekti ka depozituar edhe urdhërderdhjen në bankën e kursimeve, datë 5.5.2004, në shumën 154.700 lekë, për zhdoganimin e mjetit. Ndërsa, lidhur me burimin e krijimit ai ka deklaruar se kanë shërbyer të ardhurat e tij nga puna si prokuror deri në maj të vitit 2004.

28.2 Në deklaratën për vitin 2007, subjekti ka deklaruar se e ka shitur automjetin tip “Opel” me targë ***, në vlerën 2.500 euro. Komisioni, në analizën e kryer për vitin 2007, të ardhurat nga shitja e këtij mjeti i ka marrë në konsideratë në vlerën 250.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.6.2007, depozituar nga subjekti me pyetësin nr. 6, datë 18.5.2023.

28.3 Komisioni, pasi kreu analizën financiare në datën e zhdoganimit të mjetit, 5.5.2004, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të investojë në blerjen e këtij mjeti, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

29. Komisioni i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2007 blerjen e automjetit tip “Renault” me targë ***, në vlerën 5.000 euro.

29.1 Gjatë hetimit administrativ⁷⁴, subjekti ka sqaruar: *“...mjeti është blerë për një shumë prej 500.000 lekësh dhe jo 5.000 euro. Këtë lapsus të bërë prej meje në deklarinimin periodik vjetor e kam saktësuar edhe para ILDKPKI-së para fillimit të procesit të rivlerësimit”*.

29.2 Për të provuar këtë fakt, subjekti ka depozituar⁷⁵ kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.6.2007, me palë shitëse shtetasen E.P dhe palë blerëse shtetasin Saimir Hysa, për automjetin tip “Renault Megane”, në vlerën 500.000 lekë.

29.3 Nga verifikimi i procesverbalit të mbajtur më 15.3.2016 në ILDKPKI⁷⁶ konstatohet se subjekti e ka qartësuar vlerën e blerjes së automjetit.

29.4 Ndërsa lidhur me burimin e krijimit të shumës 500.000 lekë për blerjen e automjetit, subjekti ka deklaruar se kanë shërbyer të ardhurat nga punësimi i tij, si dhe të bashkëjetueses E.T (sot bashkëshortja).

29.5 Në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar se e ka shitur automjetin tip “Renault Megane” me targë ***, në vlerën 3.000 euro⁷⁷. Të ardhurat nga shitja e këtij mjeti Komisioni i ka përfshirë në analizën e kryer për vitin 2010.

⁷³ Pyetësor nr. 2, datë 30.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁴ Pyetësor nr. 2, datë 30.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁵ Me pyetësin nr. 2, datë 30.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁶ Administruar me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2020.

⁷⁷ Sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.5.2010, depozituar me pyetësin nr. 2, datë 30.3.2023.

29.6 Komisioni, pasi kreu analizën financiare në datën e investimit për automjetin tip “Renault” me targë ***, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuara, ku vlera e mjetit është marrë në konsideratë 500.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të investojë në blerjen e këtij mjeti, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

30. Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2010 blerjen e automjetit tip “Renault Megane” me targë *****, në vlerën 4.000 euro.

30.1 Nga korrespondenca e Komisionit me DPSHTRR-në⁷⁸ rezultoi se ky mjet është blerë vlerën 6.200 euro, sipas kontratës datë 27.7.2010. Sipas deklaratës doganore me nr. reference R 40127, datë 30.7.2010, zhdoganimi i mjetit është kryer për shumën 283.132 lekë.

30.2 Lidhur me burimin e krijimit, subjekti ka deklaruar gjatë hetimit se si burim për këtë mjet ka shërbyer: *“Shuma 3.000 euro, përfutur nga shitja e tip “Renault” me targë ***, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.5.2010; shuma prej 300.000 lekësh cash, deklaruar prej meje në deklaratimet periodike vjetore paraardhëse, por për të cilën nga pakujdesia nuk kam deklaruar pakësimin e saj në deklaratën e vitit 2010; si dhe të ardhurat nga punësimi të miat dhe të bashkëjetueses time. Lidhur me gjendjen cash në procesverbalin e pyetjes në vitin 2014 në ILDKPKI, kam deklaruar gjendjen cash 0 (zero) në banesë, gjë që provon përdorimin e kësaj shume për këtë qëllim. Për këtë mjet nga ana ime është paguar detyrimi doganor në shumën 283.000 lekë. Dua të saktësoj se vlera e blerjes të këtij automjeti ka qenë rreth 6.200 euro, por unë nuk e disponoj dokumentin e blerjes së tij për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar”.*

30.3 Lidhur me kursimet *cash*, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pakësimin e tyre në vitin 2010. Komisionit i rezultoi se të vetmet deklarime të subjektit për likuiditetet në *cash* janë: (i) në vitin 2006, ku ka deklaruar vlerën 100.000 lekë; (ii) në vitin 2008, ku ka deklaruar shtimin e tyre me 200.000 lekë. Pas këtij viti subjekti nuk rezultoi të ketë deklaruar shtesa apo pakësime.

30.4 Komisioni, nga verifikimi i procesverbalit të mbajtur në datën 15.3.2016 në ILDKPKI⁷⁹, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se gjendja *cash* në datën 31.12.2014 është 0 (zero) lekë.

30.5 Komisioni nuk ka vlerësuar të marrë në konsideratë këtë deklaram të subjektit gjatë hetimit dhe, në këto kushte, e ka mbajtur të pandryshuar vlerën e likuiditeteve *cash* prej 300.000 lekësh, për sa kohë që nga subjekti nuk është deklaruar ndonjë ndryshim në asnjë deklaratë periodike.

30.6 Komisioni kreu analizën financiare në datën e zhdoganimit të mjetit, 30.7.2010.

30.7 Nga analiza duket se: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi në shumën 67.926 lekë të investojë në blerjen e këtij mjeti, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare; (ii) ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me vlerën e shpenzuar për këtë pasuri, pasi në deklaratën periodike ka deklaruar 4.000 euro, ndërsa sipas dokumentacionit të administruar dhe deklaramit të tij gjatë hetimit ka rezultuar se ka shpenzuar 6.200 euro dhe 283.132 lekë për zhdoganimin. Në këto kushte⁸⁰, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit, si dhe për të depozituar dokumentacion justifikues në mbështetje të shpjegimeve të tij.

⁷⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 27.10.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁹ Administruar me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2020.

⁸⁰ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

30.8 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se nuk ka pasur detyrim ligjor për të deklaruar për bashkëjetuesen e tij dhe, për këtë arsye, nuk ka deklaruar kursimet *cash* të saj në fund të çdo viti. Nga analiza financiare e Komisionit rezulton që ajo ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për kursime në shumën 100.000 lekë në vit dhe në fund të vitit 2009 ka pasur minimalisht shumën 100.000 lekë gjendje *cash*. Subjekti ka sqaruar se nga analiza rezulton që kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit dhe me një balancë pozitive prej 32.074 lekësh. Subjekti ka saktësuar se në vitin 2009 Komisioni ka llogaritur shpenzime udhëtimi për bashkëshorten në Itali në periudhën 15.2.2009 – 14.3.2009, shumën 1.530 euro = 188.950 lekë. Ai ka deklaruar: *“Këtë fakt unë e kam deklaruar në pyetësin nr. 1 dhe kam sjellë dokumente të cilat po jua ridërgoj, që vërtetojnë se qëllimi i vizitës në Itali ka qenë për trajnim profesional pranë kompanisë elektro-energjetike italiane “***”, me qendër në Milano-Itali dhe 100% të shpenzimeve janë mbuluar nga “***”, ndaj kërkoj nga Komisioni ta saktësojë”*.

Lidhur me deklarimin e gabuar të çmimit të konstatuar me të drejtë, subjekti ka pranuar se nga ana e tij në DPV-në e vitit 2010 nuk është deklaruar saktë çmimi real i blerjes së automjetit prej 6.200 euro, por 4.000 euro. Ky ka qenë një lapsus/pasaktësi, e cila është kryer pa asnjë qëllim për të ndryshuar vlerën reale të mjetit, për më tepër që për nga vetë natyra e profesionit që ushtroj prej 30 vjetësh e di që verifikimi i këtij fakti bëhet përmes një veprimi fare të thjeshtë rutinor. Ai ka deklaruar: *“Unë i kisha plotësisht mundësitë financiare për ta blerë këtë mjet me këtë çmim, fakt që konfirmohet nga vetë analiza financiare që Komisioni ka bërë, ku rezulton një balancë negative për një shumë prej 67.900 lekësh, balancë që rezulton pasi në analizë nuk është përfshirë si burim shuma prej 300.000 lekësh që ai kishte gjendje cash në banesë dhe që ka qenë deklaruar prej tij në DPV-në e viteve 2008 – 2009, gjë që e konsideron të gabuar”*. Subjekti ka sqaruar se e ka deklaruar të shpenzuar këtë shumë në vitin 2014 para ILDKPKI-së, pra ajo diku është shpenzuar, dhe ka pretenduar se Komisioni nuk është shprehur për këtë fakt. Për këtë shkak, subjekti ka kërkuar që ajo të përfshihet në analizë, ku sipas tij ai jo vetëm justifikon blerjen e këtij mjeti, por ka edhe bilanc pozitiv. Subjekti i mëshon faktin që ka dorëzuar në dy institucione kontratën origjinale të blerjes me vlerën reale 6.200 euro, në DRSHTTR Tiranë dhe në Doganën e Tiranës, ku edhe është gjetur nga Komisioni dhe se prej tij detyrimi doganor është paguar mbi bazën e vlerës reale të mjetit 6.200 euro, ai nuk ka bërë asnjë ndërhyrje në këtë dokument për të ulur vlerën e tij, qoftë për ta deklaruar në vlerë më të vogël apo për të ulur vlerën e detyrimit doganor, gjë për të cilën pretendon se duhet vlerësuar si rrethanë me vlerë të lartë provuese. Subjekti ka sqaruar se duke dorëzuar dokumentin origjinal natyrisht që është lehtësisht e identifikueshme dhe e verifikueshme vlera reale e blerjes së mjetit, gjë për të cilën shprehet se e di dhe se nuk do të mund ta bënte. Subjekti ka pranuar se duhet të ishte treguar më i kujdesshëm në deklarim, por për ilustrim një lapsus të tillë sqaron se e ka bërë edhe në vitin 2007 kur ka deklaruar blerjen e një mjeti në vlerën 5.000 euro, në një kohë që realisht ishte blerë 500.000 lekë, rreth 200.000 lekë më pak, veprim që shkante “në dëmin” e tij. Subjekti e rikujton këtë fakt për simetri me deklarimin e vitit 2010, për të krijuar bindjen se ka qenë diçka e paqëllimshme dhe pa synuar fshehjen apo deklarimin e rremë të pasurisë.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

30.9 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të shumta të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, konstaton se në periudhën e krijimit të pasurisë objekt hetimi, bashkëshortja e tij ka qenë në statusin e bashkëjetueses dhe, për rrjedhojë, për shkak të ligjit të kohës nuk ka pasur detyrimin për deklarim. Sikurse rezultoi përgjatë hetimit, nga kryerja e analizës financiare, viti 2009 është mbyllur në balancë pozitive. Trupi gjykues vlerëson se balanca negative e rezultuar në një vlerë të papërfillshme, e cila rikuperohet nga përdorimi i kursimeve të mundshme të një viti më parë,

të cilat nuk ishin detyrim për t'u deklaruar. Njësia e Shërbimit Ligjor kreu përlllogaritjet, duke zbritur nga shpenzimet e udhëtimit të bashkëshortes udhëtimin e saj në vitin 2009 për qëllime punë, për të cilin subjekti ka depozituar certifikatën e pjesëmarrjes. Me gjithë përlllogaritjet, trupi gjykues konstatoi se ky ndryshim nuk afekton analizën financiare, pasi viti 2009 rezultoi me balancë pozitive. Trupi gjykues nuk konsideron pretendimin e subjektit për përdorimin e gjendjes *cash*, për sa kohë nuk është deklaruar pakësimi i saj në deklaratën periodike. Gjithashtu, trupi gjykues, deklarimin e pasaktë të subjektit për vlerën e mjetit e konsideron pa peshë në vlerësimin tërësor të kësaj vendimmarrjeje, për sa kohë shuma nuk shoqërohet me pamundësi financiare⁸¹.

31. Komisioni hetoi edhe në lidhje me të ardhurat e përfituara nga qiratë, referuar gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar⁸², për të cilën ishte konstatuar se:

31.1 Subjekti i rivlerësimit ka vazhduar të jetojë me familjarët e tij, duke dhënë me qira apartamentin që ka blerë në vitin 2011. Ai nuk ka paraqitur dokumente për tatimin e paguar mbi qiranë në vitin 2015. Për më tepër, të dhënat nga zyra e tatimeve tregojnë se ai ka paguar tatim mbi qiranë në vitin 2011 (shihni dokumentin nga Ministria e Financave nr. *** prot., datë 1.8.2017, dosja e ILDKPKI-së/ bashkëlidhur).

31.2 Duket se subjekti nuk ka deklaruar të ardhura nga qiraja që nga viti 2011.

31.3 Komisioni e ka pyetur⁸³ subjektin lidhur me këto konstatime paraprake, nga ku ai ka sqaruar se në vitin 2011 nuk ka paguar asnjë lloj tatimi mbi qiratë, pasi nuk kishte asnjë pasuri të dhënë me qira. Subjekti ka sqaruar se *shkresa e DRT-së Tiranë, depozituar në dosjen e ILDKPKI-së, është e pasaktë*. Lidhur me pagimin e detyrimeve për banesën e dhënë me qira nga viti 2015 e në vijim, të ndodhur në rrugën “***”, subjekti ka sqaruar se e ka depozituar dokumentacionin përkatës dhe ato shuma janë pasqyruar edhe në analizën financiare që Komisioni ka bërë.

31.4 Subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 6.7.2023, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.

31.5 Komisioni nga verifikimi i saj vëren se informohet mbi shkresën nr. *** prot., datë 1.8.2017, drejtuar ILDKPKI-së, ku saktësohet se në të jepen të dhëna për subjektin “***”, person fizik, me NIPT ***, me administrator z. S.S.H, me datëlindje ***.1972, dhe jo për shtetasin Saimir Z. Hysa, me ID ***. Informacioni saktëson se nga ana e shtetasit Saimir Z. Hysa, me ID ***, nuk rezulton të jetë kryer pagesë për tatimin mbi qiranë për vitin 2011.

31.6 Për sa më sipër, pas sqarimit të plotë të kësaj çështjeje, për të cilën rezultoi se informacioni nuk i referohej subjektit të rivlerësimit por një subjekti tregtar, trupi gjykues nuk ngre dyshime për këtë çështje dhe nuk vëren ndonjë problematikë lidhur me të.

32. Komisionit, nga aksesimi në sistemin multifunksional të ASHK-së, nga verifikimi i të gjithë korrespondencës me ASHK-në⁸⁴, DPPShtetit për sistemin TIMS, AMF-në dhe RNSH-në, nuk i rezultuan të dhëna dhe informacione të tjera përveçse atyre të konfirmuara e të trajtuara në këto rezultate hetimi.

Vlerësimi tërësor i pasurisë

33. Në përfundim, bazuar në konkluzionet më lart, për të gjitha pasuritë e deklaruar të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë,

⁸¹ Referuar vendimit të Kolegjtit, nr. ***, datë 12.10.2021.

⁸² Nr. ***prot., datë 26.5.2023, administruar në dosjen e Komisionit në versionin anglisht dhe në përkthimin shqip.

⁸³ Me pyetësorin nr. 10, datë 30.6.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.11.2020, subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi aplikues në procesin e legalizimit.

arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Saimir Hysa, ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, duke pasur parasysh se mungesa e burimeve të ligjshme në një vlerë totale prej 706.720 lekësh për blerjen e pasurisë automjet, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk mund të përbëjë shkak të mjaftueshëm për të dhënë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

B. KONTROLLI I FIGURËS

34. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës, nr. *** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, deklasifikuar me vendimin nr. ***, datë 14.10.2022, të KDZH-së, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Saimir Hysa.

34.1 Nga hetimi i Komisionit për vlerësimin e këtij kriteri, rezultoi se AKSIK-ja⁸⁵ në informacionin e përcjellë konfirmon se nuk disponon të dhëna të përditësuara për përfshirje të subjektit në veprimtari të kundërligjshme.

34.2 Trupi gjykues, në kushtet që nga hetimi i kryer: (a) nuk konstatoi mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave nga subjekti i rivlerësimit; (b) nuk evidentoi rrethana të cilat mund të përbënin *indicie* për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit apo të mund të cenonin figurën e subjektit, sipas dispozitave ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016; (c) nuk gjeti asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës – çmon se subjekti i rivlerësimit, z. Saimir Hysa, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

35. Raporti është përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

35.1 Raporti⁸⁶ ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

35.2 Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) 4 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (iii) 5 dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iv) të

⁸⁵ Mbi kërkesën e Komisionit nr. *** prot., datë 28.3.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸⁶ Nr. *** prot., datë 27.4.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

dhënave nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore, Sektori i Protokoll - Arkivit, si dhe burimeve arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

35.3 Dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

35.3.1 Gjatë periudhës së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit, prokurori, ka përzgjedhur dhe ka paraqitur 4 dokumente ligjore⁸⁷.

35.3.2 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentet: (1) vendim për vlerësimin e punës së prokurorit për vitin 2012; (2) vendim për vlerësimin e punës së prokurorit për vitin 2013; (3) vendim për vlerësimin e punës së prokurorit për vitin 2014.

35.4 Përshkrimi i 5 dosjeve për prokurorin Saimir Hysa, të përzgjedhura me short

Nga shorti i hedhur rezulton se janë përzgjedhur në mënyrë rastësore 5 dosje⁸⁸, një që i përket llojit të aktit “vendim mosfillimi”, dy dosje të cilat i përkasin llojit të aktit “vendim pushimi” dhe dy dosje që i përkasin llojit të aktit “kërkesë për gjykim”.

Analiza e gjetjeve⁸⁹

35.5 Analiza e gjetjeve në këtë raport bazohet në 3 burime informacioni:

- formulari i vetëvlerësimit dhe dokumenteve bashkëlidhur, të paraqitura nga vetë subjekti;
- dosjet e përzgjedhura me short;
- dokumentacioni arkivor pranë Sektorit të Protokoll - Arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme, të dhënat nga 23 Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informativë dhe Zyra e Informacionit të Klasifikuar, Sektori i Protokoll-Arkivit, si dhe burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

35.6 Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga analiza e 4 dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se prokurori Saimir Hysa, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit. Prokurori Saimir Hysa shfaq aftësi shumë të mira në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi. Ai përdor arsyetim të qartë dhe lidh drejt normën ligjore me zbatimin e saj në rastin konkret hetimi. Ai ka njohuri të plota rreth instituteve të së drejtës penale. Ai shfaq njohuri të mira edhe në drejtim të kuptimit dhe zbatimit të akteve që normojnë fushën e ndërtimit, institucioneve përgjegjëse në këtë fushë, detyrave përkatëse

⁸⁷ (1) Vendim për pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2013, datë 24.5.2014; (2) vendim për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. ***, viti 2013, datë 15.1.2014; (3) kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. ***, viti 2013, datë 21.5.2013; (4) vendim për pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2015, datë 10.2.2015. Aktet janë ndërmjet datës 8.10.2013 dhe datës 8.10.2016.

⁸⁸ Dosja nr. 1 nënkupton dokumentin ligjor “Vendim për mosfillimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2015”, akt i datës 1.7.2015, mbi kallëzimin penal nr. ***, datë 3.6.2015, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; dosja nr. 2 nënkupton dokumentin ligjor “Vendim për pushimin e çështjes nr. *** të vitit 2016”, akt i datës 21.6.2016, si dhe procedimin penal nr. ***, datë 11.6.2016, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; dosja nr. 3 nënkupton dokumentin ligjor “Vendim për pushimin e çështjes nr. *** të vitit 2013”, akt i datës 20.6.2014, si dhe procedimin penal nr. ***, datë 19.12.2013, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; dosja nr. 4 nënkupton dokumentin ligjor “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2016”, akt i datës 4.10.2016, si dhe procedimin penal nr. ***, datë 22.8.2016, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; dosja nr. 5 nënkupton dokumentin ligjor “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2014”, akt i datës 5.9.2014, si dhe procedimin penal nr. ***, datë 25.6.2014, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁸⁹ Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

të çdo punonjësi të këtyre institucioneve. Prokurori Hysa shfaq njohuri të plota në drejtim të kuptimit të normave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Nga dosjet e vëzhguara konstatohet se ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret për procedimet për të cilat janë ndjekur nga prokurori. Kështu, menjëherë pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti i rivlerësimit përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshtuar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre. Në 4 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se prokurori identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme, bën interpretim sistematik dhe logjik të normës ligjore në raport me faktin e referuar dhe konkludon në një zgjidhje ligjore të rastit.

b) Arsyetimi ligjor

Nga analiza e 4 dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë prokurori dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara evidentohet se subjekti i rivlerësimit, z. Saimir Hysa, shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej tij kanë shtjellim të kuptueshëm. Ai organizon aktin në përputhje me standardet e pranuar për aktet përkatëse dhe tregon kujdes që konkluzionet e tij përfaqësojnë një lidhje koherente mes fakteve të parashtruara në akt dhe bazës ligjore të përdorur gjatë arsytimit.

Tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej tij të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore dhe etike. Në aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se nga ana e tij bëhet analizë mbi rrethanat e faktit, analizë e zgjeruar e provave të mbledhura, provave të paraqitura nga mbrojtja, si edhe kërkesave dhe pretendimeve të mbrojtjes, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore të çështjeve në ndjekje.

35.7 Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Sipas të dhënave rezultojnë se për periudhën e punës prokurori ka trajtuar 1116 çështje. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar në datën 5.6.2020, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për përzgjedhjen e 5 dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit qershor 2014 – tetor 2016 rezultojnë se nga ana e prokurorit Saimir Hysa tregohet vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara. Konkretisht, kohëzgjatja e trajtimit të çështjeve që lidhen me dosjet 1, 2, 3, 4 dhe 5 ka qenë respektivisht: dosja 1 – kallëzimi penal nr. 7063, viti 2015, me datë regjistrimi 3.6.2015 dhe datë mosfillimi 1.7.2015, kohëzgjatja 28 ditë; dosja 2 – procedimi penal nr. ***, viti 2015, me datë regjistrimi 11.6.2016 dhe datë pushimi 21.6.2016, kohëzgjatja 10 ditë; dosja 3 – procedimi penal nr. ***, viti 2013, me datë regjistrimi 19.12.2013 dhe datë pushimi 20.4.2014, kohëzgjatja 4 muaj e 1 ditë; dosja 4 – procedimi penal nr. ***, viti 2016, me datë regjistrimi 22.8.2016 dhe datë dërgimi për gjykim 4.10.2016, kohëzgjatja 9 muaj e 12 ditë; dosja 5 – procedimi penal nr. ***, viti 2014, me datë regjistrimi 25.6.2014 dhe datë dërgimi për gjykim 5.9.2014, kohëzgjatja 2 muaj e 10 ditë. Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti Saimir Hysa ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuar dhe numrit total në çështjeve të përfunduara për të gjithë periudhën e vlerësimit.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore

Prokurori Saimir Hysa kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet që nga ana e subjektit të rivlerësimit veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke

mblodhur provat e aktet e nevojshme dhe konkluduar në një vendimmarrje. Lidhur me njoftimet e vendimmarrjeve, konstatohet se është respektuar detyrimi për të kryer njoftimet përkatëse subjekteve. Gjithashtu vihet re se qëndrimi i prokurorit në seancë gjyqësore është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e tij të arsyetuar ligjor lidhur me çështjet objekt gjykimi.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Prokurori ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit.

35.8 Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë prokurori, si dhe nga dosjet e hedhura në short ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nuk rezulton të ketë pasur ankesa se nga ana subjektivit të jenë kryer veprime apo mbajtur qëndrime të tilla jo në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Saimir Hysa dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 4 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e rëna në short nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektivit të rivlerësimit, prokurorit Saimir Hysa. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej 4 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektivit të rivlerësimit.

35.9 Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Nga 4 dokumentet ligjore të vetëpërzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe 5 dosjet e përzgjedhura në short vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, nga vlerësimet e punës së subjektivit Saimir Hysa për vitet 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit.

c) Gatishmëria për t’u angazhuar

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t’u angazhuar, subjekti Saimir Hysa rezulton se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë programit të formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës. Konkretisht rezulton të ketë marrë pjesë në aktivitete profesionale, si trajnimi me temë “Ndryshimet e Kodit Penal me ligjin nr. 23/2012 dhe ligjin nr.

144/2013”); veprat penale kundër personit; krimet kundër jetës; veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, zhvilluar në datën 5.4.2014, organizuar nga Shkolla e Magjistraturës në kuadër të veprimtarisë së trajnimit vazhdues.

C/1. Rivlerësimi profesional

35.10 Nga analizimi i të gjithë dokumenteve ligjore të administruara dhe dosjeve hetimore të përfunduara nga subjekti i rivlerësimit, ashtu sikurse ka rezultuar edhe në raportin e vlerësimit profesional, duket se nuk vërehen problematika në lidhje me rivlerësimin e këtij kriteri.

35.11 Nga korrespondenca e mbajtur me SPAK-un⁹⁰ rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit:

35.11.1 Nuk është regjistruar ndonjë procedim penal.

35.11.2 Konfirmohet se ka pasur material kallëzues nga shtetasi K.D dhe se pas kryerjes së verifikimeve për këtë material është vendosur të dërgohet për vlerësim në Prokurorinë e Përgjithshme.

i. Komisioni i kërkoi kësaj të fundit informacion në lidhje me këtë çështje, si dhe dokumentacionin shoqërues. Rezultoi se Prokuroria e Përgjithshme⁹¹ ka dërguar kallëzimin e shtetasit K.D për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

ii. Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se shtetasi D. ka kallëzuar subjektin e rivlerësimit, disa shtetas të tjerë, gjyqtarin e çështjes, si dhe noterin publik V.S. Ai, ndër të tjera, pretendon se prej shtetasve të tjerë i është vjedhur prona nëpërmjet mashtrimit, falsifikimit dhe përdorimit të dokumenteve të falsifikuara në dëm të interesave të tij pasurorë, duke iu tjetërsuar pasuria. Në këtë kallëzim, kallëzuesi referon procedimin penal nr. ***, i hetuar nga subjekti i rivlerësimit, për të cilin citon se ai ka shpërdoruar detyrën, pasi ka vendosur pushimin e çështjes pa kryer hetime të plota. Denoncuesi nuk ka prezantuar veprimet apo mosveprimet konkrete të subjektit të rivlerësimit. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në datën 1.4.2020 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për materialin e kallëzuar nga shtetasi K.D, pasi nga hetimi nuk ka rezultuar që shtetasit e kallëzuar, prokurorë e gjyqtarë, të kenë kryer ndonjë veprim në mospërmbyllje të rregullt të detyrës së tyre, duke cilësuar në vendim se nëse palët në proces vlerësojnë si të padrejtë vendimmarrjen e tyre ligji ka parashikuar mjete dhe forma të cilat mund të përdoren brenda afateve procedurale për t’u ankuar në gjykatë ose gjykatë më të lartë, e cila do të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e veprimeve të kryera nga prokurori e gjyqtari.

Mbi ankesën e shtetasit K.D

iii. Çështja D. është trajtuar në raportin profesional të subjektit të rivlerësimit në rubrikën e ankesave, në kuadrin e kallëzimit të bërë nga ky shtetas ndaj subjektit të rivlerësimit, nën akuzën “shpërdorimi i detyrës”. Sikurse u citua më sipër mbi këtë kallëzim, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Komisioni ka trajtuar këtë çështje mbi të cilën duket se nuk diktoheshin problematika.

iv. Në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar parashtrohet mbi kallëzimin për shpërdorim detyre, sipas të cilit vendimi i pushimit i referohet kryesisht faktit që prokurorët veprojnë në mënyrë të pavarur; se çështjet e pasurive të paluajshme trajtohen nga gjykata civile; dhe se pretendimet e z. D. ndaj znj. K. ishin trajtuar tashmë nga subjekti i rivlerësimit në hetimin e tij të viteve 2008 – 2009.

⁹⁰ Referuar përgjigjes së këtij institucioni, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 16.1.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

v. Materiali referon se z. D. i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Tiranë në vitin 2008 për akuzat “vjedhje”, “mashttrim” dhe “falsifikim të dokumenteve”, kundër znj. K. dhe të tjerëve. Z. D. pretendon se Prokuroria nuk e ka hetuar rastin dhe për një periudhë të gjatë kohore (2008 – 2010) as nuk e ka vënë në dijeni atë për vijimin e procedurave. Pas shumë kërkesave për t’u informuar lidhur me procedimin, z. D. mësoi se çështja ishte pushuar nga subjekti. Z. D. pretendon se nuk ka marrë kurrë një njoftim për përfundimin/pushimin e procedurës në mënyrë që ta apelonte atë. Pas kërkesave të tjera, Prokuroria njoftoi se dosja e tij kishte humbur dhe nuk mund të gjendej në arkivin e saj.

vi. Nga vendimi i pushimit (i Prokurorisë së Rrethit Durrës) të akuzës ndaj subjektit të rivlerësimit rezulton se subjekti ka nisur hetimin penal për pretendimet ndaj znj. K. dhe të tjerëve, më 1.10.2008. Në datën 1.9.2009, subjekti i rivlerësimit ka pushuar procedimin për falsifikim të dokumenteve dhe shpërdorim detyre. Në datën 17.3.2010, z. D. i është komunikuar vendimi i pushimit.

vii. Komisioni, në referencë të materialit të vëzhguesit ndërkombëtar, hetoi nëse subjekti i rivlerësimit kishte respektuar dhe kishte vepruar në përputhje me dispozitat penale gjatë trajtimit/hetimit të çështjes, sikurse pretendon z. D. Sipas materialit referues, thuhet se duket *prima facie* se hetimi (nëse ka pasur një të tillë) është zhvilluar për më shumë se 3 muaj, që është afati kohor normal i përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale. Nuk është e qartë nëse vendimet e shtyrjes, hetimi gjithëpërfshirës apo njoftimi i palës së dëmtuar/D. janë nxjerrë gjatë periudhës tetor 2008 – shtator 2009. Duket tepër i vonuar në kohë njoftimi i pushimit të hetimit i muajit mars 2010.

viii. Lidhur me këtë çështje, Komisioni administroi kopje të fashikullit penal.

ix. Nga aktet e administruara rezultoi:

- Me vendimin datë 1.9.2009 është vendosur pushimi i procedimit penal nr. 31.8.2008 nga subjekti i rivlerësimit. Procedimi penal është regjistruar (mbi kallëzimin nr. ***) në datën 2.10.2008, për veprat penale “falsifikim të dokumenteve nga persona që ka për detyrë t’i lëshojë” dhe “mashttrim”, parashikuar nga nenet 186/3 dhe 143/2 të Kodit Penal. Në datën 29.9.2008, prokurori i çështjes/subjekti i rivlerësimit ka mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga kallëzuesi K.D si personi që ka dijeni për veprën penale (në ndryshim nga pretendimi i z. D. se nuk ka marrë asnjëherë informacion nga Prokuroria/subjekti i rivlerësimit për procedurat dhe ecurinë e çështjes). Në datën 9.10.2008, subjekti i rivlerësimit ka vendosur për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve të ndodhura në ZVRPP dhe zyrën e noteres. Në datën 14.10.2008, OPGJ-ja ka mbajtur procesverbal për marrje në dorëzim të kopjeve të disa dokumenteve nga shtetasja E.V (vajza e znj. S.V/shitëses së pasurisë në mënyrë të përsëritur). Po në këtë datë, nga OPGJ-ja është mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga shtetasja E.V, si personi që ka dijeni për veprën penale. Në datën 16.10.2008 është mbajtur procesverbal nga OPGJ-ja në ZVRPP për këqyrje dhe marrje dokumentacioni. Në nëntor 2008, nga OPGJ-ja është mbajtur procesverbal në ZVRPP-në Tiranë, për të marrë kopje dokumentacioni. Në datën 17.11.2008, nga OPGJ-ja është mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga kallëzuesi D. si personi që ka dijeni për veprën penale. Në datën 26.11.2008, nga OPGJ-ja është mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga shtetasi Q.D si personi që ka dijeni për veprën penale. Në datën 1.12.2008, OPGJ-ja ka mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, shtetasja S.V. Në datën 12.12.2008, nga OPGJ-ja është mbajtur procesverbal për ballafaqimin e dy shtetasve D, respektivisht K. dhe Q.D. Në datën 15.12.2008 janë këqyruar dhe marrë kopje të dokumentacionit të vlerësuar nga OPGJ-ja pranë zyrës noteriale. Në datën 18.12.2008, nga OPGJ-ja është mbajtur procesverbal për marrje të kopjes së dokumenteve zyrtare nga regjistrat kadastralë nga shtetasi K., si dhe është mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga ky shtetas, me detyrë agronom në Komunën P., si personi që ka dijeni për veprën penale. Në dhjetor 2008, nga OPGJ-ja është mbajtur procesverbal për marrjen

e të dhënave nga shtetasi T., si kryeplak i fshatit M., si personi që ka dijëni për veprën penale. Në dhjetor 2008, nga OPGJ-ja është mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga notere V.S, si personi që ka dijëni për veprën penale. Në datën 18.12.2008, OPGJ-ja ka urdhëruar paraqitjen e regjistrueses së Zyrës Rajonale të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe përgjegjësit të zonës kadastrale, për t'u paraqitur në Prokurori në datën 23.12.2008. Në datën 9.1.2009, OPGJ-ja ka mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga shtetasja E.R, me detyrë *** me punë pranë KKKPronave, shtetasja D.S, me detyrë *** në ZVRPP-në Tiranë, si persona që kanë dijëni për veprën penale. Në datën 14.1.2009, OPGJ-ja ka mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga shtetasi B.P, si personi që ka dijëni për veprën penale.

Në datën 15.1.2009, OPGJ-ja ka përpiluar relacionin për përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, ku ka sugjeruar pushimin e çështjes, pasi fakti nuk parashikohet si vepër penale. Në datën 18.1.2009, OPGJ-ja ka mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga shtetasi B.P, si personi që ka dijëni për veprën penale. Në datën 7.7.2009, një tjetër prokuror ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprat penale “mashttrim” dhe “falsifikim të dokumenteve”, për shkak të kthimit nga gjykata të po të njëjtës çështje për t'u regjistruar dhe hetuar e vënë në lëvizje nga kallëzuesi D. që prej vitit 2007, për të cilin organi i akuzës kishte vendosur mosfillimin e saj në datën 19.12.2007⁹² (mosfillimi është vendosur nga një tjetër subjekt rivlerësimi). Me vendimin datë 31.8.2009, ky procedim është bashkuar me procedimin penal nr. *** (sikurse thuhet në vendimin e pushimit të procedimit penal të subjektit të rivlerësimit) i nisur gjithashtu mbi bazë të kallëzimit penal të shtetasit D., për të njëjtin fakt. Sipas pretendimeve të denoncuesit se ka pasur shumë kërkesa në prokurori për t'u njoftuar çështja e pushuar, nga aktet e administruara në dosje nuk gjendet e administruar asnjë kërkesë e kësaj natyre dhe po ashtu edhe vetë z. D. nuk ka depozituar një të tillë në ankesën e tij drejtuar organit të akuzës. Po ashtu, sipas pretendimeve të denoncuesit se kur ka kërkuar njoftimin zyrtar për pushimin e çështjes ka marrë përgjigje se dosja e tij kishte humbur dhe se nuk mund të gjendej në arkivat e Prokurorisë, nga aktet e administruara nuk rezultoi asnjë akt që të pasqyronte këtë pretendim, po ashtu edhe vetë z. D. nuk ka depozituar dokumentin/përgjigjen nga organi i akuzës se dosja kishte humbur.

x. Për sa përshkruhet më sipër, në gjendjen që ndodheshin aktet e fashikullit penal, dukej se: (i) hetimi i procedimit është zhvilluar për më shumë se 3 muaj, në tejkalim të afatit ligjor të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale (neni 323/2); (ii) kishte paqartësi nëse subjekti ka disponuar me urdhërime/vendime për shtyrje të afatit të hetimit të këtij procedimi pas datës 18.12.2008; (iii) kishte paqartësi nëse ish-in kryer veprime të tjera hetimore pas datës 18.1.2009, në raport me kohën e gjatë deri në marrjen e vendimit të pushimit të procedimit penal shtator 2009; (iv) dukej tepër i vonuar në kohë njoftimi i vendimit të pushimit të hetimit në mars 2010, ndërsa çështja ishte pushuar në shtator të vitit 2009; (v) nuk kishte të dhëna lidhur me statusin e vendimit të pushimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, pra nëse ai është ankimuar dhe, nëse po, çfarë kishte ndodhur me rastin.

xi. Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të jepte shpjegime dhe të dokumentonte të kundërtën e konstatimeve paraprahe. Gjithashtu, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegonte dhe dokumentonte lidhur me pretendimet e denoncuesit për njoftimin e vonuar të vendimit të pushimit, si dhe lidhur me përgjigjen e dhënë për humbjen e dosjes.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

35.12 Subjekti, ndër të tjera, në prapësime ka shpjeguar: *“Pas nxjerrjes nga arkiva të dosjes së procedimit penal nr. ***, viti 2008, deklaroj se hetimi për këtë procedim nga dita e regjistrimit deri*

⁹² Vendim i ankimuar në Gjykatë, prishur dhe kthyer për regjistrim e kryerje të veprimeve hetimore edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë, në datën 7.5.2009.

*në ditën e marrjes të vendimit për pushimin e hetimeve ka zgjatur prej 1.10.2008 – 1.9.2009. Në total 11 muaj, që duke përfshirë edhe një muaj të pushimeve më duket një periudhë e arsyeshme hetimi për një çështje të kësaj natyre dhe jo nga 2008 – 2010 si pretendohet në gjetjen e vëzhguesit. Kallëzimi është depozituar në datën 23.9.2008 dhe unë brenda pak ditëve, më 1.10.2008 kam bërë regjistrimin e procedimit penal. Pa asnjë vonesë, vetëm pas 7 ditësh nga ana ime është përpiluar urdhri për kryerjen e veprimeve hetimore, duke ngarkuar për kryerjen e tyre OPGJ-në Z.K”. Subjekti ka cituar se shkaktar kryesor për zgjatjen e hetimit ka qenë qëndrimi i pasinqertë i kallëzuesit, i cili nuk ka kallëzuar saktësisht rrethanat e kallëzimit, duke fshehur faktin që në të vërtetë konflikti ishte mes tij dhe vëllait të tij dhe jo personave që ai kishte kallëzuar, gjë që ka detyruar organin e akuzës të arrijë tek e vërteta pas kryerjes së hetimeve të plota, ku sipas subjektit, një pjesë e të cilave mund të mos ishin kryer nëse kallëzuesi do e parashtronte faktin në Prokurori me sinqeritet. Subjekti deklaroi se nga ana e tij dhe nga oficerja e ngarkuar me hetimin e kësaj çështjeje janë kryer veprime të shumta dhe të plota hetimore që lidhen me marrjen e dokumentacionit, këqyrjet e nevojshme, si dhe pyetjen e personave që kanë dijeni për hetimin, përfshirë këtu edhe kryeregjistruesin e ish-ZVRPP-së Tiranë. Subjekti thekson se edhe prej tij i është mbajtur një deklaram kallëzuesit për rrethanat e kallëzimit, veprim që për shkak të ngarkesës që ka nuk është se bëhet shpesh. Subjekti ka sqaruar se ka dhënë zgjidhje ligjore të saktë dhe në përputhje të plotë me provat e marra gjatë hetimit. Ai ka sqaruar se në kuadër të hetimeve të këtij procedimi nuk është përpiluar asnjë urdhër për regjistrimin e emrit të personit në regjistrin e njoftimeve të veprave penale si autor të ndonjë vepra penale. Sipas nenit 287/1 të Kodit të Procedurës Penale, që ka qenë në fuqi në vitin 2008: “Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale”. Sipas nenit 323/1 të Kodit të Procedurës Penale të kohës “Brenda tre muajve nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, prokurori vendos dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin ose pezullimin e saj”. Subjekti ka shpjeguar se mbi këto fakte nuk ka pasur asnjë arsye për të marrë vendim për të zgjatur afatin e hetimeve sipas nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale, veprim që lidhet domosdoshmërisht me momentin e regjistrimit të emrit të personit në regjistrin e njoftimeve të veprave penale dhe jo me momentin e regjistrimit të procedimit penal. Subjekti, pretendimin se nga ana e tij nuk i është bërë njoftim ose i është bërë njoftim tepër i vonuar kallëzuesit/denoncuesit, e deklaroi të gënjeshtërt. Ai ka konkretizuar se sipas dosjes hetimore, në faqen 10 ndodhet e qepur shkresa me objekt “Njoftohet vendimi për pushimin e çështjes” drejtuar shtetasit K.D, në adresën e deklaruar prej tij, rruga “****” N. ***, Tiranë. Pavarësisht se në Kodin e Procedurës Penale të kohës nuk ka pasur një dispozitë urdhëruese që detyron prokurorin të njoftonte personin që kishte bërë kallëzim për pushimin e çështjes, në vështrim të nenit 329/1 të Kodit të Procedurës Penale dhe në bazë të urdhrin të brendshëm të Drejtuesit të Prokurorisë, subjekti ka sqaruar se në çdo rast kur çështja pushohej nga ana e tyre, ky vendim i komunikohet të pandehurit dhe të dëmtuarit ose personit që kishte bërë kallëzimin mbi bazën e të cilit ishte regjistruar çështja. Njoftimi bëhej me shkrim, në rrugë postare, duke i dërguar një kopje të vendimit me shkresë zyrtare që nënshkruhej nga Drejtuesi i Prokurorisë, pasi ai nënshkruante për arkivimin e dosjes. Detyra e prokurorit të çështjes ka qenë përpilimi i shkresës në dy kopje, një kopje e së cilës lidhej në dosje, kurse shkresa tjetër bashkë me një kopje të vendimit të pushimit i dërgohej kallëzuesit. Në rastet kur adresa ishte e pasaktë ose shkresa kthehej nga shërbimi postar, vendimi i njoftohej kallëzuesit kundrejt nënshkrimit në kopjen e shkresës së lidhur në dosje që dokumentonte datën e marrjes, datë që lidhej me të drejtën e tij për të bërë ankim. Pasi dosja lidhej dhe numërtohej, i dorëzohej zv/drejtuesit të linjës, i cili pasi e lexonte dhe, në rast se ishte dakord me vendimin e prokurorit, ia kalonte Drejtuesit të Prokurorisë, i cili nënshkruante në kapakun e dosjes për arkivimin e saj. Pasi*

nënshkruante Drejtuesi, shkresa i kalonte sekretarisë, e cila bënte protokollimin e saj dhe i dërgonte kallëzuesit vendimin dhe bënte arkivimin e dosjes. Subjekti thekson se detyra e tij si prokuror i çështjes ka mbaruar në momentin kur ka dorëzuar dosjen e lidhur, brenda së cilës ndodhet edhe shkresa e njoftimit tek zv/drejtuesi i Prokurorisë. Në rastin konkret rezulton se Drejtuesi i Prokurorisë, në datën 6.10.2009, ka nënshkruar në kapakun e dosjes për arkivimin e saj. Po kështu, shkresa që ndodhet në dosje është e nënshkruar prej tij, por nuk është e protokolluar. Ai ka deklaruar se: *“Unë detyrimin tim për përpilimin e shkresës përcjellëse dhe futjen e saj në dosje e kam kryer. Natyrisht që drejtuesi do të ketë nënshkruar të dyja kopjet e shkresës dhe jo vetëm një. Çfarë ndodh më pas nuk është as detyra dhe as përgjegjësia ime, por e sekretarisë dhe zyrës të protokollit apo shërbimit postar”*. Subjekti ka deklaruar se pavarësisht se ai detyrimin e tij e ka përmbushur plotësisht, nga verifikimi që ka bërë në librin e protokollit i ka rezultuar se pas arkivimit të dosjes më 6.10.2009, nga sekretaria e Prokurorisë i është bërë komunikimi i vendimit të pushimit shtetasit K.D me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2009. Subjekti ka depozituar një fotokopje të librit të dorëzimit për vitin 2009, ku sipas tij, vërtetohet ky fakt. Lidhur me statusin e dosjes, subjekti ka sqaruar se shtetasi K.D kundër vendimit të tij ka bërë ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me vendimin nr. *** akti, datë 17.11.2010 (subjekti ka depozituar një kopje), Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka shqyrtuar rastin, e ka rrëzuar kërkesën e bërë nga shtetasi K.D për shfuqizimin e vendimit të pushimit të datës 1.9.2009 për pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2008. Kundër këtij vendimi shtetasi K.D ka bërë ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 21.4.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 17.11.2010.

Subjekti ka deklaruar se ky fakt hedh poshtë sa pretendon shtetasi K.D se nuk ka marrë kurrë një njoftim për përfundimin/pushimin e procedurës në mënyrë që ta apelonte atë, pasi rezulton se ai jo vetëm ka marrë dijeni, por edhe e ka ankuar vendimin duke e ndjekur rastin deri në Gjykatën e Apelit.

Sipas pjesës arsyetuese të vendimit të Gjykatës, këtij shtetasi vendimi i është komunikuar në shtator të vitit 2009 dhe vetë ankuesi, që ankimin e ka bërë më 24.3.2010, nuk ka paraqitur asnjë dokument se kur ka marrë dijeni për vendimin e pushimit. Subjekti ka sqaruar se: *“Nga raporti i Komisionit konstatohet se shtetasi K.D nuk ka paraqitur asnjë dokument shoqërues për denoncimin që ka bërë ndaj meje. Më së paku, ky shtetas duhej të kishte paraqitur shkresën sipas së cilës ka marrë përgjigje nga organi i Prokurorisë se dosja kishte humbur apo “kërkesat e shumta” dhe që ai paska bërë për të marrë vendimin e pushimit që i ishte dërguar në rrugë postare në adresën që ai ka depozituar bashkë me kallëzimin”*. Subjekti pretendon se këtij shtetasi mund t'i ishin kërkuar provat, ku i mbështeste pretendimet e tij, po sipas të njëjtit standard që i është kërkuar atij që të provojë të kundërtën e gënjeshtreve të kallëzuesit/denoncuesit. Subjekti sqaron se *pretendimi i tij se është njoftuar nga Prokuroria se dosja kishte humbur është absurd, pasi dosja edhe sot ndodhet në arkiv. Edhe para Gjykatës ky shtetas nuk ka paraqitur qoftë edhe një dokument të vetëm për sa ka pretenduar para jush*. Në përfundim, subjekti ka deklaruar se lidhur me këtë barrë prove ai ka dhënë shpjegime të plota dhe të mbështetura në prova të pakundërshtueshme se nga ana e tij është zbatuar ligji me përpikëri dhe ato që pretendon shtetasi K.D janë tërësisht të pavërteta.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

35.13 Trupi gjyqësor, në analizë të shpjegimeve të subjektit, hetimit të kryer dhe dokumentacionit të administruar, konstaton se subjekti ka dhënë sqarime të plota lidhur me këtë çështje. Nga aktet e administruara rezultoi se për këtë çështje, nuk është regjistruar emër i të dyshuarit, ndaj periudha 11-mujore e zgjatjes së hetimit ka qenë atribut i subjektit për shkak të kryerjes së një sërë veprimesh hetimore, të cilat u provuan me akte shkresore. Nga verifikimi i kopjes së librit të dorëzimit për vitin 2009 vërtetohet se është bërë komunikimi i vendimit të pushimit shtetasit K.D me shkresën nr. ***

prot., datë 8.10.2009, dhe jo në mars 2010. Trupi gjykues vëren se subjekti ka konfirmuar edhe statusin e çështjes nga ku konstatohet se vendimi i tij ka mbetur në fuqi. Po ashtu, nga verifikimi i akteve të administruara, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë kërkesë të denoncuesit për njoftimin e vendimmarrjes së organit të akuzës, ndaj edhe pretendimi i subjektit se nuk ekziston një e tillë, qëndron. Po nga aktet e administruara në dosje, trupi gjykues nuk vërejt ndonjë përgjigje të dhënë nga institucioni se dosja e tij kishte humbur dhe se nuk mund të gjendej në arkivat e Prokurorisë, por edhe nga vetë z. D. nuk rezultoi të jetë depozituar një përgjigje e tillë nga organi i akuzës, fakte këto të cilat provojnë se edhe pretendimet e denoncuesit rezultojnë të pavërteta. Për këtë çështje, trupi gjykues nuk konstaton ndonjë problematikë që të mund të ndikojë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

35.14 Në vijim, po nga raporti i vlerësimit profesional konstatohet se pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale të ish-Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nuk ka rezultuar të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

35.15 Nga korrespondenca e Komisionit me Prokurorinë e Përgjithshme dhe prokuroritë e rretheve (informacion i përcjellë nga organi epror/Prokuroria e Përgjithshme) konstatohet se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan⁹³ ka konfirmuar se ndaj subjektit të rivlerësimit është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, i bërë nga shtetasi R.I, nën akuzën “shpërdorimi i detyrës”. Kallëzuesi ka pretenduar për themelin e çështjes për hetime të padrejta të kryera nga subjekti në çështjen penale për të cilën ai ishte akuzuar dhe dënuar nga gjykata me 14 vjet burgim, nën akuzën “marrëdhënie seksuale me të mitura” dhe “marrëdhënie seksuale me dhunë me të mitura në moshën 14-18 vjeç”. Për këtë kallëzim, organi i akuzës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, pasi fakti i kallëzuar nuk përbën veprë penale.

Në lidhje me denoncimet e depozituara në Komision, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016

36. Denoncim⁹⁴ i shtetases E.C

36.1 Denoncuesja në denoncimin e saj ankohet për vendim të padrejtë të subjektit të rivlerësimit për “Mosfillim të procedimit penal”, me objekt kallëzimi “Pengesë të ekzekutimit të vendimit gjyqësor”, duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit po mbron palën e kallëzuar nga ana e saj, duke shpërdoruar në këtë mënyrë detyrën. Lidhur me këtë pretendim denoncuesja ka depozituar kallëzimin penal nr. ***, viti 2019, si dhe kopje të vendimit *për mosfillim procedimi* të prokurorit Saimir Hysa, datë 9.11.2019.

36.2 Nga verifikimi i denoncimit Komisioni konstaton se denoncuesja nuk parashtron shkelje konkrete të kryera nga subjekti i rivlerësimit, por pretendon për vendimmarrje të padrejtë.

36.3 Nga verifikimi i akteve të administruara, Komisioni konstaton se subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal bazuar në nenin 290/1, shkronja “ç”, duke arsyetuar se veprimet përmbartimore janë kryer sikurse edhe vetë kallëzuesja i ka parashtruar ato, ndërkohë që tjetërsimi i pasurisë së pretenduar nga kallëzuesi është kryer gjatë kohës që vendimi gjyqësor nuk kishte marrë formë të prerë, duke konkluduar se në rastin në fjalë, fakti “objekt i kallëzimit penal” nuk përmban elemente të veprës penale të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal. Rezultoi se subjekti ka njoftuar palën kallëzuese, e cila ka ushtruar ankim ndaj këtij vendimi.

⁹³ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹⁴ Denoncim nr. *** prot., datë 18.2.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

36.4 Në rrethanat e parashtruara, Komisioni konstaton se pretendimet lidhen me themelin e çështjes dhe, në tërësi, duket se nuk evidentohen problematika që mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit.

37. Denoncim⁹⁵ i shtetasit V.M

37.1 Denoncuesi në denoncimin e tij ankohet për disa subjekte rivlerësimi, duke adresuar edhe ankesën mbi vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit ndaj “Vendimit të mosfillimit mbi kallëzimin penal të kryer nr. ***, datë 11.12.2019”, kallëzuar për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Sipas denoncuesit, subjekti, në takimin e datës 16.1.2020 me palën e interesuar, ka shfaqur qëndrimin se veprimet e kallëzuara në përmbajtje të materialit kallëzues nuk përmbajnë elemente të veprës penale. Denoncuesi pretendon se ka kërkuar përjashtimin e prokurorit dhe se nuk është pajisur me kopje të vendimit të mosfillimit të këtij procedimi, si dhe me aktet e dosjes, duke i penguar e vonuar qëllimisht kundërshtimin e vendimit të marrë nga subjekti i rivlerësimit.

37.2 Nga verifikimi i përmbajtjes së këtij denoncimi, Komisioni vëren se⁹⁶ bazuar në referimin e Drejtorisë Vendore të Policisë, në datën 11.12.2020, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, për veprën penale “pastrimi i produkteve të veprës penale”, për të cilën subjekti ka vendosur mosfillimin e tij. Nga dokumentacioni bashkëlidhur këtij denoncimi nuk rezulton të jetë paraqitur vendimi i mosfillimit të këtij procedimi. Lidhur me pretendimin e denoncuesit se ai nuk është pajisur me kopje të vendimit të mosfillimit të këtij procedimi dhe me aktet e dosjes, duke e penguar e vonuar qëllimisht kundërshtimin e vendimit të marrë nga subjekti i rivlerësimit, pas kërkesës së Komisionit⁹⁷ në përgjigje subjekti ka konfirmuar⁹⁸ dhe dokumentuar se kallëzimi nr. *** është regjistruar mbi bazën e referimit të ardhur nga DVP Tiranë. Ai ka shpjeguar se për këtë kallëzim, me vendimin e datës 18.1.2020, nga ana e tij është vendosur mosfillimi i procedimit. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim shtetasi V.M dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** regj. themeltar, datë 3.3.2020, ka vendosur mospranimin e kërkesës për shfuqizim të këtij vendimi, të paraqitur nga shtetasi V.M.

37.3 Subjekti ka depozituar kopje të vendimit për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. ***, datë 18.1.2019, dhe printim të vendimit nr. *** regj., datë 3.3.2020, të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Tiranë.

37.4 Në ndryshim nga pretendimi i denoncuesit, Komisionit i rezultoi se ai ka ushtruar ankim dhe, më tej, ka vijuar edhe procesi gjyqësor ndaj vendimit të mosfillimit.

37.5 Për këtë çështje është referuar edhe në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar. Materiali ka parashtruar faktet dhe rrethanat e çështjes.

i. Në datën 11.12.2019, Prokuroria e Rrethit Tiranë ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, bazuar në kallëzimin e Seksionit kundër Pastrimit të Parave pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, për *pastrim të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*, sipas nenit 287 të Kodit Penal. Policia iu referua informacionit mbi një kontratë dhurimi të pjesëve takuese të pasurisë së paluajtshme të datës 2.10.2018, nga tre shtetas për një shtetas tjetër. Policia konstatoi se nuk kishte asnjë lidhje mes palëve në kontratë për të justifikuar dhurimin, ndërsa gjatë periudhës dhjetor 2018 – janar 2019 bashkëshorti i njëjës prej dhuruesve (B. K.) kishte depozituar në llogarinë e tij disa

⁹⁵ Denoncim nr. *** prot., datë 4.2.2020, nr. *** prot., datë 3.2.2020, nr.*** prot., datë 9.7.2021 dhe nr. *** prot., datë 4.7.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹⁶ Sipas vërtetimit datë 16.1.2020, lëshuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁹⁷ Me pyetësorin datë 4.4.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹⁸ Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, datë 4.4.2023, drejtuar subjektit me tekst në *email*.

shuma parash, përafërsisht 45.000 euro. Sipas policisë, natyra reale e kontratës duhet të ishte ajo e shitjes. Policia ka dhënë gjithashtu informacione për disa transaksione bankare të dhuruesve, informacion për pasuritë e tyre të paluajtshme dhe informacion nga sistemi TIMS. Bazuar në sa më sipër, policia kërkoi fillimin e procedimit penal ndaj këtyre personave për *pastrim të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale*.

ii. Në datën 18.1.2020, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për shkak të mungesës së bazës ligjore. Sipas subjektit të rivlerësimit, policia nuk i referohej veprimtarisë kriminale apo veprës penale që gjeneronte paratë në fjalë. Referimi nga policia për “kontratën e shitjes së hartuar në formë dhurimi për arsye të panjohura”, sipas subjektit të rivlerësimit ishte krejtësisht i pamjaftueshëm për të pasur dyshimin më të vogël të mundshëm për ekzistencën e veprës penale për fillimin e procedimit penal. Subjekti i rivlerësimit iu referua nenit 293 “Referimi i veprës penale në Prokurori” të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit *policia gjyqësore i referon prokurorit, me shkrim, elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur deri atëherë, duke treguar burimet e provës dhe veprimet e kryera, si dhe vë në dispozicion të prokurorit, për vlerësim, të gjitha aktet dhe provat e marra*.

iii. Sipas subjektit të rivlerësimit, policia nuk e ka respektuar këtë dispozitë, nuk ka paraqitur asnjë element, fakt apo hap hetimor për të provuar veprimtarinë kriminale që ka gjeneruar gjendjen *cash*. Sipas subjektit të rivlerësimit, policia gjyqësore duhet të veprojë me iniciativë për verifikimin e fakteve dhe fillimin e procedimit penal dhe referimin e faktit në Prokurori.

iv. Subjekti i rivlerësimit iu referua edhe një rrethane tjetër që nuk lejonte fillimin e procedimit penal, konkretisht një vendimi të mëparshëm të Prokurorisë për të mos hetuar një kallëzim penal nga z. M. të datës 14.1.2019, për një kontratë dhurimi të pavlefshme sipas procedurës civile. Prokuroria arsyetoi në atë kohë (shkurt 2019) se kontrata e dhurimit, në thelb duke qenë shitjeje, nuk përbënte veprë penale, nuk mund të cilësohej si e falsifikuar dhe mund të shfuqizohej nga një gjykatë civile.

v. Bazuar në sa më sipër, subjekti i rivlerësimit arsyetoi se nuk mund të fillonte procedimin pasi ishte vendosur tashmë nga Prokuroria për këtë fakt dhe pasi fakti i referuar nga policia gjyqësore nuk përmbante elementet e domosdoshme të veprës penale. Ai e bazoi vendimin e tij në nenet 290/1/e dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale.

vi. Gjykata ka pushuar çështjen sepse z. M. është tërhequr nga ankimi, pasi synonte të bënte një tjetër kallëzim penal më konkret për këtë çështje.

37.6 Për sa më sipër, dukej se: (i) subjekti ka rezultuar në vendimin e mosfillimit të procedimit penal në tejkallim të afatit të parashikuar në ligj (datë 18.1.2020/shihni nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale/15 ditë), pasi kallëzimi penal është regjistruar në datën 11.12.2019; (ii) bazuar në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale vendimi i mosfillimit të procedimit penal është njoftuar në tejkallim të parashikimit ligjor (pas 10 ditëve të marrjes së vendimit), ku thuhet se prokurori, në këtë rast subjekti, duhet t’i njoftonte menjëherë vendimin e mosfillimit kallëzuesit/ve, ndërkohë që shkresa e Prokurorisë për njoftimin e z. M. mban datën 28.1.2020; (iii) nuk përbën bazë ligjore për mosfillimin e procedimit penal, fakti që policia gjyqësore nuk e ka dokumentuar plotësisht faktin/veprën ose e ka cilësuar gabimisht veprën penale, siç pretendon subjekti i rivlerësimit; (iv) subjekti ka neglizhuar ekzistencën e fakteve penale ose nevojën për ndjekje penale, që konsiston të paktën në evazion fiskal të mundshëm nga ana e palëve, mosdeklarim të të ardhurave, duke lënë mënjanë edhe pastrimin e produkteve të veprës penale; (v) kallëzimet e z. M. kanë adresuar dy vepra penale të ndryshme, ku në rastin objekt hetimi çështja është adresuar për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale sipas nenit 287 të Kodit Penal dhe, për pasojë, duket se ky kallëzim nuk mund të quhej i njëjtë

apo i ndërvarur me kallëzimin e mëparshëm datë 14.1.2019, ku akuza e kallëzuesit referonte veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

Në këto kushte⁹⁹, subjektit iu kërkua të shpjegojë dhe dokumentojë të kundërtën e konstatimeve më sipër.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

37.7 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se lidhur me barrën e provës për këtë rast, në bazë të gjetjes së vëzhguesit¹⁰⁰, në aktin që i është vënë në dispozicion ka konstatuar pasaktësi, mosnjohje të legjislacionit shqiptar, si dhe interpretim të deformuar të argumenteve që ka dhënë në vendimin për mosfillim. Subjekti ka shpjeguar se denoncuesi nuk e gëzon cilësinë e “kallëzuesit”, pasi kallëzimi nr. *** është regjistruar mbi bazën e referimit të ardhur nga policia gjyqësore në DVP Tiranë dhe ai nuk ka pasur në hetim asnjë kallëzim të bërë prej tij, ndaj nisur nga ky fakt ai ka shpjeguar se nuk ka pasur asnjë arsye që këtë vendim t’ia komunikonte këtij shtetasi brenda 10 ditëve dhe, për këtë shkak, ai nuk e ka bërë. Subjekti nën këtë sqarim deklaroi se nuk i ka cenuar denoncuesit asnjë të drejtë dhe po ashtu deklaroi se nuk e ka shkelur këtë dispozitë.

Subjekti qartëson se vendimin ia ka njoftuar policisë gjyqësore me shkresën nr. ***, datë 14.1.2020, për ta njohur me vlerësimin që i ka bërë referimit të tyre. Subjekti ka shpjeguar se sipas nenit 291/2 të Kodit të Procedurës Penale: *“Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit”*. Subjekti ka deklaruar se komunikimi i vendimit që i është bërë denoncuesit nga Prokuroria më 28.1.2020 nuk i është bërë me këtë cilësi, por me kërkesë të veçantë të bërë prej tij dhe për këtë deklaroi se ai ia ka pranuar këtë kërkesë, duke i dhënë një kopje të vendimit të mosfillimit si “person i interesuar” dhe jo “kallëzues” me të drejtë ankimi. Pikërisht për të shmangur rrëzimin e ankimit që kishte bërë në Gjykatë për mungesë të legjitimitetit për të bërë ankim, ai hoqi dorë nga ankimi, duke pretenduar se do të paraqiste një kallëzim tjetër në Prokurori, fakt që citohet edhe në gjetje. Shtetasi V.M ka pretenduar vazhdimisht se ka bërë kallëzim pranë Drejtorisë së Përgjithshme kundër Pastrimit të Parave, por ky organ nuk gëzon atributet e organit të ndjekjes penale apo policisë gjyqësore. Sipas nenit 283/2 të Kodit të Procedurës Penale: *“Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit”*. Pra, ligji ka përcaktuar vetëm këto dy organe, ku qytetari mund të drejtohet për të bërë kallëzim penal. Subjekti ka shpjeguar se ky shtetas nuk është subjekt, që, lidhur me këtë kallëzim, gëzon të drejtat që i njeh neni 291/2 i Kodit të Procedurës Penale. Lidhur me këtë çështje, subjekti ka shpjeguar se *shtetasi V.M në vitin 2019 ka paraqitur një kallëzim ndaj shtetasve S.SH, noter publik, V.C, V.K (motrat e tij) dhe K.M, duke pretenduar se këta shtetas kishin kryer veprën penale “falsifikimi i dokumenteve”. Kallëzimi është paraqitur në Prokurorinë e Rrethit Durrës, e cila e ka përcjellë për kompetencë tokësore në Prokurorinë e Rrethit Tiranë. Prokurori i ngarkuar me këtë material kallëzues me nr. ***, në datën 27.2.2019, ka vendosur mosfillimin e procedimit sipas nenit 290/a/ç të Kodit të Procedurës Penale, duke vlerësuar se fakti i kallëzuar nuk përbënte vepër penale. Kundër këtij vendimi V.M ka bërë ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga gjyqtari A.M, me vendimin nr. *** regj., datë 7.6.2019, është rrëzuar kërkesa e V.M, me arsyetimin se “konflikti i pretenduar është i natyrës administrative civile” dhe se “vijimi i hetimeve nga organi i Prokurorisë do të shërbente si mjet që palët në konflikt të siguronin prova në funksion të konflikteve civile, administrative etj.”. Subjekti thekson: “Në këtë vendim ka konstatuar se ky kallëzim ishte bërë*

⁹⁹ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

¹⁰⁰ Nr. ***, datë 26.6.2023.

nga shtetasja L.M, bashkëshortja e V.M, edhe më parë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, që e kishte referuar në Prokurorinë e Rrethit Tiranë, e cila në datën 11.2.2019 kishte vendosur mosfillimin e procedimit për kallëzimin e shtetasit V.M, me nr. ***, fakt për të cilin ai deklaroi se nuk ka pasur dijeni kur kam marrë këtë vendim. Sa i takon përmbajtjes së këtyre kallëzimeve, gjyqtari në këtë vendim ka konstatuar se “çështja për të cilën është vendosur mosfillimi i procedimit penal nr. ***, viti 2019, është e njëjtë me çështjen konkrete që po gjykon Gjykata (nr. ***, viti 2019), duke e konsideruar këtë rast si “gjë të gjykuar”. Të njëjtin fakt ka referuar seksioni kundër pastrimit të parave në DVP-në Tiranë në kallëzimin nr. ***. Pavarësisht termave të “mëdha” që përdor ankuesi V. M në letrat e tij të pafundme, çështja në thelb është një konflikt familjar që lidhet me mosdakordësinë për mënyrën e administrimit të një prone në bashkëpronësi të ndodhur në Durrës mes V.M dhe motrave të tij V.C dhe V.K. Dy motrat e tij kanë lidhur një kontratë dhurimi me shtetasin K.M, për dhurimin e pjesëve takuese të tyre në këtë pronë. V.M ka pretenduar se kjo kontratë është fiktive, pasi në të vërtetë ka qenë kontratë shitjeje, nisur nga fakti se mes dhuruesve dhe pranuesit të dhurimit nuk kishte asnjë marrëdhënie që të motivonte këtë dhurim. Ankesat e tij për këtë fakt lidhen me mosrespektimin e të drejtës së parablerjes, duke shmangur ofertën që duhej t’i ishte bërë atij fillimisht konform nenit 204 të Kodit Civil për të blerë pronën përmes një kontrate fiktive dhurimi. Ky është thelbi i konfliktit dhe duket qartë se nuk ka asnjë veprimtari kriminale në mes. Fakti nëse ky veprim përbën ose jo falsifikim është trajtuar në dy kallëzime penale të bërë prej familjes M., për të cilat organi i Prokurorisë ka vlerësuar se nuk përbën vepër penale, por konflikt civil, duke vendosur mosfillimin e procedimit, vendime këto të lëna në fuqi edhe nga Gjykata. I njëjti fakt, në mënyrë identike, është referuar edhe nga policia gjyqësore e DVP-së Tiranë se “dyshohet se bëhet fjalë për një kontratë shitjeje të hartuar në formën e një kontrate dhurimi për arsye të panjohura”. Pavarësisht se në referim nuk citohet, konstatoj se informacioni që policia gjyqësore pretendon se disponon, ka ardhur nga DPP-ja, ku shihet qartazi se është vënë në lëvizje nga kërkesat me shkrim që V. dhe L.M kanë bërë në DPP dhe në “Platformën për Bashkëqeverisje” dhe jo nga ndonjë investigim me iniciativë të tyre. Ky fakt citohet edhe në kërkesën e datës 27.12.2019, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Tiranë, ku V.M deklaroi se “Jam personi që kam vënë në lëvizje organet përkatëse shtetërore për fillimin e procedimit penal”. Në këtë kërkesë ai përsëri citon “Kam denoncuar një kontratë fiktive, përpiluar nga noteri S.SH..., si dhe një qarkullim parash të qarkulluara në dorë në të zezë jashtë sistemit bankar”. Pavarësisht këtij citimi, në referim nuk më është vënë në dispozicion asnjë informacion për lëvizje parash jashtë sistemit bankar etj., përveç disa veprimeve rutinë (shkresa ku kërkohej informacion për pasuritë e personave të kallëzuar), veprime hetimore këto të parakohshme, për sa kohë nuk ishte saktësuar nëse ekzistonte fakti penal apo jo. Policia gjyqësore më ka referuar vetëm dyshimin se kontrata është fiktive, pasi është realisht shitje dhe jo dhurim. Nga Prokuroria në dy vendime mosfillimi që nuk janë marrë nga unë është përcaktuar qartësisht se ky fakt nuk përbën vepër penale, por edhe nga Gjykata”. Subjekti pretendon se ai nuk duhet të fillonte një hetim të ri për një fakt për të cilin ishte marrë dy herë vendim për mosfillim nga dy kolegë të tjerë. Ai sqaron se sado të ndryshohet emërtimi apo cilësimi ligjor i faktit dhe pavarësisht se nga cili vjen, qytetar/polici gjyqësore/institucion shtetëror, mbetet po ai dhe kallëzimet e shtetasve V. dhe L.M janë po të njëjta dhe parimi i “gjësë të gjykuar” e ndalon nisjen e hetimit. Duke qenë se nuk ekziston asnjë veprimtari kriminale apo vepër penale, për rrjedhojë, nuk mund të kemi vepër penale në kuptim të nenit 287 të Kodit Penal. Subjekti ka deklaruar se në ndryshim nga sa thuhet në gjetje, në vendimin e tij nuk flitet në asnjë rresht për punë të dobët të policisë apo se ka qenë ky shkaku që ai ka vendosur mosfillimin, pavarësisht se në rastin konkret ka theksuar se edhe mund ta kishte thënë, pasi referimi ishte tepër i dobët

nga pikëpamja profesionale, nisur nga fakti se vinte nga një shërbim i Policisë Gjyqësore i specializuar dhe i trajnuar më së miri. Ndaj, ka theksuar ai, jo pa qëllim kam konstatuar në vendim faktin se “nuk është vënë në dispozicion asnjë e dhënë, nuk është kryer asnjë veprim hetimor apo informacion mbi elementet thelbësore të faktit”. Për më tepër që nuk është cituar vepra penale që paska gjeneruar këto pasuri të paligjshme dhe që po tentojnë të “pastrohen” nga personat e kallëzuar. Subjekti ka sqaruar se lidhur me sa pretendohet për “evazion fiskal”, ky fakt nuk qëndron, pasi sipas legjislacionit shqiptar dhurimi i pasurive të paluajtshme tatohet njësoj si shitja, pra nga ana e dhuruesve është paguar tatimi sipas referencës së zonës ku ndodhet pasuria pasi, në rast të kundërt, nga ASHK-ja nuk bëhet kalimi i pasurisë nga dhuruesi tek përfituesi i dhurimit. Subjekti pranon tejkalimin e afatit 15-ditor për marrjen e vendimit të mosfillimit, sikurse është parashikuar në nenin 291/1 të Kodit të Procedurës Penale, por argumenton se kjo ka ndodhur për shkak të ngarkesës së madhe që kanë pasur këto kohë, si dhe për faktin se në fund të vitit ka një rritje tej normales së ngarkesës, shkelje për të cilën mendon se duhet vlerësuar nga Komisioni në kuadër të parimit të proporcionalitetit.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

37.8 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar, i çmon të argumentuara dhe të bazuara ligjërisht pretendimet e subjektit lidhur me çështjen e njoftimit të vendimit të mosfillimit të materialit kallëzues, për sa kohë kallëzimi nr. *** është regjistruar mbi bazën e referimit të ardhur nga policia gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë. Trupi gjykues e konsideron të së njëjtës natyrë hetimin e çështjes nga të tjerë prokurorë për të njëjtën veprë penale, “falsifikimi i dokumenteve”, por referimi i adresuar në këtë rast duket se i përket veprës penale “pastrimi i produkteve të saj” (parashikuar në nenin 287 të Kodit Penal) edhe pse policia gjyqësore në këtë referim duket se është mjaftuar me kërkimin e denoncuesit pranë DPPPP-së dhe shkresën e kësaj të fundit ia ka vënë në dispozicion organit të akuzës, ndërsa në fakt nuk rezulton të ketë investiguar vetë si referues i çështjes lidhur me të dhënat e administruara.

Në vëmendje të trupit gjykues, në vlerësimin e kësaj çështjeje është edhe statusi aktual i saj, për të cilin pavarësisht se denoncuesi ka ushtruar ankim ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se ai vetë është tërhequr nga gjykimi në po këtë gjykatë. Nga materiali referues vërehet se policia gjyqësore ka referuar vetëm dyshimin se kontrata është fiktive, pasi është realisht shitje dhe jo dhurim, por në vërtetimin datë 16.1.2020 të organit të akuzës, depozituar nga denoncuesi, thuhet se materiali i policisë është regjistruar për veprën penale “pastrimi i produkteve të veprës penale”, për të cilën më tej është vendosur mosfillimi. Trupi gjykues, në rastin objekt hetimit, nuk e vlerëson rolin e referuesit të kallëzimit si determinant në vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, ndaj çmon se çështja mund të ishte hetuar dhe jo të mosfillohej nën dritën e gjësë së gjykuar. Ky vlerësim vjen për shkak se, nga dokumentacioni i administruar konstatohet që denoncuesi duket të ketë qenë në përpjekje të vazhdueshme institucionale për të pasur informacion të thelluar lidhur me veprimet fiktive të pretenduara prej tij në pronën objekt konflikti deri në organin e akuzës. Po ashtu duket se çështja është vënë e rivënë në lëvizje; duket se organi referues rezulton të kishte bërë disa kërkime në institucione; duket se nga subjekti çështja mund të ishte vlerësuar edhe nën dritën e nenit 293/1 të Kodit Penal, ku thuhet se me marrjen e njoftimit për një veprë penale, policia gjyqësore, pa vonesë, i referon prokurorit, me shkrim, elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur deri atëherë. Pra, duke konsideruar këto rrethana, proporcionalisht subjekti mund të kishte grumbulluar të dhëna apo marrë informacion mbi elementet thelbësore të faktit dhe mund të kishte kryer ndonjë veprim hetimor në kuadër të veprës penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, pavarësisht informacionit jo të plotë të institucionit referues. Për një konkludim më të plotë të çështjes dhe në kushtet e ndalimit të

Komisionit për zëvendësim logjik të subjektit në vendimmarrje, pa i hyrë themelit të çështjes në diskrecion të prokurorit, trupi gjykues vlerësoi që ky rast t'i kalojë për shqyrtim të mëtejshëm organit kompetent.

38. Denoncim¹⁰¹ i shtetasit E.Ç

38.1 Denoncuesi ankohet lidhur me veprimet e marra nga subjekti në disponimin e tij në vendimin e mosfillimit të procedimit penal datë 1.4.2019, kundrejt kallëzimit penal nr. ***, të bërë nga ai/denoncuesi për veprën penale “shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ndaj punonjësve të ZVRPP-së, që sipas denoncuesit kanë penguar ekzekutimin e vendimit gjyqësor të dhënë në favor të tij nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

38.2 Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit, megjithëse në datën 1 prill ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, në datën 3 prill ka vijuar të bëjë hetime. Çështja, sipas denoncuesit, pas vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit është rikthyer për të tjera hetime. Denoncuesi ka depozituar vendimin e mosfillimit, si dhe procesverbalin e organit të akuzës mbajtur nga OPGJ-ja në datën 3.4.2019, për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale.

38.3 Komisioni administroi kopje të fashikullit penal¹⁰² për të konkluduar mbi pretendimet e denoncuesit.

i. Nga aktet e fashikullit rezultoi se në organin e Prokurorisë është regjistruar në datën 20.3.2019, kallëzimi nr. ***, i shtetasit Ç. Kallëzimi ka ardhur si rezultat i mosushtrimit të detyrës nga punonjës të ZVRPP-së për të vënë në ekzekutim masën e përkohshme të sigurimit të padisë mbi pronësi të caktuar nga Gjykata, për shkak se denoncuesi kishte paditur disa shoqëri tregtare për mospërbushjen e disa detyrimeve kontraktore që ato kishin me denoncuesin/kallëzuesin.

ii. Në datën 1.4.2019 ndaj këtij kallëzimi është vendosur mosfillimi i procedimit penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale (mbështetur në nenin 290/1(ç) të Kodit të Procedurës Penale).

iii. Sipas këtij vendimi është pyetur kallëzuesi/denoncuesi dhe përmbaruesi gjyqësor, i cili ka konfirmuar se sipas përgjigjes së ZVRPP-së janë sekuestruar pasuritë në zbatim të vendimit të Gjykatës. Nga aktet e fashikullit rezultoi se përmbaruesi gjyqësor është pyetur në datën 3.4.2019 dhe po në këtë datë ka depozituar edhe aktet përkatëse.

iv. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë 24.5.2019, ka vendosur shfuqizimin e vendimit dhe urdhërimin për regjistrimin e procedimit penal, vendim i cili ka mbetur në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë 17.11.2022. Vendimi ka lënë si detyrë kryerjen e hetimeve me qëllim përcaktimin e faktit dhe veprës penale, si dhe individualizimin e përgjegjësive penale dhe të personit që e ka kryer atë. Në vendim del qartë fakti se kallëzuesi është pyetur dhe se ai duhet të ripyetet.

v. Në datën 13.1.2023 është vendosur regjistrimi i procedimit penal të këtij kallëzimi.

vi. Në datën 18.1.2023 është urdhëruar kryerja e disa hetimeve si, ripyetja e shtetasit Ç., pyetja e punonjësit të ZVRPP-së, ripyetja e përmbaruesit gjyqësor për të sqaruar veprimet përmbarimore të ndërmarra për ekzekutimin e vendimit, administrimi dhe këqyrja e akteve që certifikojnë pronësitë mbi pasuritë e paluajtshme, për të cilat është vendosur masa e përkohshme e sigurimit të padisë, si

¹⁰¹ Denoncim nr. *** prot., datë 7.6.2019 dhe nr. *** prot., datë 30.4.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁰² Përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 13.4.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

dhe kryerja e veprimeve të tjera që dalin të nevojshme. Këto veprime janë lënë për t'u kryer deri në datën 15.4.2023.

vii. Subjekti është pyetur¹⁰³ në lidhje me statusin aktual të çështjes. Në përgjigjen e dhënë ka deklaruar të njëjtat të dhëna të përshkruara më sipër, sikurse kanë rezultuar nga verifikimi i fashikullit penal.

viii. Subjekti ka shtuar se vendimi i shfuqizimit të vendimit të tij për mosfillimin e kallëzimit penal ka mbërritur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 28.12.2022 dhe në datën 13.1.2023, në zbatim të këtij vendimi, është bërë regjistrimi i procedimit penal nr. ***, për këtë kallëzim, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Me urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore të datës 18.2.2023 është kërkuar nga policia gjyqësore kryerja e veprimeve hetimore të nevojshme, duke lënë si afat për kryerjen e tyre datën 15.4.2023.

ix. Subjekti ka deklaruar se nga oficeri i policisë gjyqësore janë kryer të gjitha detyrat e lëna në urdhër, me përjashtim të pyetjes së kallëzuesit E.Ç, i cili është njoftuar në datat 17.2.2023, 24.2.2023, 10.3.2023 dhe 18.4.2023 e, pavarësisht këtyre njoftimeve nuk paraqitet, por vazhdon dhe paraqet ankesa ndaj subjektit pranë Komisionit, ILD-së, ONM-së, KLP-së, etj. Subjekti ka sqaruar se statusi aktual i çështjes është “në hetim” deri në kryerjen e veprimeve të plota.

x. Subjekti ka depozituar¹⁰⁴ të gjithë dokumentacionin që provon shpjegimet e tij.

38.4 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoj subjektit të shpjegojë lidhur me mospërputhjen e pasqyruar në vendimin e mosfillimit të çështjes datë 1.4.2019, të një veprimi hetimor të kryer nga OPGJ-ja ndaj përmbauesit më pas, në datën 3.4.2019, si dhe lidhur me moskryerjen e hetimeve, fakt i konstatuar nga gjykata, e cila ka prishur vendimin e mosfillimit të kallëzimit penal.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

38.5 Subjekti, në prapësime, ka deklaruar: (i) data reale e vendimit është 3.4.2019; (ii) vendosja e datës 1.4.2019 në vendim është një lapsus. Ai ka prapësuar se ka kërkuar nga noterja B.A këqyrjen dhe verifikimin në kompjuterin e tij të “file E.Ç” dhe nga këqyrja e saj në rubrikën “Properties” ka rezultuar se dokumenti “Mosfillim E.Ç” është krijuar (*content created*) në datën 3.4.2019, ora 12:43 dhe printimi i fundit (*last printed*) dhe i vetëm i këtij akti është bërë më 3.4.2019, ora 01:03. Subjekti ka deklaruar se këto të dhëna teknike janë të pamundura për t'u ndryshuar nga ana e tij dhe se ato i gjeneron vetë kompjuteri. Sa i takon deklaramit të përmbauesit gjyqësor, subjekti ka deklaruar se rezulton që ai është dhënë në datën 3.4.2019, ora 09:15 min. Pra, vendimi për mosfillim është marrë pasi është dhënë ky deklaram. Subjekti ka sqaruar se deklarami i cituar në vendim nuk mund të pasqyrohej nëse nuk do të ishte dhënë më parë dhe, për pasojë, kjo ka ndodhur dhe mbetet një rrethanë e pakundërshtueshme. Sa i përket prishjes së vendimit nga gjykata, subjekti ka theksuar se gjykata ka lënë detyra krejtësisht të përgjithshme, pa orientuar marrjen e ndonjë prove konkrete dhe, për këtë, subjekti ka shprehur mendimin e tij se konkluzioni i vendimit që ai ka marrë se fakti nuk përbën qartazi vepër penale ka qenë i drejtë, por gjithsesi është kryer hetimi i çështjes në drejtimet që ka orientuar Gjykata dhe ka konfirmuar se do të dilet me një vendimmarrje konkrete.

¹⁰³ Me email-in datë 7.6.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁴ Me procesverbalin nr. *** prot., datë 9.6.2023; vërtetimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 8.6.2023; shkresën nr. *** prot., datë 2.3.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; urdhrin nr. ***, datë 1.3.2023, për thirrjen e shtetasit Ç.; kthim përgjigjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. *** prot., datë 6.2.2023; urdhrin për paraqitje të shtetasit Ç., nr. *** prot., datë 16.2.2023; urdhrin nr. ***, datë 16.2.2023, për thirrjen e shtetasit Ç.; urdhrin nr. ***, datë 8.2.2023; kthim përgjigjen nr. *** prot., datë 17.2.2023; raporte shërbime datë 15.2.2023; kthim përgjigjen nr. *** prot., datë 24.2.2023; raport shërbimin datë 21.2.2023; urdhër për paraqitje nr. ***, datë 1.2.2023; kthim përgjigjen nr. *** prot., datë 10.3.2023.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

38.6 Trupi gjykues i vlerëson të argumentuara dhe, për pasojë, bindëse shpjegimet e subjektit lidhur me vërtetësinë e marrjes së vendimit në të njëjtën datë me marrjen e deklaramit nga përmbartuesi gjyqësor. Nga ana tjetër, fakti që gjykata nuk ka konkretizuar detyra për t'u kryer në kthimin e çështjes, trupi gjykues nuk konstaton ndonjë problematikë, ndaj subjektit. Trupi gjykues vlerëson se sipas nenit E¹⁰⁵ të Aneksit të Kushtetutës nuk ka kompetencë për të konkluduar mbi këtë çështje pasi rezultoi se ajo është në hetim.

39. Denoncim¹⁰⁶ i shtetasit E.S

39.1 Denoncuesi në denoncimin e tij parashtron se ka kallëzuar shtetasin B.B për shkak të dëmtimit të pronës së tij me zjarr. Denoncuesi pretendon se pasi është njohur me aktin “Njoftim për përfundimin e hetimeve...” ka vërejtur se subjekti nuk ka kryer hetime dhe ka pretenduar se ai për rreth dy vite nuk është thirrur për të dhënë deklaramime. Po ashtu, denoncuesi ka pretenduar se në datën 27.2.2020 ka paraqitur një *memo*, porse nga ana e subjektit nuk është pranuar me pretendimin se ajo është jashtë afatit. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga denoncuesi, dhe specifikisht “Njoftim për përfundimin e hetimeve”, konstatohet se në të përshkruhet fakti i dhënies së deklaramimeve nga ana e denoncuesit. Po ashtu konstatohet se subjekti ka arsyetuar shkaqet dhe pasojën e rrethanave objekt hetimi, duke referuar edhe vendimin unifikues nr. 5, datë 11.11.2003, të Gjykatës së Lartë.

39.2 Lidhur me pretendimin e denoncuesit se subjekti, në kundërshtim me nenin 110 të Kodit të Procedurës Penale, nuk i ka pranuar *memon* e paraqitur nga ana e tij, pasi është jashtë afatit, Komisioni konstaton se në përmbajtjen e denoncimit vetë denoncuesi pranon faktin që subjekti i ka vënë në dispozicion dokumentin “Njoftim për përfundimin e hetimeve”, të cilin e ka nënshkruar gjithashtu. Njëkohësisht, nga dokumentacioni i administruar duket se ka një moskoherencë në deklaramin e denoncuesit lidhur me ndërmarrjen e akteve prej tij, si *memo* apo kërkesë për informacion, krahasuar me aktin e përfundimit të hetimeve datë 23.1.2020. Kështu, denoncuesi parashtron se pas datës 23.1.2020 ka depozituar një kërkesë për informacion, ku bën me dije se nuk ka informacion se në cilën fazë është hetimi i çështjes (ndërsa kishte nënshkruar përfundimin e hetimeve), po ashtu shprehet se në datën 22.2.2020 ka kërkuar kopje të akteve, pra sërish pas përfundimit të hetimeve sqaron se në datën 27.2.2020 ka depozituar një *memo* etj. Nën këto pretendime, denoncuesi lidh çdo veprim të kryer ngushtësisht me nenin 110 të Kodit të Procedurës Penale, ku thuhet se mund të depozitohet memorie dhe kërkesa në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit.

39.3 Në rrethanat e parashtruara, Komisioni nuk evidenton ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me vlerësimin e kriterit profesional për subjektin e rivlerësimit.

40. Denoncim¹⁰⁷ i shtetasit H.SH

40.1 Denoncuesi ankohet për disa prokurorë dhe OPGJ për zvarritje të hetimeve, moskryerje të plotë të tyre me objektivitet dhe në mënyrë të drejtë. Denoncuesi ankohet për shpërdorim detyre nga disa titullarë komunarë të ish-Komunës P., kryesisht nga ish-kryetari i Komunës, i cili, sipas tij, ka përvetësuar e dhunuar pronën e tij, pa ndjekur procedurat e shpronësimit. Denoncuesi shpjegon se në vitin 2017 ka bërë kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën penale

¹⁰⁵ Neni E/2Vlerësimi i aftësive nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim.

¹⁰⁶ Denoncim nr. *** prot., datë 24.3.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁷ Denoncim nr. *** prot., datë 15.1.2021, nr. *** prot., datë 5.11.2021, nr. *** prot., datë 15.9.2021, nr. *** prot., datë 4.5.2022, nr. *** prot., datë 10.11.2021 dhe nr. ***, datë 21.2.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

“shpërdorimi i detyrës”. Prokurori (një tjetër subjekt) ka vendosur “Mosfillimin e çështjes penale”. Pas ankimimit të këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe detyrimin e saj për kryerjen e veprimeve të tjera hetimore, të cilat duhet të përfundonin brenda 60 ditësh. Ky vendim rezulton të ketë marrë formë të prerë. Sipas pretendimeve të tij, pavarësisht nga afati i lënë, kjo çështje ka qëndruar për një kohë të gjatë pa u kryer veprime hetimore dhe, më pas, përsëri prokurori ka marrë vendim për pushimin e saj. Denoncuesi deklaroi se ka paraqitur ankim në ILD dhe KLP. Ai ka sqaruar se nga ILD-ja ankesa është arkivuar, ndërsa KLD-ja i ka kthyer përgjigje në lidhje me një subjekt, i cili është shkarkuar nga Komisioni. Denoncuesi ankohet se subjekti nuk ka kryer veprime hetimore mbi çështjen e rikthyer dhe se ka vendosur me pa të drejtë pushimin e procedimit penal nr. ***, në datën 20.5.2021, çështje e cila është kthyer për hetime të tjera. Më tej, denoncuesi ka kërkuar nga Drejtuesja e Prokurorisë zëvendësimin e prokurorit të çështjes Saimir Hysa, kërkesë e cila nuk është pranuar nga ana e subjektit dhe drejtueses.

40.2 Komisioni administroi fashikullin penal¹⁰⁸, ku nga verifikimi i akteve rezultoi se subjekti, me kërkesën e datës 7.5.2021, ka kërkuar pushimin e çështjes që i përket procedimit penal nr. ***, datë 3.7.2017. Për këtë procedim hetimi është nisur që në vitin 2017 nga një tjetër prokuror. Pas kthimit të çështjes nga Gjykata në vitin 2018, janë lënë detyra për t’u kryer nga organi i akuzës. Rezulton se çështja ka kaluar tek disa prokurorë dhe së fundi është rezultuar në kërkesën e subjektit për pushimin e saj. Në kërkesë citohet se nga rihetimi i çështjes është konstatuar, përveç mungesës së elementeve të veprës penale për faktet që pretendohen nga kallëzuesi dhe që janë analizuar në vendimmarrje, është vlerësuar edhe fakti se për të njëjtën çështje ka pasur edhe kallëzime të tjera të mëparshme nga denoncuesi apo edhe anasjelltas nga të tjerë ndaj denoncuesit (gjithnjë në kuadër të konfliktit pronësor për toka të përfituara me ligjin nr. ***, për AMTP-të e disponuara dhe të kundërshtuara, etj.), të cilat gjithashtu janë pushuar dhe janë lënë në fuqi në gjykatë. Këto raste janë referuar në kërkesën e subjektit të rivlerësimit si *indicie*, të cilat tregojnë se organi i akuzës është shprehur një herë për çështjen dhe se shumë prej problematikave të kallëzuara herët janë parashkruar.

40.3 Kërkesa për pushimin e çështjes ka rezultuar në përfundimin se problematika e kontestuar nga kallëzuesi është marrëdhënie juridiko - civile dhe për këtë shkak kallëzuesi duhet t’i drejtohet gjykatës për të kundërshtuar vendimet administrative, nga të cilat mendon se është cenuar në interesat e tij pasurorë. Sipas akteve të administruara, kërkesa i është njoftuar kallëzuesit. Në vijim, çështja është kthyer për hetime të tjera me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 19.5.2021. Pas hetimeve të kryera nga një tjetër subjekt rivlerësimi është kërkuar sërish pushimi i çështjes. Hetimi rezulton i vijuar nga një tjetër subjekt për shkak se subjekti i rivlerësimit ka kërkuar dorëheqjen nga hetimi i procedimit penal nën argumentin se edhe pse kishte caktuar ekspertët për të kryer aktin e ekspertimit, ata ishin penguar në mënyrë të qëllimshme nga denoncuesi.

40.4 Në tërësi, duket se nuk evidentohet ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me vlerësimin e kriterit profesional për subjektin e rivlerësimit.

41. Denoncim¹⁰⁹ i shtetaseve L.M, M.M dhe Y.Ç

41.1 Denoncuesja ankohet se prokurori Hysa ka proceduar dhe ka hetuar ndaj të vdekurit (të ndjerit vëllait të saj) në mungesë të dijenisë së saj dhe trashëgimtarëve ligjorë. Denoncuesja pretendon se subjekti ka urdhëruar kryerjen e aktit të ekspertimit të rremë, pa dijeninë e palëve të akuzuara. Sipas denoncueses, prokurori Hysa ka bërë seancë gjyqësore pa dijeninë e palëve të interesuar.

¹⁰⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.4.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁰⁹ Denoncim nr. *** prot., datë 27.9.2019 dhe nr. *** prot., datë 23.5.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

Denoncuesja pretendon se subjekti ka abuzuar me detyrën, pasi ka bërë një hetim në kundërshtim me ligjin penal.

41.2 Nga verifikimi i vendimit nr. ***, datë 26.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, depozituar nga denoncuesja, Komisioni konstatoi se subjekti ka kërkuar *Pushimin e procedimit penal nr. *** për veprën penale “falsifikimi i dokumenteve dhe pastrimi i produkteve të veprës penale”*, parashikuar nga nenet 186/1 dhe 287/a të Kodit Penal.

41.3 Konstatohet se shtetasi A.GJ ka bërë kallëzim ndaj shtetasve XH. e L.Ç, duke pretenduar se këta shtetas me anë të falsifikimit të dokumenteve kanë mundur të kalojnë në emër të tyre një sipërfaqe toke të ndodhur në F, Tiranë.

41.4 Sipas arsytimit të vendimit gjyqësor, konstatohet se subjekti ka kryer hetime dhe, në përfundim, ka kërkuar pushimin e këtij procedimi penal, disponim ky i lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë 26.6.2019, por edhe nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë 13.10.2020. Denoncuesi ka shpjeguar se ka bërë ankim në të gjitha shkallët e gjyqësorit. Parashtrimi i denoncueses duket kontradiktor, për sa kohë ajo ankohet se ndaj saj dhe vëllait të saj është hetuar me pa të drejtë, ndërkohë që subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal mbi materialin e kallëzuesit, i cili kallëzonte pikërisht denoncuesen.

41.5 Komisioni administroi fashikullin penal¹¹⁰, ku nga verifikimi i kërkesës për pushimin e çështjes rezultoi se subjekti në përmbajtje ka pasqyruar të gjitha veprimet hetimore të kryera dhe, në përfundim, ka konkluduar se kërkesa duhet pushuar për shkak se lidhur me përgjegjësitë eventuale penale për falsifikimin apo përdorimin e këtyre dokumenteve nuk mund të ushtrohet ndjekje penale ndaj shtetasve Ç. si persona që kanë përdorur këto dokumente për shkakun se ata kanë ndërruar jetë. Nën të njëjtin argumentim është kërkuar edhe pushimi i çështjes ndaj shtetasit XH.Ç për veprën penale “pastrimi i produkteve të veprës penale”. Nga aktet vërehet se akti i ekspertimit është realizuar për shkak të pretendimit të kallëzuesit se atij i është falsifikuar nënshkrimi. Po nga dokumentacioni i administruar rezultoi se Instituti i Policisë Shkencore ka përfunduar aktin e ekspertimit tekniko - grafik, dhënë detyrë nga një tjetër prokuror, nga ku ka rezultuar se shkrimi dhe nënshkrimi në aktet objekt i ekspertimit janë të shtetasit A.GJ, pra të kallëzuesit. Duket se të dhënat e aktit të ekspertimit në vijim prezantojnë të dhëna të tjera se akti/et është/janë nënshkruar nga shtetasi GJ.. Nga verifikimi i akteve duket se palët janë përfshirë në pretendime reciproke për falsifikim dokumentesh me pasojë tjetërsime të pasurive. Aktualisht akti i ekspertimit i fundit i drejtohet një tjetër prokurori që lë të kuptohet se tanimë çështja po hetohet nga një tjetër subjekt rivlerësimi.

41.6 Në rrethanat e parashtruara Komisioni konstaton se pretendimet e denoncuesit kryesisht prezantohen për themelin e çështjes, madje denoncuesi parashtron pretendime lidhur me gjykimin e çështjes në gjykatë. Në këto kushte, duket se nuk evidentohet ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me vlerësimin e kriterit profesional, për subjektin e rivlerësimit.

42. Denoncim¹¹¹ i shtetasës SH.L

42.1 Denoncuesja ankohet ndaj vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit “Vendimit të mosfillimit të procedimit penal” datë 4.9.2020¹¹², bazuar në nenin 291, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale. Denoncuesja ka parashtruar se edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 4.11.2021, ka lënë në fuqi padrejtësisht vendimin e subjektit të rivlerësimit.

¹¹⁰ Përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 12.4.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹¹¹ Denoncim nr. *** prot., datë 13.4.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

¹¹² Mbi kallëzimin nr.*** prot., datë 25.6.2021.

42.2 Nga verifikimi i vendimit të subjektit, Komisioni konstatoi se subjekti ka arsyetuar faktin se, sipas tij, nuk ka bazë ligjore për fillimin e procedimit penal, duke argumentuar se rasti në fjalë ka referencat e zbatimit të dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Civile, konkretisht nenit 610 të tij.

42.3 Komisioni i kërkoi subjektit¹¹³ të qartësojë dhe dokumentojë statusin ligjor të kësaj çështjeje.

42.4 Subjekti ka qartësuar se kallëzimi nr. ***, viti 2021, është regjistruar në datën 25.6.2021, mbi bazën e kallëzimit të depozituar me postë nga mbrojtësit e shtetases SH.L. Për këtë kallëzim, me vendimin e datës 4.9.2021 është vendosur mosfillimi i procedimit. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim kallëzuesja SH.L dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** regj. themeltar, datë 4.11.2021, ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë. Subjekti ka depozituar kopje të vendimit për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. ***, datë 4.9.2021, dhe printim të vendimit nr. *** regj. them., datë 4.9.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

42.5 Në tërësi, Komisioni konstaton se pretendimet e denoncueses lidhen me themelin e çështjes dhe se në rastin konkret nuk vihet re asnjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me vlerësimin e kriterit profesional për subjektin e rivlerësimit.

43. Denoncim¹¹⁴ i shtetasit R.K

43.1 Denoncuesi në denoncimin e tij ankohet ndaj vendimit gjyqësor të një tjetër subjekti rivlerësimi, më konkretisht ndaj vendimit të dhënë nga gjyqtari A.GJ, i cili ka vendosur *Pranimin e kërkesës për pushimin e çështjes së subjektit të rivlerësimit*. Në përmbajtje të ankimit të tij, denoncuesi parashtron rrethanat e mosmarrëveshjes objekt të kallëzimit të tij, i lidhur me pretendime të falsifikimit të akteve të gjendjes civile. Denoncuesi ankohet se nga ana e gjyqtarit i është mohuar e drejta e ankimit, porse nuk referon ndonjë shkelje konkrete në adresë të subjektit të rivlerësimit.

43.2 Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga denoncuesi, Komisioni konstaton se pretendimet e denoncuesit nuk i referohen subjektit të rivlerësimit, por një tjetër subjekti rivlerësimi.

44. Denoncim¹¹⁵ i shtetasit SH.B

44.1 Denoncuesi në denoncimin e tij të paraqitur në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, drejtuar drejtueses së kësaj Prokurorie, ankohet se çështja e tij ka kaluar në disa subjekte rivlerësimi, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit.

44.2 Komisioni konstaton se denoncuesi nuk referon ndonjë shkelje konkrete për subjektin e rivlerësimit, si dhe nuk ka paraqitur dokumentacion.

44.3 Nga trajtimi i këtij denoncimi nuk vihet re ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me vlerësimin e kriterit profesional për subjektin e rivlerësimit.

45. Denoncim¹¹⁶ i shtetases S.M

45.1 Denoncuesja ankohet kryesisht për ekspertët mjekoligjorë, që kanë përgatitur aktin e ekspertimit mbi kallëzimin penal të kryer nga struktura e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat ku ajo ka kallëzuar shtetasen XH.D, duke pretenduar se është goditur prej saj. Gjithashtu, denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer verifikime të plota dhe nuk ka marrë asgjë parasysh në vlerësimin e kësaj çështjeje.

¹¹³ Me pyetësin nr. 3, datë 4.4.2023, përcjellë subjektit me tekst në *email*.

¹¹⁴ Denoncim nr. *** prot., datë 2.8.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

¹¹⁵ Denoncim nr. *** prot., datë 6.6.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

¹¹⁶ Denoncim nr. *** prot., datë 11.2.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

45.2 Nga verifikimi i akteve bashkëlidhur këtij denoncimi, Komisioni konstaton se mbi kallëzimin e denoncueses, subjekti i rivlerësimit ka disponuar me vendimin për mosfillimin e procedimit në datën 15.1.2020.

45.3 Rrethanat e ngjarjes për këtë çështje pasqyrojnë konflikt mes dy shtetaseve, të cilat kanë kallëzuar njëra - tjetrën. Sipas akteve të ekspertimit rezulton së dëmtimet që ka marrë denoncuesja kanë sjellë humbje të aftësisë për 9 ditë, ndërsa dëmtimet e të kallëzuarës janë vlerësuar si dëmtime të parëndësishme. Rezulton se subjekti i rivlerësimit i ka arsyetuar rrethanat e ngjarjes dhe konkluzionet e ekspertëve, duke kualifikuar veprën penale si “dëmtime të tjera me dashje” sipas nenit 90/1 të Kodit Penal.

45.4 Konstatohet se subjekti i rivlerësimit është bazuar në nenin 59/1 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit procedimi penal për këtë veprë penale fillon mbi bazën e ankimit të viktimës akuzuese, ankim që paraqitet drejtpërdrejt në gjykatë, duke disponuar për mungesë të bazës ligjore për fillimin e procedimit penal.

45.5 Komisioni, nga verifikimi i të dhënave të rezultuara në rastin konkret, nuk vëren ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me vlerësimin e kriterit profesional për subjektin e rivlerësimit.

46. Denoncim¹¹⁷ i shtetasit SH.GJ

46.1 Denoncuesi në ankesën e tij ka parashtruar pretendime që lidhen me kallëzimin penal për kryerjen e veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, kallëzim i regjistruar si procedim penal me nr. ***, i hetuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka disponuar me kërkesë para gjykatës për pushimin e këtij procedimi. Sipas denoncuesit, pretendohet se ai është njohur me përfundimin e hetimeve vetëm kur i ka ardhur fletëthirrja për gjykatë. Po ashtu, denoncuesi ankohet edhe mbi vlerësimin ligjor që subjekti i ka bërë çështjes në drejtim të hetimit për vepra të tjera penale, sikurse ka qenë “drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt”.

46.2 Lidhur me pretendimet e denoncuesit, nga verifikimi i kërkesës për pushimin e çështjes përpara gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Komisioni konstaton se rrethanat e ngjarjes parashtrohen në mënyrë të ndryshme nga pretendimet e denoncuesit, ku ky i fundit ka pranuar vetë të mos ndjekë çështjen në rrugë ligjore pasi ka rrëshqitur vetë. Komisioni konstaton se subjekti ka arsyetuar për veprën penale “drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt” dhe se mbi këtë rrethanë i kallëzuarit është ndëshkuar me masë administrative gjobë, bazuar në procesverbalin e konstatimit të shkeljes datë 3.7.2021.

46.3 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegonte dhe dokumentonte lidhur me pretendimin e denoncuesit se *është njohur me përfundimin e hetimeve vetëm kur i ka ardhur fletëthirrja për gjykatë*, si dhe të qartësonte dhe dokumentonte statusin aktual të çështjes.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

46.4 Subjekti në prapësime ka parashtruar se me kërkesën datë 11.4.2022 është kërkuar pushimi i procedimit penal nr. ***, filluar mbi bazën e kallëzimit për veprën penale të parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal dhe se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** regj. them., datë 28.10.2022, ka pranuar kërkesën duke vendosur pushimin e çështjes. Subjekti ka sqaruar se gjykimi është zhvilluar në prani të shtetasit SH.GJ, i cili sipas vendimit ka qenë dakord me kërkesën e bërë nga ana e tij/subjektit. Subjekti ka saktësuar se kërkesa për pushim i është komunikuar personit që ka bërë kallëzim me shkresë në adresën që ai ka vënë në dispozicion, rruga “***”, banesë private,

¹¹⁷ Denoncim nr. *** prot., datë 26.9.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

dhe nisur nga fakti se banesa nuk ka numër në shkresë është vendosur edhe numri i telefonit të tij për të lehtësuar detyrën e punonjësit të postës. Subjekti ka sqaruar se përtej këtij momenti, veprimet janë problem i shërbimit postar dhe jo i tij.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

46.5 Trupi gjykues i çmon bindëse dhe të provuara shpjegimet e subjektit lidhur me njoftimin e përfundimit të hetimeve denoncuesit. Ky vlerësim, përveçse i mbështetur në provë, përkon edhe me pjesëmarrjen e vetë denoncuesit në gjykim dhe dakordësinë e tij me kërkesën e subjektit për pushimin e çështjes në gjykatë, ndërsa nuk rezulton të jetë ankuar.

47. Denoncim¹¹⁸ i shtetasit G.SH

47.1 Ky denoncues ankohet ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***, të marrë nga subjekti i rivlerësimit. Denoncuesi në ankimin e tij parashtroi historinë e çështjes së tij civile që ka ndjekur në gjykatë, për të cilën është përfaqësuar nga av. A.LL, të cilit i ka dhënë nëpërmjet prokurave të përgjithshme dhe të posaçme disa tagra. Denoncuesi ankohet se përfaqësuesi i tij, av. LL., ka përfituar me pa të drejtë shuma të prejardhura nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, duke sqaruar se ai nuk e ka pasur këtë tagër në prokurë. Denoncuesi duket se ankohet për themelin e çështjes dhe nuk prezanton problematika të natyrës procedurale.

47.2 Subjekti është pyetur në lidhje me këtë çështje dhe në përgjigjen e tij¹¹⁹ ka deklaruar se procedimi penal nr. ***, viti 2019, është regjistruar mbi bazën e referimit të ardhur nga policia gjyqësore në DVP-në Tiranë, ku shtetasi G.SH kishte bërë kallëzim ndaj shtetasve T.LL dhe A.LL. Pas kryerjes së hetimeve të nevojshme me kërkesën e datës 1.22.2020, është kërkuar pushimi i çështjes mbështetur në nenin 328/1(b) të Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 15.11.2011, ka vendosur pushimin e këtij procedimi penal, duke pranuar kërkesën e organit të akuzës.

47.3 Subjekti ka shpjeguar se kundër këtij vendimi ka bërë ankim shtetasi G.SH dhe se ai nuk ka informacion nëse ankimi është shqyrtuar apo jo në Gjykatën e Apelit.

47.4 Subjekti ka depozituar kopje të kërkesës për pushimin e çështjes nr. ***, viti 2019, dhe të vendimit nr. *** regj. them., datë 15.11.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

47.5 Komisioni, pas verifikimit të të dhënave të rezultuara në dokumentacionin e administruar, nuk vëren ndonjë fakt apo rrethanë që mund të përbëjë provë në lidhje me vlerësimin e kriterit profesional për subjektin e rivlerësimit.

48. Denoncim¹²⁰ i shtetasit A.Z

48.1 Denoncuesi ankohet lidhur me çështjen nr. *** të hetuar nga subjekti i rivlerësimit. Denoncuesi ankohet së në çështjen në fjalë subjekti nuk ka verifikuar pranë ZRPP-së rolin dhe punën e punonjësve të këtij institucioni, të cilët i ka kallëzuar për shpërdorim detyre, pasi ata mbajnë të bllokuar prej vitit 2012 regjistrimin e aktit të trashëgimisë dhe lëshimin e certifikatës së pasurisë truall, bazuar në deklarata të rreme. Për këto pretendime denoncuesi ka depozituar edhe vendimin e mosfillimit penal të kësaj çështjeje.

¹¹⁸ Denoncim nr. *** prot., datë 5.4.2022, administruar në dosjen e Komisionit. Për këtë çështje nga ky shtetas është depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (referuar shkresës nr. ***prot., datë 25.1.2023, të kësaj Prokurorie) edhe kallëzimi penal nr. ***, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal, pasi fakti penal nuk ekziston.

¹¹⁹ Dërguar në përgjigje të pyetësorit nr. 3, datë 4.4.2023, parashtuar subjektit me tekst në *email*.

¹²⁰ Denoncim nr. *** prot., datë 15.7.2022, nr. *** prot., datë 1.12.2022, nr. *** prot., datë 25.4.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

48.2 Nga verifikimi i vendimit të mosfillimit, Komisioni konstaton se rrethanat e faktit të çështjes tregojnë për mbivendosje pronash. Rezulton se punonjësit e ZRPP-së i kanë kthyer përgjigje denoncuesit për këtë situatë juridike të pronës. Rezulton gjithashtu se subjekti i ka arsyetuar ato dhe se në vendimin e tij ka vlerësuar se pretendimet e kallëzuesit për mosveprim të ZRPP-së lidhur me ankesat e tij, nuk përbëjnë vepër penale, pasi në çdo rast aktet administrative janë objekt i ankimit në gjykatë nga palët që preken/cenohen.

48.3 Për të qartësuar më shumë situatën e pretendimeve në denoncim, pasi denoncuesi ka vijuar ankesat ndaj subjektit të rivlerësimit edhe për çështje të tjera (gjithnjë të prezantuara në kuadër të problemeve pronësore), për të cilat pretendon se janë përfunduar pa u kryer verifikimet e nevojshme sipas parashikimeve ligjore, Komisioni i kërkoi¹²¹ subjektit të japë shpjegime dhe dokumentojë mbi pretendimet, vërtetësinë dhe saktësinë e tyre.

48.4 Subjekti ka parashtruar në mënyrë të detajuar historikun dhe veprimet e kryera me çështjen objekt trajtimi. Ai ka shpjeguar se procedimi penal nr. *** është regjistruar më 19.10.2020 dhe se në bazë të shortit elektronik prokuror për hetimin e këtij procedimi ka qenë caktuar prokurori E.K. Në datën 19.10.2021, prokurori i çështjes ka përpiluar kërkesën për pushimin e kësaj çështjeje, me arsyetimin se fakti objekt kallëzimi nuk ekziston. Pasi prokurori i çështjes është larguar nga detyra, në bazë të shortit elektronik është caktuar subjekti si prokuror për këtë çështje. Pretendimi i këtij shtetasi se seanca është shtyrë 8 herë për mungesë të tij, sipas tij, është absurd, pasi sipas nenit 329/b/2: *“Kur palët nuk paraqiten, ndonëse janë njoftuar rregullisht... pa parashtruar shkaqe të arsyeshme gjykimi zhvillohet pa praninë e saj/tyre”*. Për më tepër, ka theksuar subjekti, që shtetasi A.Z ka kërkuar edhe përjashtimin e gjyqtarit G.H. Në këtë kuptim, është shprehur subjekti, shtyrja e gjyqimit për 8 seanca, duke e marrë të mirëqenë pretendimin e ankuesit, nuk ka qenë rrjedhojë e mosparaqitjes së tij.

48.5 Subjekti ka sqaruar se pasi është njohur me aktet është paraqitur në seancë dhe ka dhënë pretendimet e tij. Ai ka shpjeguar se gjykata ka vendosur të kthejë aktet për vazhdimin e hetimeve dhe këtë vendim ai nuk e ka apeluar, duke menduar se kryerja e veprimeve të urdhëruara nga gjykata do të ishte në dobi të të gjithëve, pasi ankimimi do të shtynte çështjen për më shumë se 2 vjet deri në pritje të gjyqimit në apel. Subjekti ka deklaruar se para mbërritjes së akteve të këtij procedimi në Prokurorinë e Rrethit Tiranë, me vendimin e datës 8.10.2022 është bërë bashkimi i këtij procedimi penal me atë me nr. ***, viti 2022, ardhur për kompetencë nga PPKKOK-ja për shkakun se kanë të njëjtin objekt, në një procedim të vetëm me nr. ***. Më pas ai është vënë në dijeni të faktit se në datën 8.6.2022 shtetasi A.Z ka kërkuar që subjekti të përjashtohet nga hetimi i këtij procedimi, por edhe i procedimit penal nr. *** regj., viti 2022, datë 24.2.2022, po mbi bazën e kallëzimit të tij, duke pretenduar se ai kishte shkaqe njëanshmërie, por pa cituar asnjë të tillë. Subjekti ka sqaruar se denoncuesi ka kërkuar në avancë përjashtimin e disa prokurorëve të tjerë, të cilët sipas tij janë në konflikt interesi. Subjekti ka theksuar se ky shtetas, me sa ai ka pasur dijeni, ka paraqitur një kallëzim penal ndaj tij në PPKKOK, duke pretenduar se prej subjektit është shpërdoruar detyra në dëm të tij/denoncuesit. Mbi këtë kërkesë, është shprehur subjekti, ai ka paraqitur pranë drejtuesit të Prokurorisë një kërkesë për heqjen dorë nga këto procedime penale *“duke besuar se zëvendësimi i tij do të ndikonte në zhbllokimin e situatës dhe realizimin e detyrave që gjykata kishte lënë pas kthimit të dosjes për plotësimin e detyrave. Për më tepër që ky shtetas në mënyrë të vazhdueshme paraqiste ankesa të pabazuara në ILD, KLP, KPK, si dhe ka bërë kallëzim penal ndaj subjektit pranë PPKKOK-së”*. Në këto rrethana, për një hetim të paanshëm dhe objektiv dhe jashtë çdo subjektiviteti, subjekti ka menduar se është detyrimi i tij ligjor të heqë dorë nga hetimi i mëtejshëm

¹²¹ Me pyetësin datë 5.4.2023, parashtruar me tekst në email.

i këtij procedimi. Në vijim ai ka konfirmuar se drejtuesi i Prokurorisë, me vendimin datë 19.10.2022, nuk e ka pranuar kërkesën për heqjen dorë me arsyetimin se *“Kërkesa e prokurorit Saimir Hysa nuk gjen mbështetje në përcaktimet ligjore të nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale dhe, si e tillë, nuk mund të pranohet”*. Pas këtij momenti, ka theksuar subjekti, nga oficeri i policisë gjyqësore është njoftuar disa herë shtetasi A.Z për të dhënë shpjegime, si dhe modele të nënshkrimit dhe shkrimit të tij dhe familjarëve të tij që nuk jetojnë në Shqipëri, pasi ai ka pretenduar, ndër të tjera, se i është falsifikuar nënshkrimi i tij në një akt noterial. Pavarësisht se ai është njoftuar në adresën e dhënë prej tij, kutinë postare nr. *** Tiranë dhe përmes telefonatave në disa njoftime, ka refuzuar të paraqitet, duke insistuar në largimin e subjektit nga hetimi i çështjes, si dhe në faktin se “si viktimë dhe kallëzues nuk ka asnjë detyrim ligjor për deklarime të mëtejshme, të cilat do të sqarohen vetëm në gjykatë gjatë seancës”, qëndrime këto të shprehura prej denoncuesit përmes disa sms-ve oficerit të policisë gjyqësore.

48.6 Subjekti ka deklaruar se aktualisht të dyja këto procedime janë në fazën e hetimit paraprak dhe se ai pasi është njohur me ankesën e këtij shtetasi nuk është në gjendje ta kuptojë mosdashjen e tij për të bashkëpunuar me organin e hetimit dhe qëndrimin e denoncuesit ndaj tij/subjektit. Subjekti ka sqaruar se kërkesat e këtij shtetasi për përjashtimin e gjyqtarëve apo prokurorëve kanë qenë të shumta, por vetë ky shtetas është pengesë kryesore për ecurinë normale të hetimit. Lidhur me faktin se në disa raste kallëzimet e tij i janë shortuar subjektit, kjo gjë lidhet me faktin se të gjitha kallëzimet janë në fushën e veprimit të seksionit, ku subjekti bën pjesë dhe kjo gjë është një rastësi nga përzgjedhja e bërë përmes shortit elektronik, ku subjekti nuk ndikon dot. Subjekti ka deklaruar se të gjitha vendimet që ai ka marrë lidhur me kallëzimet e tij i janë njoftuar në rrugë postare në adresën e depozituar prej këtij shtetasi dhe ai nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit për asnjë prej tyre.

Subjekti ka depozituar 10 dokumente për të provuar shpjegimet e dhëna.

48.7 Edhe pse Komisioni në rrethanat e konstatuara, në raport edhe me dokumentacionin e depozituar e verifikuar, duket se nuk vërejt ndonjë fakt apo rrethanë, që mund të përbënte provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, vijoi hetimin mbi këtë denoncim, referuar edhe materialit me gjetje të vëzhguesit ndërkombëtar.

48.8 Në materialin përkatës janë cituar edhe një herë faktet e rrethanat e kësaj çështjeje objekt hetimi. Ndër të tjera, në gjetje pasqyrohet se: (i) Në mars të vitit 2022, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në gjykatë kërkesën për pushimin e çështjes. Në korrik 2022, gjykata konstatoi se hetimi nuk ishte i plotë. Sipas gjykatës, prokuroria nuk i kishte hetuar pretendimet për falsifikim të një certificate pronësie të përdorur nga noterja. Gjykata ia ka rikthyer aktet/dosjen subjektit për hetime të mëtejshme; (ii) Denoncuesi Z., ndër të tjera, pretendon se subjekti i rivlerësimit e ka vonuar hetimin, për shkak të mungesës së tij në seanca (ai është paraqitur vetëm dy herë nga tetë seanca gjithsej); (iii) Subjekti ka dhënë shpjegime, duke saktësuar se hetimi është kryer nga një prokuror tjetër; (iv) Për vonesat, subjekti i rivlerësimit u përgjigj se gjykata mund edhe të vazhdonte me seancat, në rast të mungesës së paarsyeshme, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe disa dokumente bashkë me shpjegimet e tij; (v) Subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse për mungesën e tij në seancat gjyqësore, pasi i referohet vetëm një dispozite të procedurës penale që lejon gjykatën të vazhdojë seancat në rastet e mungesave të pajustificuara të palëve; (vi) Subjekti i rivlerësimit ka përmendur edhe kërkesat e denoncuesit për zëvendësimin e gjyqtarit të caktuar për çështjen, por nuk ka paraqitur asnjë provë për këtë; (vii) Subjekti duhet të sqarojë pozicionin e tij, nëse mungesat ishin të justifikuar, si dhe të sigurojë dokumente mbështetëse; (viii) Çështja i është caktuar subjektit që nga korriku 2021, pasi ish-prokurori është shkarkuar nga detyra dhe subjekti i rivlerësimit e ka paraqitur kërkesën në gjykatë në mars të vitit 2022, ku në këtë seancë ai vetë nuk ka qenë i pranishëm; (ix) Subjekti i rivlerësimit duhet të

shpjegojë në mënyrë të besueshme kohën kaq të gjatë që iu desh për të paraqitur kërkesën në gjykatë (korrik 2021 – mars 2022) dhe nëse ai kishte ndërmarrë ndonjë hap hetimor, ndërkohë subjekti duhet të shpjegojë gjithashtu nëse veprimet e tij kanë qenë në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

48.9 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit: (i) të sqarojë pozicionin e tij në gjykatë, nëse mungesat ishin të justifikuara, si dhe të depozitonte dokumente mbështetëse; (ii) të dokumentojë shpjegimin e tij lidhur me kërkesat e denoncuesit për zëvendësimin e gjyqtarit të caktuar për gjykimin e çështjes; (iii) të shpjegojë në mënyrë bindëse kohën e gjatë që u nevojiti për të paraqitur kërkesën në gjykatë (korrik 2021 – mars 2022); (iv) të rendisë hapat/veprimet hetimore të ndërmarra për hetimin e kësaj çështjeje në përputhje me Kodin e Procedurës Penale, duke provuar edhe me dokumentacion (urdhura, vendime apo procesverbale).

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

48.10 Në qëndrimin e tij subjekti ka cituar nenin E/2 të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, sipas të cilit “*Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim*”, pasi procedimi penal në fjalë me nr. ***, viti 2021, është ende në fazën e hetimit paraprak, por ka vijuar të japë shpjegime, duke pretenduar se ankesa e këtij personi është tërësisht e pabazuar.

48.11 Subjekti ka deklaruar se *sipas të dhënave të sistemit CAMS kjo çështje i është shortuar atij më 24.7.2021, pas shkarkimit nga detyra të prokurorit të mëparshëm prej Komisionit në datën 9.7.2021. Kërkesa për pushim është e datës 9.3.2021.* Subjekti ka deklaruar bazuar në procesverbalin e seancave gjyqësore, për të cilat shpjegon se rezultoni: sipas shortit elektronik të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesa i është shortuar fillimisht gjyqtarit S.T. Ky gjyqtar ka caktuar seancën e parë në datën 18.11.2021. Kjo sipas njoftimit të datës 4.10.2021, me objekt “Caktim prokurori”. Subjekti ka deklaruar: “*Për këtë seancë unë nuk kam pasur dijeni dhe nuk jam paraqitur dhe sipas procesverbalit të seancës, gjykata ka konstatuar se “u thirr nuk u paraqit prokurori E.K (rezultoni të mos jetë më në atë institucion), duke caktuar seancën e radhës në 7.1.2022. Në datën 7.1.2022 unë nuk jam paraqitur dhe Gjykata në bazë të nenit 329/b/2 të Kodit të Procedurës Penale ka marrë vendim për të vazhduar gjykimin e çështjes mbi bazën e akteve që organi i Prokurorisë ka paraqitur dhe pasi ka kryer shqyrtimin gjyqësor ka vendosur të shtyjë seancën gjyqësore për më 17.3.2022, ora 11:00, “Për t’u njohur dhe administruar aktet”. Gjatë kësaj kohe gjyqtari S.T, në datën 3.11.2021, kishte njoftuar Komisionin (sipas faqes zyrtare të Komisionit) se do të paraqiste kërkesë për dalje në pension të parakohshëm. Më 8.2.2022, KLGJ-ja ka vendosur pranimin e kërkesës për miratimin e pensionit të parakohshëm për magjistratin S.T... mbarimin e statusit të magjistratit S.T, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të daljes në pension të parakohshëm pleqërie; efektet juridike të urdhërimeve sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi fillojnë në datën 28.2.2022. Për këtë arsye seanca e datës 7.3.2022 nuk është zhvilluar, pasi gjyqtari kishte dalë në pension. Çështja është rihedhur në short dhe për shqyrtimin e kësaj kërkesë është shortuar gjyqtari G.H. Ky gjyqtar në datën 10.3.2022 ka urdhëruar caktimin e seancës gjyqësore për në datën 15.4.2022, ora 11:00.*

*Në seancën e datës 15.4.2022, unë kam marrë pjesë dhe shtetasi A.Z ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit G.H. Për këtë arsye, gjyqtari ka shtyrë seancën me qëllim shqyrtimin e kërkesës nga gjyqtari i gatshëm, duke caktuar për seancë tjetër datën 11.5.2022. Kërkesa është shqyrtuar nga gjyqtari K.G, i cili me vendimin nr. *** regj., datë 19.4.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së shtetasit A.Z për përjashtimin e gjyqtarit G.H. Në datën 10.5.2022, shtetasi A.Z ka depozituar në sekretarinë e Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Tiranë një kërkesë për shtyrjen e seancës së datës 11.5.2022, pasi kishte angazhime personale. Pasi jam vënë në dijeni nga sekretarja gjyqësore për*

këtë kërkesë, unë nuk jam paraqitur në seancë, duke e konsideruar të panevojshme prezencën time. Pavarësisht se kishte kërkuar vetë shtyrjen e seancës, shtetasi A.Z është paraqitur në këtë seancë, ku përsëri ka kërkuar shtyrjen e saj “për shkak të një problemi personal familjar”. Gjykata ia ka pranuar këtë kërkesë duke caktuar seancën e radhës në datën 8.6.2022. Në datën 8.6.2022 unë jam paraqitur në seancë, por ajo nuk është zhvilluar, pasi A.Z kishte revokuar prokurorin e avokates së tij, duke kërkuar shtyrjen e seancës. Me një kërkesë të veçantë me shkrim ai ka kërkuar që seanca të caktohet në datën 15.7.2022, pasi ndodhej në Itali, për më tepër që edhe gjyqtari ishte angazhuar me përgatitjen e dokumentacionit për procesin e rivlerësimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit. Seanca e radhës është caktuar më 18.7.2022, ku unë nuk kam marrë pjesë dhe gjykata ka vazhduar gjykimin duke shpallur edhe vendimin për kthimin e akteve. Në total, për shqyrtimin e kësaj kërkesë janë zhvilluar seanca në datat 18.11.2021, 7.1.2022, 15.4.2022, 11.5.2022, 8.6.2022 dhe 18.7.2022. Nga procesverbalet rezulton se në dy seancat e zhvilluara nga gjyqtari S.T, më 18.11.2021 dhe 7.1.2022, unë nuk kam pasur dijeni, pasi njoftimet ishin bërë për prokurorin e mëparshëm. Në seancën e datës 11.5.2022 nuk jam paraqitur, pasi isha vënë në dijeni për kërkesën e bërë prej A.Z për shtyrjen e seancës. Në seancat e datës 15.4.2022 dhe 8.6.2022 unë kam marrë pjesë dhe shkakun i shtyrjes së seancës ka qenë vetë shtetasi A.Z. Seanca e datës 8.6.2022 është shtyrë nga vetë gjyqtari, pasi ishte i angazhuar me përgatitjen e dokumentacionit për procesin e rivlerësimit në Kolegjin. E vetmja seancë që kam munguar ka qenë ajo e datës 8.6.2022, për të cilën nuk jam në gjendje të shpjegoj se për çfarë arsye, e cila gjithsesi nuk është bërë shkak për ty shtyrë seanca, pasi sipas nenit 329/b/2 “kur palët nuk paraqiten ndonjëse janë njoftuar rregullisht... pa parashtruar shkaqe të arsyeshme gjykimi zhvillohet pa praninë e saj”. Pra, mungesa ime nuk është bërë shkak në asnjë rast për shtyrje të seancës gjyqësore. Për periudhën mars 2021 – prill 2022 çështja është zvarritur nga gjyqtari S.T, i cili ishte në prag të largimit nga detyra dhe aspak nga unë. Pas zëvendësimit të tij, çështja është vënë në veprim dhe gjykimi i plotë ka përfunduar brenda tre muajve, pavarësisht shtyrjeve që janë pasojë e kërkesave të vetë këtij personi”. Subjekti kundërshtoi: “Si mund të konstatohet lehtësisht i gjithë ankimi i A.Z kur ai është keqdashës, i pavërtetë, hakmarrës deri në nivelin e shpifjes kur pretendon se unë kam munguar në 8 seanca gjyqësore kur janë zhvilluar gjithsej 6 dhe shkakun u shtyrjes për gjysmën e tyre ka qenë ai vetë. Unë, jo vetëm që nuk e kam zvarritur gjykimin, por pasi gjykata ka vendosur të kthejë aktet për vazhdimin e hetimeve, këtë vendim nuk e kam apeluar duke menduar se kryerja e veprimeve të urdhëruara nga gjykata do të ishte në dobi të të gjithëve, pasi ankimimi do të shtynte çështjen për më shumë se dy vjet deri në pritje të gjykimin në apel. Pretendimet e tij ndaj meje lidhen me faktin se në dy raste unë kam marrë vendim për mosfillimin për kallëzimet që ai ka bërë, gjë që ai e ka konsideruar si njëanshmëri, shkak për të cilin ka kërkuar edhe përjashtimin tim, kërkesë që nuk është pranuar nga drejtuesi i Prokurorisë, pavarësisht qëndrimit tim se “duke besuar se zëvendësimi im do të ndikojë në zhbllokimin e situatës dhe realizimin e detyrave që gjykata ka lënë pas kthimit të dosjes për plotësimin e detyrave. Për më tepër që ky shtetas në mënyrë të vazhdueshme paraqet ankesa të pabazuara në ILD, KLP, KPK, si dhe ka bërë kallëzim penal ndaj meje pranë PPKKOK-së. Në këto rrethana, për një hetim të paanshëm dhe objektiv dhe jashtë çdo subjektiviteti mendoj se është detyrimi im ligjor të heq dorë nga hetimi i mëtejshëm i këtij procedimi”.

Nga oficeri i policisë gjyqësore ky shtetas është njoftuar për të dhënë shpjegime, si dhe modele të nënshkrimit dhe shkrimit të tij dhe familjarëve të tij që nuk jetojnë në Shqipëri, pasi ai ka pretenduar ndër të tjera se i është falsifikuar nënshkrimi i tij në një akt noterial. Pavarësisht se ai është njoftuar në adresën e dhënë prej tij, kutinë postare nr. ***, Tiranë, si dhe përmes telefonit në disa njoftime ai ka refuzuar të paraqitet, duke insistuar në largimin tim nga hetimi i çështjes, si dhe në faktin se “si viktimë dhe kallëzues nuk ka asnjë detyrim ligjor për deklarime të mëtejshme, të cilat sipas tij/denoncuesit do të sqarohen vetëm në gjykatë gjatë seancës”, qëndrime këto të shprehura prej tij

përmes disa sms-ve oficerit të policisë gjyqësore. Kërkesat e këtij shtetasi për përjashtimin e gjyqtarëve apo prokurorëve janë të shumta, por vetë ky shtetas është pengesë kryesore për ecurinë normale të hetimit. Të gjitha vendimet që unë kam marrë lidhur me kallëzimet e tij i janë njoftuar në rrugë postare në adresën e depozituar prej këtij shtetasi dhe ai nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit për asnjë prej tyre”.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

48.12 Trupi gjykues vlerëson shpjegimin e detajuar të subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionin e depozituar mbi të cilin ai ka prapësuar. Nga verifikimi i procesverbaleve gjyqësore të administruara, trupi gjykues konstaton se qëndrojnë pretendimet e subjektit se ai nuk është bërë shkas për shtyrjen e procesit gjyqësor. Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se procesi gjyqësor është shtyrë në 6 seanca të konkretizuara në datat përkatëse sipas procesverbaleve gjyqësore dhe jo siç pretendohet nga denoncuesi se janë zhvilluar 8 seanca. Konstatohet se shtyrja e seancave gjyqësore ka ardhur si rezultat i kërkesave të vetë denoncuesit për mospjesëmarrje në gjykim, për përjashtim gjyqtari dhe, për rrjedhojë, për shkak të kohës që kërkohet për shqyrtimin e saj, për shkak të arsyeve të ndryshme të gjyqtarëve të çështjes, si për dorëheqje të dhënë nga procesi i rivlerësimit etj. Të gjitha kërkimet dhe arsyet e shtyrjeve që kryesisht i referohen denoncuesit dhe gjyqtarëve pasqyrohen në procesverbale, nga ku vërehet se ato konkurrojnë në raport me mospjesëmarrjen e subjektit të rivlerësimit vetëm në një seancë gjyqësore. Trupi gjykues konkludon se nuk qëndron pretendimi i denoncuesit se subjekti i rivlerësimit e ka vonuar hetimin, duke mos u paraqitur në seanca gjyqësore, pasi jo vetëm që hetimi është i ndarë nga gjykimi, por edhe për faktin se dokumentacioni provoi katërçipërisht të kundërtën. Trupi gjykues e quan shterues shpjegimin e subjektit lidhur me pretendimet e denoncuesit – si për hetimin nga ana e tij të çështjes, pasi ai ka theksuar se bën pjesë në seksione të hetimit të këtyre çështjeve (pronësore) dhe se çështjet caktohen me short, si për kërkimet e tij për të dhënë dorëheqje për shkak të ankesave të denoncuesit, kërkesa të cilat nuk janë pranuar nga eprorë të subjektit apo edhe për të gjitha veprimet e denoncuesit, të cilat duken si makinacione për të tërhequr vëmendjen lidhur me këtë çështje, ndërsa rezulton i njoftuar për të dhënë deklarime në hetimin e saj.

Në përfundim, trupi gjykues nuk vëren fakte apo rrethana që ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, por në këtë vlerësim mban në konsideratë edhe faktin se çështja është nën hetim dhe, për rrjedhojë, Komisioni nuk ka kompetencë¹²² të mëtejshme trajtimi.

49. Denoncim¹²³ i shtetasit F.H

49.1 Denoncuesi ankohet për një çështje penale që i përket një ngjarjeje të ndodhur në vitin 2007 (hetuar nga një tjetër subjekt rivlerësimi), për veprën penale të parashikuar nga neni 99 të Kodit Penal, e cila është pushuar në vitin 2007. Çështja e kallëzuar nga denoncuesi i referohet vdekjes së nënës së tij, për të cilën pretendon se në të vërtetë shkak i vdekjes ka qenë aksidenti nga një automjet dhe jo hemorragjia cerebrale si shkak i rrëzimit të saj në shkallë. Më tej ai shpjegon se çështja e pushuar në vitin 2007 është kthyer për hetime të tjera. Nga vendimi i pushimit të procedimit penal, datë 25.10.2010, të subjektit të rivlerësimit, konstatohet se vendimi i pushimit të çështjes në vitin 2007 është shfuqizuar nga Prokurori i Përgjithshëm në vitin 2009 për të sqaruar shkakun e vdekjes së të ndjerës, nënës së denoncuesit. Nga dokumentacioni i administruar vërehet se subjekti i rivlerësimit në rihetimin e çështjes, pas shfuqizimit nga organi epror, ka kryer hetimet e lëna, ka përkrahur në vendim aktin e ekspertimit mjekoligjor, pyetjen e disa personave, për të cilët

¹²² Bazuar në vendimin e Kolegjit nr. 33/2021, datë 3.11.2021.

¹²³ Shkresë nr. *** prot., datë 25.4.2019; shkresë nr. *** prot., datë 25.4.2019; shkresë nr. *** prot., datë 11.6.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

pretendohej se kishin dijeni për shkakun e vdekjes, të dhënat e grumbulluara nga spitali, ku e ndjera ka marrë shërbimin e nevojshëm etj. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka konkluduar në pushimin e çështjes, pasi deklarimet e marra, akti i ekspertimit, por edhe diagnoza e qendrës spitalore nuk kanë identifikuar si shkak të vdekjes aksidentin e ngjarë ndaj të ndjerës, sikurse ka pretenduar denoncuesi. Vendimi i subjektit të rivlerësimit është prishur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e saj nr. *** akti, datë 21.7.2011, me arsyetimin se duhen ripyetur shtetasit e pyetur më parë dhe, nëse do të kenë sërish deklarime kontradiktore, të ballafaqohen me qëllim zbulimin e shkakut të vdekjes së të ndjerës.

49.2 Në shpjegimet¹²⁴ e dhëna, subjekti ka deklaruar se vendosi të pushonte çështjen për shkak të mungesës së provave dhe, për sa i përket statusit aktual të çështjes, ai shpjegoi se çështja ishte pushuar me vendim të datës 15.1.2012.

49.3 Komisioni vijoi hetimin për çështjen e denoncuar për shkaqet e parashtruara në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar, ku thuhet se: (i) në vitin 2011, më 21 korrik, gjykata ka urdhëruar subjektin e rivlerësimit që të ndërmerre disa veprime të tjera hetimore, ndër të tjera, të merrte në pyetje 4 persona dhe, nëse do të kishte deklarata kontradiktore, të kryente ballafaqimin dhe, më tej, ai duhej të merrte në pyetje mjekun e përfshirë; (ii) hetimi i subjektit të rivlerësimit duket se ka zgjatur gati 1 vit në vitin 2010 dhe 4,5 muaj në vitin 2011, kur hetimi penal zakonisht zgjat 3 muaj, ndërsa shtyrja eventuale duhet të jetë e motivuar; (iii) nga informacioni i dhënë prej subjektit të rivlerësimit nuk kuptohen arsyet e shtyrjes në të dyja rastet; (iv) nga vendimi i tij për pushimin e hetimit të datës 15.1.2012 duket se nuk janë marrë në pyetje të gjithë personat e përmendur nga gjykata, përkundrazi, duket se ka marrë në pyetje dikë që nuk është përmendur nga gjykata; (v) subjekti ka konstatuar se nuk ka pasur deklarata kontradiktore, ndaj nuk ka nevojë për ballafaqim; (vi) shtetasi F.S nuk është marrë në pyetje nga subjekti i rivlerësimit, pasi duket se është një nga dëshmitarët e drejtpërdrejtë; (vii) shkaktari i dyshuar i aksidentit automobilistik, siç përmend denoncuesi, ishte shtetasi A.B, i cili duket se nuk është pyetur.

49.4 Në këto kushte, Komisioni i kërkoi subjektin të shpjegonte dhe dokumentonte: (i) veprimet konkrete të kryera përgjatë hetimit të çështjes (duke depozituar kopje të akteve procedurale të administruara në fashikullin penal), zgjatjen e hetimeve (mbi 3 muaj) për një vit deri në vendimmarrjen e parë të vitit 2010 dhe për 4,5 muaj deri në vendimmarrjen e radhës, datë 25.1.2012; (ii) arsyet e mosmarrjes në pyetje të shtetasit F.S, pasi dukej se ishte një nga dëshmitarët e drejtpërdrejtë në këtë çështje penale (për shkak të detyrave të lëna prej saj/ gjykatës); (iii) përse nuk ishte pyetur (nuk janë marrë deklarime) shkaktari i dyshuar i aksidentit automobilistik, A.B, sikurse përmend denoncuesi se ka qenë ky shtetas; (iv) nëse ndaj vendimit të vitit 2012 të pushimit të procedimit penal është ushtruar ankim dhe cili është statusi aktual i tij.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

49.5 Subjekti në prapësimet e tij ka parashtruar se aktualisht çështja është e pushuar në bazë të vendimit të pushimit të datës 15.1.2012. Ai ka qartësuar se kallëzuesi ka ngritur pretendimin se nëna e tij F.H nuk ka vdekur si pasojë e rrëzimit nga shkallët, por si pasojë e një aksidenti automobilistik, duke akuzuar për këtë shtetasin A.B si personi që ka drejtuar mjetin dhe duke lëvizur *indietro* ka goditur nënën e tij. Subjekti ka deklaruar se nga provat që u mblodhën, ky fakt jo vetëm nuk rezultoi i provuar, por as i vërtetë. Subjekti ka sqaruar se kundër këtij pretendimi ka dëshmuar edhe vëllai i kallëzuesit, i cili ka deklaruar se nëna e tij në spital i ka thënë se ishte rrëzuar nga shkallët, por edhe

¹²⁴ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

me fqinjët e pranishëm. Subjekti ka deklaruar se ka vendosur në mungesë të provave pushimin e çështjes, duke shtuar se vendimmarrja është e drejtë dhe e bazuar në prova.

49.6 Lidhur me zgjatjen e hetimeve mbi 3 muaj, subjekti ka sqaruar se paraprakisht prej tij, në kuadër të hetimeve të këtij procedimi, nuk është përpiluar asnjë urdhër për regjistrimin e emrit të personit në regjistrin e njoftimeve të veprave penale si autor të ndonjë vepre penale. Sipas nenit 287/1 të Kodit të Procedurës Penale, që ka qenë në fuqi në vitin 2008: *“Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale”*. Sipas nenit 323/1 të Kodit të Procedurës Penale të kohës: *“Brenda tre muajve nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, prokurori vendos dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin ose pezullimin e saj”*. Nisur nga ky fakt, subjekti ka shpjeguar se nuk ka pasur asnjë arsye që të marrë vendim për të zgjatur afatin e hetimeve sipas nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale, veprim që lidhet domosdoshmërisht me momentin e regjistrimit të emrit të personit në regjistrin e njoftimeve të veprave penale dhe jo me momentin e regjistrimit të procedimit penal.

49.7 Lidhur me ecurinë e hetimit të këtij procedimi, subjekti ka deklaruar se ky procedim është marrë për veprim prej tij në datën 11.6.2009 sipas shënimit të zv/drejtuesit të Prokurorisë, pas shfuqizimit të vendimit të pushimit të marrë nga një prokuror tjetër prej Prokurorisë së Përgjithshme më 29.5.2009. Në datën 8.10.2009 është përpiluar urdhri për kryerjen e veprimeve hetimore dhe është ngarkuar për kryerjen e veprimeve një OPGJ pranë Komisarariatit të Policisë Nr. ***, Tiranë. Nga ky oficer janë kryer veprimet hetimore të mëposhtme: procesverbal deklarimi H.H, datë 5.11.2009; procesverbal deklarimi F.S, datë 4.11.2009; procesverbal deklarimi V.R, datë 14.11.2009; procesverbal këqyrjeje pranë INSTAT-it, datë 3.12.2009; procesverbal këqyrjeje në kartotekën e Spitalit Ushtarak, datë 29.10.2009; procesverbal këqyrjeje marrje dokumentesh, datë 9.11.2009. Më 29.11.2009, OPGJ-ja ka përpiluar relacionin dhe me shkresën e datës *** prot., datë 22.12.2009, janë sjellë aktet në Prokurori. Pas mbërritjes së akteve nga policia gjyqësore, subjekti ka sqaruar se nga ana e tij, në datën 29.3.2010 është marrë vendim për të kryer ekspertimin mjekoligjor me grup ekspertësh. Në zbatim të këtij vendimi është kryer akti i ekspertimit mjekoligjor nr. ***, datë 11.5.2010, nga grupi i ekspertëve mjekoligjorë. Në datën 31.3.2010 është përpiluar një urdhër tjetër për kryerje të veprimeve hetimore. Në zbatim të këtij urdhri është përpiluar shkresa nr. *** prot., datë 12.4.2010, drejtuar DRSHTRR-së Tiranë, ku kërkohej informacion për disa mjete. Më 28.4.2010 është marrë shkresa nr. *** prot., ardhur nga DPSHTRR-ja Tiranë, bashkë me informacionin e kërkuar. Në datën 9.4.2010 është pyetur shtetasi XH.R. Në datën 9.4.2010 është pyetur shtetasja L.Y. Në datën 9.4.2010 është pyetur shtetasi P.M. Në datën 11.4.2010 është pyetur shtetasja E.G. Në datën 14.4.2010 është pyetur shtetasja B.M. Në datën 18.4.2010 është pyetur shtetasi A.B. Është administruar më 12.3.2010 pranë zyrës së gjendjes civile të Njesisë Bashkiake Nr. *** Tiranë certifikata e vdekjes e shtetasit NJ.D, person që gjithashtu duhej të merrej në pyetje. Me shkresën nr. *** prot., datë 12.4.2010, janë sjellë materialet në Prokurori. Në datën 25.5.2010 është vendosur pushimi i çështjes dhe është përpiluar shkresa nr. *** prot., datë 16.6.2010, për njoftimin e këtij vendimi shtetasit F.H. Në datën 21.7.2010, me vendimin nr. *** akti, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit dhe vazhdimin e hetimeve, duke lënë si detyrë pyetjen e shtetasve K. dhe A.B, SH.Y dhe F.S, si dhe ripyetjen e shtetasës SH.Y. Vendimi i Gjykatës i formës së prerë ka mbërritur në Prokurori më 1.9.2010 dhe në datën 5.9.2010 i ka kaluar për veprim nga zv/drejtuesi i Prokurorisë. Pas mbërritjes së vendimit të sipërcituar janë kryer veprime të tjera hetimore si: procesverbal deklarimi K.B, datë 16.11.2011; procesverbal deklarimi N.D, datë 10.11.2011; procesverbal deklarimi SH.S, datë 4.11.2011. Në datën 12.1.2012 është vendosur pushimi i çështjes dhe është përpiluar shkresa nr. ***, datë 2.2.2012, për njoftimin e

këtij vendimi shtetasit F.H në adresën e tij në SHBA. Kundër këtij vendimi shtetasi F.H nuk ka bërë ankim, prandaj mund të konsiderohet përfundimtar.

49.8 Lidhur me konstatimin e Komisionit për mosmarrjen në pyetje të shtetasit A (A) B si autor i dyshuar i aksidentit, subjekti ka deklaruar se pyetja e tij nuk është bërë e mundur për shkak se ky shtetas, sipas informacioneve që dispononte policia gjyqësore, ishte larguar jashtë shtetit. Me shkresën nr. ***, drejtuar Departamentit për Kufirin dhe Emigracionin, është kërkuar informacion për hyrje-daljet e tij dhe rezulton se ai kishte dalë nga Shqipëria më 1.8.2008 dhe nuk ishte kthyer më. Subjekti ka deklaruar se nga verifikimi që kishte bërë në sistemin TIMS, shtetasi A.B pas vitit 2008 për herë të parë ka hyrë në Shqipëri në datën 13.8.2013, pasi hetimet për këtë procedim ishin pushuar.

49.9 Subjekti ka shpjeguar edhe lidhur me marrjen në pyetje të shtetasit F.S. Subjekti ka deklaruar se ky shtetas rezulton i pyetur në datën 4.11.2009 nga OPGJ-ja. Subjekti ka depozituar një kopje të deklarimit të këtij shtetasi. Subjekti ka cituar deklarime të këtij shtetasi, ku ndër të tjera ai ka pohuar se *“Nuk ka parë ndonjë makinë aty pranë në momentin e rrëzimit”* dhe *“F. ishte e moshuar dhe ka rënë disa herë nga shkallët”*, duke shtuar se *deklarimi është i ndryshëm nga sa ka pretenduar denoncuesi se nëna e tij është goditur nga një mjet në lëvizje.*

49.10 Subjekti ka parashtruar se për këtë çështje, sikurse edhe mund të konstatohet, janë kryer hetime të plota dhe se ai ka pranuar çdo kërkesë të shtetasit F.H për të kryer veprime hetimore apo marrje provash. Subjekti ka deklaruar se *pretendimet e denoncuesit kanë qenë kontradiktore, bazuar në fjalë të dëgjuesve lart e poshtë apo të sajuesve dhe që në asnjë rast nuk rezultuan të vërteta.* Subjekti ka theksuar se vëllai i tij H.H ka deklaruar se *“E pyeta mamanë dhe më tha se u rrëzova në rrugë”* dhe, më pas, *“Mbaj mend që e pyeti doktori dhe i është përgjigjur njësoj si mua, se ishte rrëzuar në tokë”*. Subjekti ka cituar edhe deklarimet e mjekut V.R, person pa asnjë interes në çështje, i cili ka deklaruar se familjarët e F. i kanë thënë se ajo kishte rënë nga shkallët dhe se fraktura të tilla janë shumë të shpeshta tek moshat e vjetra. Subjekti ka deklaruar se *kallëzuesi pretendon se nëna e tij është goditur nga një mjet tip “BMW” me ngjyrë të kuqe, por nga informacioni i marrë nga DRSHTRR-ja Tiranë as babai dhe as bashkëshorti i hallës së A.B nuk dispononin një mjet të tillë.* Subjekti ka shpjeguar se *për më tepër që ai përmend herë një furgon me ngjyrë blu dhe herë një mjet BMW.* Subjekti ka deklaruar se asnjë prej deklaruesve që ai ka kërkuar të pyeten nuk jep ndonjë informacion me vlerë për hetimin, duke u justifikuar me shprehjet se *“kam dëgjuar”* apo *“flitet në lagje”*, me të cilat ka qenë e pamundur që të ngrihet akuzë dhe, për këtë arsye, subjekti është shprehur se pushimi i çështjes për mungesë të provave ka qenë e vetmja zgjidhje e duhur.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

49.11 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të detajuara të subjektit për të gjitha veprimet hetimore të kryera, por edhe të dokumentacionit të administruar, konstatoi se në të vërtetë çështja është regjistruar pa autor dhe e tillë ka mbetur. Për pasojë, subjekti ligjërisht nuk ka qenë i detyruar dhe as ka pasur arsye të vendosë lidhur me zgjatjen e afatit të hetimit, kështu që konteksti i zvarritjes së çështjes duket se nuk qëndron, për sa kohë faktet dhe rrethanat kanë pasqyruar nevojën e një hetimi kompleks, domosdoshmërinë për të pyetur një numër të konsiderueshëm personash, nevojën e kryerjes dhe administrimit të aktit të ekspertimit etj.

49.12 Nga verifikimi i vendimit gjyqësor, i cili e ka kthyer çështjen për të tjera hetime në raport me veprimet e mëtejshme hetimore të kryera nga subjekti, duket se ato janë ezauruar, për sa kohë çështja ka përfunduar dhe vendimi gjyqësor nuk është ankimuar. Nga verifikimi i vendimit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.*** Akti, datë 21.07.2011, trupi gjykues konstatoi se nuk ishte lënë detyrë pyetja e shtetasit A.B si i dyshuar për kryerjen e aksidentit, por nga verifikimi i

vendimit të subjektit të rivlerësimit datë 25.05.2010 “Për pushimin e çështjes”, konstatohet se është pasqyruar informacioni që organi i akuzës kishte se ky shtetas ndodhej jashtë vendit. Trupi gjykues në këtë çështje objekt hetimi konstaton se duket se qëndrojnë pretendimet e subjektit të rivlerësimit se të gjithë të pyeturit (të kërkuar për të deklaruar nga denoncuesi) kanë deklaruar në forma dhe mënyra të ndryshme, ashtu sikurse edhe kishin dëgjuar për rastin dhe, për pasojë, jo domosdoshmërisht mund të ishin në një linjë deklarimi. Kjo situatë nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit në çmuarjen e rastit, pasi duket se të pyeturit hera-herës nuk ishin të mirënjohur me rastin, nuk kanë deklaruar se kanë qenë të pranishëm në ngjarje. Referuar deklarimeve të ndryshme vërehet se edhe vetë i vëllai i subjektit të rivlerësimit nuk ishte në koherencë me pretendimet e denoncuesit, madje edhe vetë ky i fundit kishte deklarime kontradiktore për mjetin me të cilin pretendohet se ishte kryer aksidenti, duke konfirmuar një herë një mjet të tipit “BMW” dhe një herë tjetër një furgon. Trupi gjykues, konstaton se është respektuar e drejta e palës/denoncuesit¹²⁵, për njoftimin e vendimit, i cili nuk ka ushtruar ankim.

49.13 Në të tilla kushte, trupi gjykues mbi hetimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit të cilat kanë rezultuar në vendimmarrje pushimi të saj, nuk vlerëson të penalizojë subjektin vetëm për faktin e rikthimit të çështjes për të tjera hetime, për sa kohë rrethanat konkrete të çështjes, nuk kanë prodhuar një situatë ku të detyrohej organi i akuzës të regjistronte emrin e personit dhe të ngrinte për të akuzën.

50. Denoncim¹²⁶ i shtetasit K.D

50.1 Denoncuesi ankohet për vendimmarrje të padrejtë të gjykatës në dëm të tij. Ai ka qartësuar se është akuzuar dhe dënuar padrejtësisht. Përmbajtja më e madhe e denoncimit referon pretendime të denoncuesit për një tjetër prokuror, si dhe për gjyqtaren e çështjes penale në ngarkim të tij, ku nuk saktësohet vepra penale për të cilën akuzohej. Denoncuesi ankohet se subjekti i rivlerësimit është përfshirë thuajse në fund të procesit, në mënyrë rastësore, kur çështja ndodhej në gjykatë për gjykim. Denoncuesi pasqyron shumë informacion, por nuk konkretizon pozitën e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë çështje, ndërsa hera-herës sqaron se ka kërkuar disa herë përjashtimin e tij nga kjo çështje. Në tërësi, nga trajtimi i denoncimit nuk pasqyrohen të dhëna mbi të cilat mund të konkludohet në një perceptim të qartë.

50.2 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të qartësojë dhe dokumentojë pozitën e tij në këtë çështje penale, prej nisjes në organin e akuzës dhe vijimit të çështjes në gjykatë, si dhe të shpjegojë e dokumentojë mbi pretendimet e denoncuesit lidhur me kërkesën e tij për përjashtimin e subjektit nga ky proces.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

50.3 Subjekti në qëndrimin e tij, ndër të tjera, ka parashtruar se ky shtetas akuzohet për “ngacmim seksual”, kryer ndaj një punonjëseje të shoqërisë që drejtonte. Ai ka sqaruar se çështja ka qenë dërguar për gjykim nga një prokuror tjetër dhe, pas largimit të tij nga detyra, në datën 1.2.2022 subjekti është caktuar për përfaqësimin e akuzës në gjykatë, në bazë të shortit elektronik. Subjekti ka shpjeguar se në seancën e parë që ka marrë pjesë, i pandehuri kërkoi gjykimin e shkurtuar të çështjes dhe, pasi gjykata ka pranuar kërkesën, ai po në atë seancë ka dhënë konkluzionet ku ka kërkuar deklarimin e të pandehurit fajtor dhe dënimin e tij me 1.5 vjet burgim. Subjekti ka sqaruar se do t'i qëndronte akuzës, pasi ishte plotësisht e provuar dhe natyrisht që ai kishte lexuar dosjen. Subjekti ka qartësuar se pasi i pandehuri kishte kërkuar kohë në seancën pasardhëse, ishte ndodhur në një sulm verbal nga i pandehuri, me argumente se subjekti nuk kishte dosje dhe nuk e njihte

¹²⁵ Referuar shkresës nr.***, datë 02.02.2012, administruar në denoncimin e shtetasit H nr.*** prot, datë 11.06.2019.

¹²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 22.5.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

atë/dosjen, nuk ishte prokuror i çështjes etj. Më tej, ka sqaruar subjekti, i pandehuri kishte kërkuar përjashtimin e tij, porse ai kishte bërë me dije më herët se nuk kishte pasur asnjë shkak për të dhënë dorëheqjen dhe kishte kërkuar vazhdimin e gjykimit. Subjekti ka sqaruar se drejtuesi i Prokurorisë, ku ai kishte bërë kërkesën për zëvendësimin e tij, i kishte kërkuar informacion dhe, në përfundim, kishte refuzuar kërkesën e të pandehurit për zëvendësimin e subjektit. Subjekti ka sqaruar se edhe pas këtij refuzimi i pandehuri kishte kërkuar vazhdimisht që subjekti të dorëhiqej, ndërsa subjekti e ka refuzuar këtë kërkesë, duke konfirmuar se nuk kishte shkak për të dhënë dorëheqje, se ishte duke bërë detyrën etj. Subjekti ka sqaruar se në përfundim të gjykimit me shumë vështirësi Gjykata e Shkallës së Parë e deklaroi të pandehurin fajtor duke e dënua me 1 vit burgim dhe aktualisht pritet gjykimi në Gjykatën e Apelit, ku i pandehuri ka bërë ankim.

50.4 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, vëren se ato janë të plota, të qarta dhe hedhin plotësisht dritë mbi ecurinë e hetimit dhe shqyrtimit të çështjes, pasi janë dhënë sqarime edhe mbi statusin e saj.

51. Denoncim¹²⁷ i shtetasit B.K

51.1 Denoncuesi ankohet për ndërhyrje të paautorizuar dhe pa asnjë proces gjyqësor nga subjekti i rivlerësimit për bllokimin në hipotekë të pronës së babait të tyre. Denoncuesi ka depozituar kartelën e pasurisë, nga verifikimi i së cilës konstatohet se një sipërfaqe trualli është e regjistruar në emër të disa bashkëpronarëve K. Nga pretendimi i denoncuesit dhe dokumenti i depozituar nuk prezantohet asnjë lidhje me funksionin e subjektit të rivlerësimit. Duket e paqartë arsyeja e depozitimit të këtij akti nga denoncuesi, për shkak se nuk shërben dhe as ka lidhje me pretendimin pronësor, për të cilin gjithashtu nuk ka treguar fakte konkrete për subjektin e rivlerësimit.

51.2 Komisioni mbi kërkimin pa objekt të denoncuesit nuk konstatoi fakte apo rrethana, të cilat ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

52. Denoncim¹²⁸ i shtetasit A.P

52.1 Denoncuesi, në ankesën e tij të depozituar pas vendimmarrjes së trupit gjykues, synon të raportojë dhe nuk prezanton ndonjë shkelje të kryer nga subjekti i rivlerësimit për ndonjë çështje të hetuar prej tij. Denoncuesi synon të bëjë kryesisht prezent blerjen e një pasurie nga ana e subjektit të rivlerësimit, për të cilën shkruan se ky i fundit nuk e ka deklaruar në organet kompetente. Denoncuesi, veç denoncimit, nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion.

52.2 Komisioni e ka njohur subjektin me denoncimin përkatës, duke i bërë me dije se ky denoncim është administruar në dosjen e tij. Subjekti, në përgjigje të denoncimit, ka deklaruar: “...kjo pasuri është blerë nga unë dhe bashkëshortja ime në dhjetor 2022 dhe aktualisht është e regjistruar në ASHK në emrin tonë. Kjo pasuri është deklaruar rregullisht nga ana ime në DPV-në e vitit 2022”, duke depozituar edhe dokumentacionin përkatës të administruar në dosjen e tij.

Komisioni hetoi bazuar në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar¹²⁹ mbi dy çështje penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit.

53. Mbi kallëzimin penal nr. ***

53.1 Nga dokumentacioni i administruar (përcjellë nga vëzhguesi ndërkombëtar) ka rezultuar se në cilësinë e prokurorit në Tiranë, subjekti i rivlerësimit, në bazë të kallëzimit penal, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 27.6.2022, nga shtetasit F. B. dhe A. P. Kallëzimi ishte kundër

¹²⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 10.7.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹²⁸ Përcjellë në Komision me email-in e datës 9.8.2023.

¹²⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.6.2023, administruar në dosjen e Komisionit në versionin anglisht dhe në përkthimin shqip.

maternitetit “***”, Spitalit Pediatrik etj., me pretendimin se nga ana e përfaqësuesve të këtyre institucioneve janë kryer veprime në kundërshtim me ligjin, që përbëjnë veprën penale “shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Shkurtimisht, në kallëzimin penal pretendohej se një foshnjë e porsalindur ishte infektuar me HIV për shkak të neglizhencës nga ana e spitalit dhe të tjerëve. Subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e çështjes pa nisur hetimin, me vendimin e datës 12.7.2022.

53.2 Ky vendim i subjektit të rivlerësimit është ankimuar në gjykatë. Në vendimin e saj, gjykata ka nënvizuar mangësitë e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë çështje dhe ka urdhëruar fillimin e hetimit. Vendimi i gjykatës rezulton se është lënë në fuqi në Apel.

53.3 Bazuar në këto të dhëna, Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka kryer veprime hetimore lidhur me vërtetësinë e pretendimeve të kallëzuesve, si pasojë e të cilave gjykata ka vendosur kthimin e çështjes dhe regjistrimin e procedimit penal dhe, për rrjedhojë, i kërkoi subjektit: (i) të shpjegojë dhe dokumentojë të kundërtën e konstatimit¹³⁰; (ii) të depozitojë vendimet përkatëse, të organit të akuzës dhënë nga subjekti, si dhe vendimet gjyqësore.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

53.4 Subjekti i rivlerësimit në qëndrimin e tij ka sqaruar se procedimi është ende në fazën e hetimit dhe, mbështetur në kapitullin/nenin E/2 të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, “*Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim*”, konsoliduar kjo edhe nga vendimi i Kolegjit nr. ***. Subjekti ka sqaruar se materiali nuk është procedim por material kallëzues. Subjekti ka sqaruar se nuk është i vërtetë fakti se kallëzuesit kanë pretenduar se “*Një foshnjë e porsalindur ishte infektuar me HIV për shkak të neglizhencës nga ana e spitalit dhe të tjerëve*”. Subjekti ka cituar kallëzuesin në mënyrë të drejtpërdrejtë, ku ai ka kërkuar nisjen e hetimeve “*Kush e dëmtoi djalin tonë pa nisur akoma jetën*” dhe, në vijim, subjekti ka deklaruar se “*Në kallëzim nuk përmendet kurrkund fjala HIV*”. Subjekti ka deklaruar se kallëzuesi ka bërë kallëzim ndaj: maternitetit “***” dhe spitalit pediatrik QSUNT për “neglizhencë dhe shpërdorim detyrë”; Institutit të Shëndetit Publik për “zvarritje të informacionit dhe moskryerje hetimi në kohë”; Ministrisë së Shëndetësisë si “organi më i lartë përgjegjës për shkelje të rënda dhe dëmtim pacienti nga personeli shëndetësor”. Subjekti ka shpjeguar se kallëzuesi nuk ka parashtruar asnjë fjalë tjetër në kallëzim për të shpjeguar se çfarë kishte ndodhur realisht dhe për çfarë veprimesh të kundërligjshme kërkonin që organi i Prokurorisë të fillojë hetime. Subjekti ka qartësuar se kallëzimi është bërë ndaj institucioneve dhe jo ndaj personave përgjegjës. Kallëzuesit nuk kanë referuar asnjë fakt konkret, përveç kërkesës për të nisur hetimet se “*Kush e dëmtoi djalin tonë pa nisur akoma jetën*”. Subjekti ka sqaruar se kallëzuesit kanë depozituar tri analiza dhe nuk kanë dhënë asnjë sqarim se për çfarë arsye ishin kryer ato.

53.5 Subjekti ka shpjeguar se mosfillimi i procedimit është kompetencë e prokurorit sipas nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë rast, subjekti ka referuar vendimin unifikues nr. 2, datë 20.6.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës të Lartë, ku theksohet se: “*Rastet e mosfillimit të çështjes penale nuk kërkojnë ndonjë hetim të thellë. Konstatimi i rrethanave është i lehtë dhe përgjithësisht bëhet para fillimit të procedimit penal, për këtë mjaftojnë vetëm disa verifikime të shpejta për të konkluduar rreth marrjes së një vendimi mosfillimi*”. Subjekti ka sqaruar se në kallëzimin e bërë nuk parashtrohet asnjë e dhënë konkrete për të motivuar regjistrimin e një procedimi penal, nuk ka asnjë shpjegim se çfarë dëmtimi ka pësuar fëmija i kallëzuesve, në çfarë mënyre ka ndodhur, nuk ka dhënë shpjegime se çfarë lidhje kanë institucionet që ai ka kallëzuar, në thelb ata nuk kanë kallëzuar asgjë. Subjekti ka sqaruar se për këto shkaqe në vendim ka përcaktuar

¹³⁰ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

se: “Mungojnë provat apo indiciet e nevojshme për të krijuar dyshimin e arsyeshëm sa i përket pretendimit të kallzuesve për kryerjen e veprës penale”.

53.6 Subjekti ka qartësuar se vendimi që ka marrë nuk mbyllte mundësinë që fakti të hetohej. Ai ka theksuar se pasi është njohur me fatkeqësinë e tyre, u ka sugjeruar kallzuesve që të përpilonin një kallzim të plotë dhe ta depozitonin, ndërsa ata kanë preferuar të ndjekin rrugën gjyqësore dhe të ankimeve ndaj tij në organet shtetërore dhe media. Subjekti ka sqaruar se për shkak të mbingarkesës në punë është e pamundur që të thirret e pyetet çdo person që bën kallzimin dhe që prokurori të marrë rol aktiv, duke marrë prova e kryer verifikime për vetëm 15 ditë, ndaj shtrohet diskutimi se a mund që të mos fillohet vetëm mbi bazë të kallzimit. Subjekti ka depozituar të dhëna mbi ngarkesën e punës, ku thekson se në total për vitin 2022 ka pasur 765 kallzime/procedime dhe se ka marrë pjesë në mbi 500 seanca gjyqësore.

53.7 Subjekti ka kërkuar që të dhënat e depozituara të vlerësohen nga Komisioni në kontekst, me sa është pretenduar në gjetjen e vëzhguesit, për të kuptuar se nuk ka manifestuar asnjë mangësi profesionale në trajtimin e këtij kallzimi. Subjekti ka deklaruar se prej tij nuk është shkelur asnjë ligj dhe kallzuesve nuk u është cenuar asnjë e drejtë. Subjekti ka depozituar kallzimin e shtetasve B. dhe P, datë 21.6.2022, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

53.8 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe verifikimit të dokumentacionit të administruar, vëren se referuar kallzimit të depozituar nga subjekti, të dhënat e përmbajtjes së aktit duket të jenë sipërfaqësore, nuk pasqyrojnë ndonjë të dhënë konkrete për t’i hapur rrugë hetimit të çështjes së kallzuar. Trupi gjykues e çmon këtë çështje në raport edhe me vendimmarrjen e gjykatës, e cila e ka kthyer atë me qëllim regjistrimin e procedimit dhe vijimin e hetimeve, veprim i kryer nga subjekti i rivlerësimit me urdhrin “Për regjistrimin e procedimit penal”, datë 12.6.2023, por edhe në raport me faktin se vërehet që në vendimin gjyqësor, në ndryshim nga kallzimi i paraqitur në organin e akuzës, kallzuesit kanë qartësuar veprën penale për të cilën akuzonin institucionet përkatës për “neglizhencë dhe shpërdorim detyre”, si dhe kanë deklaruar, të dhëna të tjera më të detajuara, duke prezantuar një situatë të qartë për vendimmarrjen gjyqësore. Në këto kushte, duke vlerësuar të gjithë faktet e rrethanat në harmoni me njëra tjetrën, ku reciprokisht të gjithë palët e përfshira, si organi i akuzës/subjekti i rivlerësimit dhe gjykata pasqyrojnë vendimmarrje të bazuara në ligj, por edhe duke qenë se tanimë çështja është ende në hetim nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues çmon se nuk ka kompetencë në trajtimin e mëtejshëm të saj dhe as nuk mund të shprehet proporcionalisht për penalizim të subjektit në këtë vlerësim referuar edhe jurisprudencës së KPA-së, referuar vendimit nr.33 datë 3.11.2021.

54. Mbi çështjen e aferës ***

54.1 Komisioni, pas njohjes me materialin e vëzhguesit ndërkombëtar¹³¹, vëren se në gjetjen e përcjellë është konstatuar se:

- Kjo çështje është raportuar nga mediat si një nga çështjet më të spikatura të pastrimit të parave dhe mashtrimit në Shqipëri. Nga aktet e administruara/dosjet përkatëse të përcjella nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm konstatohet përfshirja e subjektit të rivlerësimit në procedimin penal nr. ***, i nisur në kuadër të procedimit kryesor nr. ***.

54.2 Rrethanat e procedimit penal nr. *** për aferën ***

¹³¹ Shkresë nr. ***, datë 27.6.2023, administruar në dosjen e Komisionit në versionin anglisht dhe në përkthimin shqip.

54.2.1 Në vitin 2014, Prokuroria e Rrethit Tiranë regjistroi procedimin penal nr. *** për “mashttrim me pasoja të rënda” dhe “pastrim të produkteve të veprës penale” fillimisht kundër shtetasit K.I (përfaqësues dhe administrator i shoqërisë “***” sh.p.k.), e më pas kundër shtetasve J.H dhe J.I (përkatësisht drejtor i përgjithshëm dhe drejtor i financës për *** Shqipëri).

54.2.2 Sipas akteve të dosjes, shoqëria “***” sh.p.k. është kontraktuar nga *** Shpërndarje në vitet 2010 – 2011 për të mbledhur borxhet e akumuluar për llogari të *** Shpërndarje. Shteti shqiptar zotëronte në atë kohë 24% të aksioneve të shoqërisë *** Shpërndarje. Nga hetimet rezultoi se I, H dhe I, së bashku me persona të tjerë të përfshirë, kanë vjedhur rreth 650 milionë lekë nga *** Shpërndarje me transaksione fiktive dhe dokumente të falsifikuara.

54.2.3 Në vitin 2015, prokurori i çështjes në atë kohë ka ndarë çështjen e I (nr. ***) nga ajo e H dhe I (***). Mësohet se I u gjykua dhe u dënua për “mashttrim me pasoja të rënda” dhe “pastrim i produkteve të veprës penale” me 11 vite burg. Aktualisht, I është ende duke vuajtur dënimin.

54.2.4 Në vitin 2017, Hejsek dhe Ivan, sipas dosjeve të administruara, u dërguan për gjykim për të njëjtat akuza. Në atë kohë, prokurori i çështjes ndau procedimin penal nr. *** “mashttrim me pasoja të rënda” dhe “pastrimi i produkteve të veprës penale” ndaj tyre, nga procedimi penal nr. *** mbi përdorimin e dokumenteve të falsifikuara në këtë procedim penal, sipas nenit 186 të Kodit Penal, “falsifikimi i dokumenteve”.

54.2.5 Procedimi penal nr. ***

Procedimi penal nr. *** duket se ishte caktuar subjektit të rivlerësimit. Nga dosja nuk është e qartë se kur i është caktuar çështja subjektit të rivlerësimit. Në qershor 2019, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesë në gjykatë për pushimin e hetimeve. Në kërkesën e tij për pushimin e hetimeve, subjekti i rivlerësimit i është referuar pikave 2 dhe 3 të nenit 186. Subjekti i rivlerësimit iu referua disa veprimeve hetimore që përfshinin katër shoqëri, të cilat lidhën kontrata shërbimi në vitin 2010 me shoqërinë “***” sh.p.k. për shuma të mëdha parash. Subjekti i rivlerësimit iu referua disa pyetje-përgjigjeve të përfaqësuesve të shoqërive të hetuara. Bazuar në sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka konstatuar se të katër kontratat e shërbimit nuk janë zbatuar nga kontraktorët, megjithëse ata kanë marrë pagesa (ose pjesa më e madhe e tyre). Shoqëritë nuk i kanë kthyer pagesat e marra nga shoqëria “***” sh.p.k. dhe as shtetasi K.I në cilësinë e administratorit të ***-s nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ligjor për kthimin e pagesave.

54.2.6 Subjekti i rivlerësimit ka konkluduar se kishte dyshime serioze se dokumentet mbi transaksionet financiare ishin fiktive dhe kualifikoheshin sipas nenit 186 “falsifikimi i dokumenteve” të Kodit Penal, kryer në bashkëpunim. Subjekti i rivlerësimit gjithashtu ka arsyetuar se falsifikimi në bashkëpunim kualifikohej sipas nenit 186/2. Subjekti i rivlerësimit arriti në përfundimin se sipas dispozitave të nenit 66/b për parashkrimin e veprës penale, hetimi nuk mund të vazhdonte, pasi afati kohor për procedimin e veprës sipas nenit 186/2 kishte mbaruar. Prandaj, ndjekja penale duhej të shuhej.

54.2.7 Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë mbi kërkesën për pushim

i. Nëpërmjet vendimit të regjistrimit themeltar *** të datës 21.11.2019, Gjykata e Shkallës së Parë konstatoi se hetimi për procedimin penal nr. *** nuk ishte i plotë, se kërkesa e prokurorit nuk ishte në përputhje me aktet hetimore të paraqitura në gjykatë, se prej gati 2 vitesh nuk ishte ndërmarrë asnjë hap hetimor etj.

Gjykata arsyetoi se procedimi penal ishte regjistruar sipas nenit 186/3 dhe jo nenit 186/2 të Kodit Penal. Neni 186/3 parashikon falsifikimin e dokumenteve nga persona që kanë për detyrë t'i lëshojnë ato dhe dënohet deri në 7 vjet. Parashkrimi për pikën 3 është 10 vjet, pra nuk kishte përfunduar ende.

Sipas gjykatës, aktet e administruara tregojnë për praninë e veprave të tjera penale, si “mashtim me pasoja të rënda” dhe “pastrim i produkteve të veprës penale”, të kryera nga personat që përfitojnë në mënyrë të paligjshme nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara, siç ka pranuar edhe vetë prokurori në kërkesën për pushim.

ii. Në vijim të sa më sipër, gjykata i ktheu aktet prokurorit, duke urdhëruar veprime të veçanta hetimore brenda 6 muajve.

54.2.8 Ankimi i subjektit të rivlerësimit

Kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, më 21.11.2019, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim.

i. Në dosjen e siguruar nga prokuroria, të vetmet akte të nxjerra nga subjekti i rivlerësimit janë kërkesa për pushim dhe ankimi ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë. Nuk është e qartë nëse subjekti i rivlerësimit ka kryer ndonjë veprim hetimor përpara paraqitjes së kërkesës për pushim, siç përmendet në kërkesën e tij (marrja në pyetje e përfaqësuesve të shoqërive, sigurimi i dokumenteve, kontratave etj.).

ii. Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë i referohet mungesës së veprimeve hetimore për gati 2 vite (2017 – 2019).

iii. Subjekti i rivlerësimit duket se i është referuar në mënyrë kontradiktore në kërkesën e tij për pushim të dy neneve, 186/2 dhe 186/3, të Kodit Penal, duke konkluduar më pas për pushim sipas nenit 186/2 për shkak të parashkrimit të veprës penale. Subjekti i rivlerësimit nuk përmend dhe nuk duket të ketë hetuar nëse kushtet e parashikuara në nenin 186/3 janë plotësuar, pavarësisht dosjeve voluminoze të siguruara gjatë hetimeve të mëparshme dhe faktit të qartë se këta persona ishin përfaqësues të shoqërive të përfshira.

iv. Subjekti i rivlerësimit është jokonsistent në identifikimin e falsifikimit të dokumenteve, përdorimit të tyre, përfituesve dhe mungesës së veprimeve si nga shoqëritë e kontraktuara, ashtu edhe nga shoqëria “****” sh.p.k., duke mos identifikuar apo hetuar përgjegjësinë e atyre, që kanë për detyrë të lëshojnë dokumentet (e falsifikuara), siç parashikohet qartë në nenin 186/3.

v. Çështja në fjalë duket më e rëndësishme në funksion të profilit të lartë publik, ku përfshihen interesa monetare përkatës të shtetit shqiptar, të cilat janë dëmtuar nga veprimtaria e shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shoqërive të tjera të kontraktuara.

54.3 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë bindshëm dhe dokumentojë lidhur me mangësitë e sipërpërmendura në kontekstin e vlerësimit të aftësive profesionale, për më tepër që afati për ndjekjen penale për veprimet e kryera gjatë viteve 2010 – 2011, sipas nenit 186/3 (10 vjet nga kryerja e veprës penale), ka qenë në fuqi deri në vitin 2021, si dhe të sqarojë e dokumentojë nëse aktualisht hetimi është pushuar për shkak të parashkrimit të veprës penale apo për arsye të tjera.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

54.4 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, në prapësime ka shpjeguar fillimisht se çështja objekt hetimi nuk ka lidhje me shoqërinë tregtare ***, pra me çështjen e aferës **. Subjekti ka prezantuar se ky procedim bën fjalë për marrëdhëniet mes shoqërisë “****” sh.p.k. me katër shoqëri tregtare shqiptare, me të cilat shoqëria “****” sh.p.k. ka lidhur disa marrëveshje blerjeje/shitjeje apo edhe

shërbimi. Nga grupi i hetimit është konkluduar që kjo marrëdhënie të hetohet si një çështje me vete, duke qenë se nuk lidhet fare me faktet, objektin e akuzës ndaj të pandehurve të procedimit penal nr. *** apo ***. Ato janë veprime juridike mes shoqërive tregtare private/jopublike, për të cilat këto shoqëri kanë përpiluar fatura tatimore për të cilat shteti ka përfituar taksat përkatëse. Subjekti ka qartësuar lapsusin e bërë në parashikimin ligjor të veprës penale 186/3. Subjekti ka sqaruar se *ndryshe nga sa theksohet në gjetje, shteti shqiptar nuk ka pësuar dëm nga kjo veprimtari*. Ai rikërkon përsëri që të mos ngatërrohet ky procedim me atë nr. ***, duke u shprehur se ky fenomen ndodhi për fat të keq edhe me gjykatësin e Shkallës së Parë që shqyrtoi kërkesën për pushim, i cili u ndikua nga shkrimet dhe interesi i medias për çështjen.

54.5 Subjekti ka prapësuar se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë pas apelimit të tij është ndryshuar dhe çështja është pushuar me vendim të formës së prerë. Subjekti ka pranuar se nga ana e tij, në faqen e dytë të kërkesës për pushim, ka një lapsus të parashikimit ligjor, ku thuhet se është bërë ndarja e çështjes penale për veprën penale “falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal. Për këtë subjekti ka sqaruar se gabimisht i është referuar një materiali të një tjetër prokurori. Ai ka theksuar urdhrin e dy prokurorëve për ndarjen e procedimit penal, ku për çështjen objekt hetimi është parashikuar vepra penale “falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186.

54.6 Subjekti ka shpjeguar se në rastin konkret shtetasi K.I dhe personat e tjerë kanë vepruar si administratorë apo ortakë të shoqërive tregtare dhe jo si subjekte të posaçme me detyra shtetërore apo funksione publike, shkak për të cilin rasti duhet kualifikuar sipas paragrafit 2 të nenit 186 dhe jo paragrafit 3. Subjekti ka kundërshtuar gjetjen e vëzhguesit se ai “nuk ka identifikuar apo hetuar përgjegjësinë e atyre që kanë për detyrë të lëshojnë dokumentet (e falsifikuara), siç parashikohet qartë në nenin 186/3”, pasi kërkesa e tij (ka sqaruar subjekti) është tepër e qartë, se nuk ka pasur subjekte të posaçme në këtë veprimtari që të kualifikohet rasti sipas paragrafit 3 të nenit 186 të Kodit Penal. Subjekti ka shpjeguar se kjo gjë përmendet në kërkesën për pushim të paktën në 4 raste kur kualifikimi ligjor është sipas nenit 186/2 të Kodit Penal, shprehur edhe me fjalë, kur shkruhet “falsifikimi i dokumenteve kryer në bashkëpunim”. Subjekti ka theksuar se në rast se kualifikimi do të ishte sipas paragrafit 3, do të shkruhej “falsifikimi i dokumenteve nga personi që ka për detyrë ta lëshojë dokumentin”. Për më tepër që në kërkesë janë bërë edhe përlllogaritje kohore, kur është shkruar se: *“Kanë kaluar edhe afatet e parashkrimit të ndjekjes penale për veprën penale për të cilat është bërë regjistrimi i procedimit penal, të parashikuara nga neni 186/2 i Kodit Penal, nisur nga fakti se të gjitha këto veprime janë kryer në periudhën 2010 – 2011”*.

54.7 Subjekti ka rikonfirmuar se qartazi bëhet fjalë për një afat 5-vjeçar të parashkrimit, 2010/2011 – 2019 të ndjekjes penale, që i korrespondon nenit 186/2 të Kodit Penal, që parashikon një dënim me burgim deri në 5 vjet. Për paragrafin e tretë të nenit 186 të Kodit Penal, që parashikon një dënim deri në 7 vjet burgim, afati i parashkrimit është 10 vjet dhe natyrisht që nuk mund të kërkonte zbatimin e institutit të parashkrimit.

54.8 Subjekti ka pranuar pakujdesinë e treguar në përpilimin e kërkesës, pasi me të drejtë ka lënë shteg për dyshime, pavarësisht ekzagjerimit të manifestuar në përshkrimin dhe efektin e saj. Po kështu, edhe sa i takon kohës së marrjes së vendimit, subjekti ka pranuar se çështja mund të ishte përfunduar më shpejt, por ka sqaruar se kjo ka ardhur për shkak të ngarkesës së madhe të punës dhe faktit se materiali është shumë voluminoz, 10 volume. Subjekti për ilustrim ka bërë me dije se edhe hetimi i çështjes penale në ngarkim të shtetasit K.I etj., ka zgjatur plot 6 vjet, nga 2011 – 2017, pikërisht për shkak të kompleksitetit dhe volumit të madh të punës së çështjeve të kësaj natyre.

54.9 Subjekti ka shpjeguar se këtë vendim mund ta kishin marrë edhe vetë ata prokurorë që bënë ndarjen e çështjes, pasi që në momentin kur është bërë ndarja kishin kaluar afatet e parashkrimit për veprën penale, të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

54.10 Subjekti ka depozituar apelimin e tij kundërshtues në Gjykatën e Apelit Tiranë, vendimin e plotë të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. ***, datë 13.5.2020, si dhe dokumentacion nga dosja objekt hetimi.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

54.11 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar, vëren se Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, në arsyetimin e vendimit të saj nr. *** akti, datë 21.11.2019, ka cituar se kërkesa e organit të akuzës për pushimin e çështjes është bazuar në nenin 186/2 të Kodit Penal. Por në këtë vendim pasqyrohet se regjistrimi i procedimit penal nr. *** i vitit 2014 (pas ndarjes) është bërë sipas nenit 186/3. Referuar vendimit të organit të akuzës, datë 27.2.2017, për ndarjen e çështjes penale nr. *** të vitit 2014 (në procedimin penale *** dhe ***) në dy procedime, nën vepra penale të ndryshme, konstatohet se procedimi penal nr. ***, i cili është hetuar nga subjekti i rivlerësimit, është ndarë për veprën penale “falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186.

54.12 Trupi gjykues, në tërësi për këtë çështje vërejti se kërkesa e subjektit për pushimin e saj, referon veprën penale bazuar në nenin 186/2 të Kodit Penal. Po në këtë kërkesë citohet se ndarja e çështjes është bërë bazuar në nenin 186/3 të Kodit Penal, ndërsa rezulton se procedimi i ndjekur nga subjekti i rivlerësimit është ndarë për veprën penale “falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 pa përcaktuar ndonjërin prej parashikimeve të këtij neni. Të dhënat dokumentojnë se pas ankimit të subjektit ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë në Gjykatën e Apelit Tiranë, kjo e fundit me vendimin nr. ***, datë 13.5.2020, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe pushimin e çështjes penale. Në referencë të vendimit të gjykatës duket se vendimmarrja e prokurorit është ligjësuar nga vendimi i Gjykatës. Vendimi i Gjykatës së Apelit ka arsyetuar se *detyrimi i Gjykatës është të verifikojë nëse organi i akuzës ka zhvilluar hetime të plota dhe të gjithanshme pa marrë atributet mbi të drejtën e ndjekjes penale, e cila mbetet e drejtë ekskluzive e prokurorisë. Vlerësimi i fakteve të mbledhura gjatë hetimit dhe cilësimi juridik i rrethanave të hetuara paraprakisht, mbeten ekskluzivitet i Prokurorisë dhe asnjë subjekt nuk mund të ndërhyjë me autoritetin e tij në fazën e veprimeve paraprake hetimore.* Kjo gjykatë ka konkluduar se shtetasi I. është dënua një herë për dokumentacion financiar fiktiv e, për pasojë, çështja duhet pushuar.

54.13 Trupi gjykues, duke konsideruar nga njëra anë këtë çështje komplekse, edhe pse me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Tiranë, vlerëson se parashtrimet e subjektit në kërkesën e tij për pushimin e çështjes, nën veprën penale 186/2 të Kodit Penal, në raport me vendimet e gjykatave, t'i nënshtrohen kontrollit nga organi kompetent, me qëllim çmuarjen e provave, si dhe logjikën e përdorur nga subjekti në analizën juridike mbi kualifikimin e saj.

54.14 Trupi gjykues, duke pasur në konsideratë:

- a) pikën 1 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuara për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit”;*
- b) nenin 59 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *“Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues”;*

c) vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 54 përcaktohet: “[...] në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjytimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shihni edhe opinionin *** të Komisionit të Venecias)”;

d) nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit konsiderohet me mangësi kur ka treguar cilësi të papranueshme në punë,

– arsyeton se mangësitë e konstatuara në dy çështjet e sipërtrajtuara nuk janë të mjaftueshme për ta identifikuar si një magjistrat, i cili ka një mënyrë/praktikë pune të papajtueshme me pozicionin e tij.

Për sa më lart, si dhe për shkak të kufizimit për të mos zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit, trupi gjykues vlerëson se vetëm mangësitë e gjetura për sa më sipër arsyetuar mund të përbëjnë shkaqe për t’u vlerësuar më tej nga organi kompetent, sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Vlerësimi i çështjes në tërësi nga trupi gjykues i Komisionit

55. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, çmon se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Saimir Hysa, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

- Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se dërgimi për inspektim i çështjeve të hetuara nga subjekti është i pamjaftueshëm për të arritur në vlerësimin e tij, sipas shkronjave “b” dhe “c” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit arrin nivelin kualifikues sipas neneve 44/a dhe 59/c të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe të nenit 59, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Saimir Hysa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Transferimin e çështjeve që i korrespondojnë kallëzimit penal nr. ***, datë 11.12.2019 dhe procedimit penal nr. *** të vitit 2017 në organin kompetent për inspektimin e shkaqeve, që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, bazuar në pikën 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

3. Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim, me përjashtim të pikës 2, ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 10.8.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka